

VLERËSIM

Udha e një Gjenerali

Bilbil Qazim Bitri merr gradën e lartë "Gjeneral brigade". Ministri Peleshi: "Njerëz si gjeneral Bitri vijnë në kohën e duhur, në vendin e duhur dhe në pozicionin e duhur."

Nga **HAKI PËRNEZHA**

— Faqe 12-13



LETËRKËMBIM

Dibra është unike. Kur vdes një pjesë, ka vdekur e gjithë Dibra

Nga **ABDURAHIM ASHIKU, NAZMI KOÇI** — Faqe 10

HISTORI

Humanistët e shekullit XV-XVI për figurën e Skënderbeut

Nga **ILIA KARANXHA**

— Faqe 14

Gjashtë faqe në Facebook dhe katër peticione online luftojnë të ndarë për të njëjtën kauzë që duhet ti bashkojë

Skavica - sfidë të cilën mund ta fitojmë vetëm të bashkuar

Pse kanë frikë banorët? A ka konsultime me to dhe kur do të zhvillohen? Planet jotransparente të qeverisë. Protesta pak, rezultat aspak. Partitë politike janë "pro" Skavicës. Ndërtimi i Skavicës - a mund të fitojë Dibra? Protesta në New York: A ka vend për shpresë?

- Moskoordinimi i përpjekjeve të zërave kundër që vijnë nga shoqëria civile, planet e qeverisë për ta ndërtuar hidrocentralin dhe puna e kompanisë në terren për fazën e parë të ndërtimit ka rritur frikën te banorët e Dibrës, se jo vetëm nuk do të marrin kompensimet sipas tregut, por edhe ato që u takojnë sipas ligjit nuk do t'i marrin dot.
- Problematikat e regjistrimit të pronës, mungesa e regjistrimit të tyre, çmimet e ulëta të referencës, do t'i katandisë shpërblimet e tyre në shumën qesharake.
- Dibra e Poshtme do të shpërbëhet si etni, sepse pjesa lindore e saj, në anën e djathtë të Drinit të Zi, do t'i bashkëngjitet pjesës tjetër të Dibrës së Epërme, që ka mbetur nën pushtimin serbo-bullgaro-maqedonas nga Konferenca e Londrës e vitit 1913, kurse pjesa tjetër e Dibrës së Poshtme do të shpërbëhet tërësisht, duke iu bashkëngjitur pjesërisht Kukësit, Mirditës dhe Matit.
- "Fakti që qeveria shqiptare është e angazhuar për ndërtimin e Skavicës, është një realitet i ri, me të cilin duhet të përballlemi. Është një mundësi për të zgjedhur mes Dibrës dhe largimit prej saj, shpërbërjes së saj. Është një mundësi që jo vetëm të kërkojmë ndërtimin e rrugës "Lidhja e Prizrenit", por të kërkojmë edhe projekte të tjera me qëllim mosbraktisjen e Dibrës, ku vendin më të rëndësishëm në këtë paketë investimesh e zë ndërtimi i qytetit "Gjergj Kastrioti", në trojet autentike të Heroit Kombëtar. Është koha për të vradë mendjen për ide e projekte, jo për të sulmuar idetë e njëri-tjetrit"

Nga **BUJAR KAROSHI** — Lexoni në faqen 2-3-4



Pamje nga protestat e nëntorit 2021 në Peshkopi. Foto: Sami Curri

Pajtohu në gazetën **RRUGA E ARBËRIT** pranë çdo filiali të **POSTËS SHQIPTARE** në të gjithë Shqipërinë. Një pajtim vjetor kushton **600 lekë**.

PETICION NGA KOMUNITETI SHQIPTAR NË AMERIKË

"Stop Skavica" - thirrja që duhet të na bashkojë

Dibra është në kërkim të një përfaqësuesi që mirëpret mundësitë për të deleguar dhe gjetur mënyra për t'i përfshirë të gjithë në procesin e vendimmarrjes dhe për të vlerësuar ndryshimin. Përfaqësues të tillë dëgjojnë dhe vlerësojnë synimet në lidhje me hyrjen dhe disponueshmërinë për reagime. Drejtuesit proaktivë krijojnë një mjedis të sigurt dhe mbështetës, duke nxitur punë krijuese dhe produktive ku dibranët ndihen të motivuar dhe të vlerësuar.

Nga **FERZILETA GJIKA**

Po bëj një përpjekje modeste për të folur në emër të bashkëatdhetarëve të mi dibranë, me shpresën për të rritur ndërgjegjësimin kundër ndërtimit të digës së Skavicës, e cila nuk është thjesht nocion i sakrificës së njerëzve për

zhvillimin kombëtar, por paraqet dilemën për komunitetet lokale të Dibrës, që nuk janë konsideruar në vendimmarrje në lidhje me projektin famëkeq të Skavicës. Sipas Komisionit Botëror për Digat (WCD, 2000: 1-2), "konfliktet mbi digat janë më shumë se konfliktet për ujën. Ato janë konflikte mbi zhvillimin njerëzor dhe vetë jetën." (Lexoni në faqen 5)

NË BRENDËSI:

- Dibra - referendum popullor për ti thënë JO Skavicës
- Vjosa - park kombëtar, Drini i Zi - çark... kombëtar
- Trishtimi që vjen nga gjuha...
- Bulqiza sërish në udhëkryq
- Varret e viktimave të komunizmit mbulohen nga stoqet e kromit
- Bellinomania shqiptare
- Mulliri i Postovirës
- Ëndrrat e Luzimit, nga bujqësia e blegtorisë, deri te turizmi
- Dr. Nevruz Bara, kirurgu me shpirt human
- Lura dhe Dom Nikoll Kaçorri
- Poetja e fjalës së bukur
- Motra ime, Shqipja
- Sadin Maliq Çerpja, trupin në Amerikë e shpirtin në atdhe
- GJECI & GJOCI
- Nazmi Përkola, "babai" i minierës së Bulqizës
- E qeshura që më sjell Musa Vladi

Gazeta "Rrugë e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur. Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!



Gazetë e pavarur. Nr. 1 (185). Janar 2022. Gazeta doli nga shtypi, 31 Janar 2022.

SKAVICA - sfidë të cilën

Nga **BUJAR KAROSHI**

Një peticion online i krijuar nga një përfaqësi e shqiptarëve që jetojnë në Amerikë, ka ndezur "rrjetin" në lidhje me kundërshtimet për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës.

Më 30 dhjetor, dy anëtarë të këtij komuniteti, Ferzileta Gjika dhe Jurgen Vladi, zhvilluan një takim me Presidentin e Republikës në lidhje me këtë çështje. Ata i kërkuan Presidentit të Republikës mbështetjen e tij për ndalimin e përpjekjeve të qeverisë për ndërtimin e HEC të Skavicës.

Gjika ka hapur edhe një faqe në internet stopskavica.org, ku do të publikohen materiale që kundërshtojnë ndërtimin e hidrocentralit. Në shkrimet e saj të publikuara edhe më parë, rivihet theksi të dëmet në ekosistem si dhe kërkohet studimi i hapësirave të tjerave për prodhimin e energjisë për plotësimin e nevojave të brendshme.

Përveç peticionit online të krijuar nga shqiptarët e Amerikës, në rrjet gjenden edhe tre peticione të tjera, dy prej të cilave në faqen change.org. Sipas një verifikimi më datë 30 janar pasdite, tre peticionet e kësaj faqeje kanë përkatësisht nga 348, 413 dhe 233 nënshkrime, shumë pak për të qenë një zë i fuqishëm online.

Në mesin e muajit janar një grup qytetarësh që kundërshtojnë ndërtimin e hidrocentralit vizituan kantierin ku po kryhen punimet në Skavicë.

"Deri më tani nuk kemi asnjë informacion se çdo të bëhet me Dibrën, - tha një qytetar. Diga ndërtohet në Skavicë, por Dibra përmblytet".

Ndërkohë që zërat kundërshtarë rriten në rrjetet sociale, KESH njoftoi më 26 janar se "në vijim të studimit për vlerësimin e fizibilitetit, pjesë kjo e fazës së parë për zhvillimin e projektit të HEC Skavica, u realizua një takim i përbashkët ndërmjet kompanisë Bechtel, KESH sh.a, si dhe partnerëve ndërkombëtarë të përfshirë në këtë fazë të projektit".



Sipas njoftimit të KESH, të hedhur në FB dhe faqen zyrtare në web, "objekti kryesor i këtij takimi ishte prezantimi nga ana e Bechtel të rezultateve të punës studimore të zhvilluar deri tani.

Prezantimi kishte fokus kryesor diskutimin mbi opsionet e propozuara në lidhje me përcaktimin e aksit të digës, proces ky i realizuar mbi bazën e analizës së kriterëve tekniko-ekonomike."

Njoftimi i KESH nuk zgjatet në detaje, megjithëse rezultatet e prezantuara nuk ka arsye pse t'i mbahen të fshehta publikut.

PSE KANË FRIKË BANORËT?

Moskoordinimi i përpjekjeve të zërave kundër që vijnë nga shoqëria civile, planet e qeverisë për ta ndërtuar hidrocentralin dhe puna e kompanisë në terren për fazën e parë të ndërtimit ka rritur frikën te banorët e Dibrës. Banorët kanë frikë se jo vetëm nuk do të marrin kompensimet sipas tregut, por edhe



Pamje faqeve në rrjetin social Facebook që janë krijuar për të kundërshtuar ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës. Një pjesë e tyre publikojnë shkrime, komente e deri vjersha për Dibrën e Skavicën, por në të gjitha vihet re gjuha e urrejtjes dhe sharjeve kundër qeverisë. Opinione serioze të botuara kundër ndërtimit të Skavicës gjejnë pak ose aspak hapsirë në këto faqe.

Moskoordinimi i përpjekjeve të zërave kundër që vijnë nga shoqëria civile, planet e qeverisë për ta ndërtuar hidrocentralin dhe puna e kompanisë në terren për fazën e parë të ndërtimit ka rritur frikën te banorët e Dibrës. Banorët kanë frikë se jo vetëm nuk do të marrin kompensimet sipas tregut, por edhe ato që u takojnë sipas ligjit nuk do t'i marrin dot. Problematikat e regjistrimit të pronës, mungesa e regjistrimit të tyre, çmimet e ulëta të referencës, do t'i katandisë shpërblimet e tyre në shuma qesharake.

ato që u takojnë sipas ligjit nuk do t'i marrin dot. Problematikat e regjistrimit të pronës, mungesa e regjistrimit të tyre, çmimet e ulëta të referencës, do t'i katandisë shpërblimet e tyre në shuma qesharake.

Frika e banorëve lidhet edhe me faktin se palët nuk bëjnë aspak transparencë, por vetëm deklarata të zmadhuara politikisht, pa argumentet ekonomike dhe pa u bazuar në fuqinë ekonomike të vendit.

"Skavica duhet të ketë një projekt afatgjatë që mbron mjedisin e mbi të gjitha duhet të jetë një projekt model sa i përket kompensimit të pronës private dhe rentës që duhet të përfitojnë bashkitë që preken nga kjo vepër", thotë një ekspert i ekonomisë në vend.

Për të bashkuar zërat kundër ndërtimit të hidrocentralit, deri më tani janë gjashtë faqe aktive në facebook. Ato, përveç se përsërisin njëra-tjetrën në postime, nuk kanë ndërmarrë

asnjë nismë thelbësore për unifikim e bashkim, qoftë edhe për protesta.

PLANET JOTRANSPARENTË TË QEVERISË

Qeveria shqiptare e kryeministrit Edi Rama që në mes të vitit 2014 diskutoi me përfaqësues të konsorciumit Power China Corporation në lidhje me hidrocentralin e Skavicës. Por ndërkohë që priteshin rezultatet e negociimit me kinezët, qeveria nisi procedurat për dhënien me koncesion të HEC-it të Katundit të Ri, i cili dështoi.

Më 12 korrik 2017 qeveria shqiptare e paraqiti projektin e Skavicës në Samitin e Triestes, nga ku u premtua financimi nga Bashkimi Europian. Qeveria mori mbështetje për Skavicën në këtë samit, por BE, përmes Komisionit Europian njoftoi një vit më parë, janar 2021, tërheqjen zyrtarisht nga mbështetja e këtij investimi. Shkak u bënë negociatat e qeverisë shqiptare me kompaninë shumëkombëshe Bechtel.

Më 27 maj 2020, gjatë një ceremonie të zhvilluar në Lushnjë, në prezantimin e Parkut Fotovoltaik të Karavastasë, kryeministri Edi Rama deklaroi se Skavicën "... ta ndërtojmë me forcat tona, me 100% aksioner shtetin".

"Skavica ka qenë një objektiv historik i të gjitha qeverive shqiptare dhe të atyre të para viteve '90. Është një objekt strategjik isht absolutisht i domosdoshëm, i vështirë, i komplikuar dhe për këtë arsye gjithmonë qeveritë e kanë pasur në plan, por asnjëherë nuk e kanë shtyrë procesin deri në fund. Ne jemi përpjekur në këto vite të gjejmë aktorët e duhur që të mund të investoheshin për këtë projekt, por tanimë kemi vendosur që, siç thoshin njëherë e një kohë, ta ndërtojmë me forcat tona dhe do ta ndërtojmë Skavicën

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtorët e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më datë 20 të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullit.

Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "e".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:

Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra
Editor i faqes online: Agim Deva
Kontribuan për këtë numër:

Osman XHILI
Abdurahim ASHIKU
Fertzileta GJIKA
Shaqir ÇERPJA
Hysen LIKDISHA
Sami CURRI / bulqizaim.al
Haki PËRNEZHA
Ilija KARANXHA
Bashkim LAMI
Martin CUKALLA
Gëzim LOKA
Destan RAMA
Nazmi KOÇI
Drini VLESHA

Redaksia falenderon përzemërsisht z. **Shaban Bitri, znj. Ferzileta Gjika-Vladi dhe z. Daut Çerpja** për kontributet e dhëna për gazetën, përkatësisht 10000 lekë, 100 USD dhe 5000 lekë.

KËRKOHEM KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.

Të interesuarit të shkruajnë email në adresën <rrugaearberit@gmail.com> ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit www.rrugaearbërit.com.

Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.

Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.

Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë në postë:

Raiffeisen Bank
Rrugë e Arbërit / NIPT: K820190025
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë

Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603

E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë


Çdo shkrim apo foto e botuar në nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

“Marrëveshja e 3 tetorit 2020 për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës është krejtësisht e paligjshme, antishqiptare dhe antikombëtare. Ajo është antiligjore jo vetëm në kundërshtim me Kushtetutën e Shqipërisë, por edhe me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut,


mund ta fitojmë vetëm të bashkuar

Faza e parë e ndërtimit të Skavicës ka nisur zyrtarisht me 5 korrik 2021 dhe janë 18 muaj në dispozicion për të kryer të gjitha studimet e nevojshme, deri në dhjetor 2022.

Dibra e Poshtme do të shpërbëhet si etni, sepse pjesa lindore e saj, në anën e djathtë të Drinit të Zi, do t'i bashkëngjitet pjesës tjetër të Dibrës së Epërme, që ka mbetur nën pushtimin serbo-bullgaro-maqedonas nga Konferenca e Londrës e vitit 1913, kurse pjesa tjetër e Dibrës së Poshtme do të shpërbëhet tërësisht, duke iu bashkëngjitur pjesërisht Kukësit, Mirditës dhe Matit.



Faqja e peticionit online në www.change.org (tinyurl.com/mrykme42), krijuar nga Ferzileta Gjika, përfaqësuese e komunitetit dibran në SHBA. Me datë 30 janar 2022, për më pak se 1 javë nga krijimi, ka marrë 395 nënshkrime.



Faqja e peticionit online në www.change.org (tinyurl.com/mxej26ne), krijuar nga Zenel Hoxha, kryetar i Aleancës për Mbrojtjen e Dibrës. Deri me datë 30 janar 2022 ka marrë 413 nënshkrime.

me 100% shtetin”.


Vetëm katër muaj më vonë, më 3 tetor 2020 në Tiranë u nënshkrua memorandumi i bashkëpunimi ekonomik mes Shqipërisë dhe SHBA, ku në qendër të këtij bashkëpunimi ishte ndërtimi i Skavicës.

“Kapitulli social i këtij studimi, i cili do të vijë me kontratën paraprake, do të jetë një kapitull i rëndësishëm, ku kompania dhe shteti do të marrin përsipër të gjithë zgjidhjet e problematikave që do të lindin duke nisur nga shpronësimet, nga kompensimet dhe në çdo hap tjetër që përgjegjësia sociale e një kontrate komerciale përfshin në bazë të ligjit”, pati thënë ministri Balluku në Parlament, duke mbrojtur ligjin nr. 38/2021, “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë “Bechtel International, inc.”, për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës”. Ky ligj u miratua me 23 mars 2021, me 93 vota pro, 3 kundër dhe 7 abstenime.


Faza e parë e ndërtimit të Skavicës ka nisur zyrtarisht me 5 korrik 2021 dhe janë 18 muaj në dispozicion për të kryer të gjitha studimet e nevojshme, deri në dhjetor 2022.

“Faza e parë përfshin kryesisht të gjithë punën përgatitore për sa i përket të gjitha studimeve që do të bëhen, duke nisur nga studimi ambiental, ai gjeologjik, ai teknik, social që është shumë i rëndësishëm dhe deri në përfundimin e kësaj faze, duke kaluar pastaj në fazën e dytë”. “Në këtë fazë kemi 18 muaj në dispozicion, të cilat do të shërbejnë për të gjitha ekipet për të bashkëpunuar, për të koordinuar dhe për të prodhuar materialet, të cilat sapo kam përmendur dhe më pas me të gjithë shpresën e mirë, që brenda këtyre 18 muajve do jetë koha e duhur pavarësisht se volumi i kësaj pune është gjigant, por ne do t’ia dalim që brenda 18 muajve që të dorëzojmë një produkt të mirë, i cili më pas do të na hapë rrugën për të kaluar në fazën e dytë dhe për të firmosur atë kontratë, e cila është kontrata e ndërtimit të Hidrocentralit të Skavicës”, deklaronte në ceremoninë e nisjes së punës, ministri i Infrastrukturës, Belinda Balluku.

Më 2 tetor 2021, në kantier ishte ministri i Infrastrukturës dhe ambasadorja e SHBA në Tiranë. Neil Wilkinson, drejtori teknik i Skavicës, tha në atë vizitë se “në këto momente jemi në procesin e kryerjes së studimeve, për të përcaktuar se ku do të jetë me saktësi vendndodhja e digës. Ne kemi filluar gërmimet e para, por duhet të bëjmë dhe disa gërmime të tjera për të parë dhe vërejtur gjeologjinë e gurit në këtë zonë”.



Faqja e peticionit online në www.thepetitionsite.com (tinyurl.com/5n7juduc), krijuar nga Zenel Hoxha, kryetar i Aleancës për Mbrojtjen e Dibrës. Deri me datë 30 janar 2022 ka marrë 38 nënshkrime.



Faqja e peticionit online në www.change.org (tinyurl.com/2mj4dfws) krijuar nga faqja në FB Albanian Tradition. Deri me datë 30 janar 2022 ka marrë 233 nënshkrime.

PROTESTA PAK, REZULTAT ASPAK

Më 1 dhjetor 2020, menjëherë pas nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit mes qeverisë shqiptare dhe asaj të SHBA, banorët e fshatrave të Fushë Alies, Laçes, Kastriot, Bllaçe e Arras, duke shkelur edhe aktet normative për pandeminë, u mblodhën për të kundërshtuar vendimet e qeverisë shqiptare për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës.

Protesta e zhvilluar në një kodër buzë Drinit, në Laçes, u thirr nga shoqata “Për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi” me qëllim zgjedhjen e një përfaqësi nga banorët dhe koordinimin e tyre, me qëllim që në bisedimet qeverinë, të mbrohen sa më mirë interesat. Protesta u shpërnda me kërcënimin e gjobave mbi organizatorët dhe pjesëmarrësit, bazuar në aktet normative të qeverisë në lidhje me pandeminë. Dy prej drejtuesve të saj janë gjobitur me nga 5 milionë lekë. Kjo e rriti zemërimin e banorëve, por protesta nuk zgjodhi asnjë përfaqësi të tyre që do të kërkonte takime me qeverinë.

Pas kësaj proteste, “Shoqata për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi” - e vetmja e regjistruar zyrtarisht deri më tani, nisi një peticion në drejtim të krerëve të shtetit, Presidentit të Republikës, Kryeministrit të Shqipërisë, kryetarit të Parlamentit Shqiptar, ministrit të Energjisë dhe Infrastrukturës si dhe ambasadores së SHBA në Tiranë dhe kompanisë amerikane “Bechtel”, ku kërkohej ndalimi i planeve për ndërtimin e HEC të Skavicës. Përmes peticionit kërkohet anulimin e marrëveshjes së nënshkruar me 3 tetor 2020 për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës.

Hartuesit e peticionit theksonin se “dëmi ekonomik, në aspektin kombëtar qëndron

në plan të dytë në krahasim me dëmin që shkakton në aspektin gjeopolitik, historik dhe etnokulturor. Dibra e Poshtme do të shpërbëhet si etni, sepse pjesa lindore e saj, në anën e djathtë të Drinit të Zi, do t'i bashkëngjitet pjesës tjetër të Dibrës së Epërme, që ka mbetur nën pushtimin serbo-bullgaro-maqedonas nga Konferenca e Londrës e vitit 1913, kurse pjesa tjetër e Dibrës së Poshtme do të shpërbëhet tërësisht, duke iu bashkëngjitur pjesërisht Kukësit, Mirditës dhe Matit.

“Marrëveshja e 3 tetorit 2020 për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës është krejtësisht e paligjshme, antishqiptare dhe antikombëtare”, - thuhej mes të tjerash në atë peticion. Ajo marrëveshje është antiligjore jo vetëm në kundërshtim me Kushtetutën e Shqipërisë, por edhe me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, e cila thekson se “Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare...”

Hartuesit e peticionit theksonin se në rast se kërkesa e tyre nuk merrej parasysh, “pasoja do të jenë të paparashikueshme, deri në mosbindje civile”. Ai peticion, që mbante firmat kryetarit të Nderit të Shoqatës, Ali Hoxha, kryetarit ekzekutiv Nazmi Drizi, nënkryetarëve Dalip Alia e Shaban Beqja, si dhe të sekretarit Nazmi Skepi nuk mori kurrë përgjigje. Kërkesa të ngjashme ka edhe peticioni i hartuar nga komuniteti shqiptar në SHBA, i cili ka gjetur edhe mbështetjen e EURONATUR, një organizatë e njohur në Europë për luftën e saj për mbrojtjen e natyrës. (Më shumë mbi peticionin lexo në faqen 5)

PARTITË POLITIKE JANË “PRO” SKAVICËS

Ligji i posaçëm që i jepte Skavicën kompanisë Bechtel u miratua nga parlamenti shqiptar më 23 mars 2021, një muaj para zgjedhjeve parlamentare. Miratimi i tij ngjalli paqartësi e pakënaqësi të një pjesë e banorëve që përmythen nga ujërat e liqenit. Ndryshe nga sa pritej, që kjo të kthehej në një çështje kryesore elektorale, nuk ndodhi. Peticioni i banorëve drejtuar qeverisë, presidentit, ambasadës amerikane dhe kompanisë Bechtel është injoruar plotësisht. Fatkeqësisht, në këtë çështje nuk ka opozitë.

Përfaqësuesit e qeverisë thoshin se “Kryeministri i punëve të mbaruara i ka menduar mirë këto punë”, ndërsa opozita e kundërshtonte vetëm me argumentin se “do të dëmshpërblejmë sipas tregut, kokërr më kokërr”. Askush nga votuesit nuk kërkoi sqarime se çfarë do të thoshte “puna e mbaruar dhe e menduar e Kryeministrit” apo cila ishte njësia e vlerësimit “kokërr më kokërr”.

Tani që fushata për kryetarin e bashkisë së Dibrës pritet të fillojë së shpejti, ka një përpjekje për ta bërë këtë çështje një kauzë zgjedhore, por duket se edhe kjo do të dështojë. Sepse kryetari i ri i bashkisë së Dibrës nuk ka asnjë mundësi reale për ta penguar procesin. Mundësitë janë vetëm teorikisht.

NDËRTIMI I SKAVICËS. A MUND TË FITOJË DIBRA?

Një lëvizje qytetare nisi në mesin e vitit të kaluar, e iniciuar nga shoqata “Nisma Dibrane”, e cila është vendosur në mes qeverisë

(Vijon në faqen 4)

SKAVICA - sfidë të cilën mund ta fitojmë veç të bashkuar

(Vijon nga faqja 3)

dhe kundërshtarëve të ndërtimit të Skavicës. Më 16 qershor 2021, në mjediset e Pallatit të Kulturës në Peshkopi u mbajt një tubim, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të pushtetit lokal, qytetarëve dhe anëtarë të shoqërisë civile, me qëllim prezantimin e nismës së rrugës "Lidhja e Prizrenit", si pjesë e Paketës së Investimeve Strategjike, e cila synon të japë zgjidhje të kënaqshme për të gjitha palët e interesuara, pa neglizhuar apo dëmtuar as interesin publik.

"Fakti që qeveria shqiptare është e angazhuar për ndërtimin e Skavicës, është një realitet i ri, me të cilin duhet të përballemi. Është një mundësi për të zgjedhur mes Dibrës dhe largimit prej saj, shpërbërjes së saj. Është një mundësi që jo vetëm të kërkojmë ndërtimin e rrugës "Lidhja e Prizrenit", por të kërkojmë edhe projekte të tjera me qëllim mosbraktisjen e Dibrës, ku vendin më të rëndësishëm në këtë paketë investimesh e zë ndërtimi i qytetit "Gjergj Kastrioti", në trojet autentike të Heroit Kombëtar. Është koha për të vlarë mendjen për ide e projekte, jo për të sulmuar idetë e njëri-tjetrit" - thotë drejtuesi i kësaj lëvizje, Hysen Uka.

Uka e ka shpjeguar idenë e tij në një shkrim më herët në gazetën "Rruga e Arbërit" (Nr. 9, shator 2021), ku ka bërë një panoramë më të detajuar mbi idenë e një "Pakete Investimesh Strategjike" në Dibër.

"Dikujt fjala "strategjike" i duket e madhe, teprim, barrë e rëndë për qeverinë dhe shtetin. Asnjëra prej këtyre nuk qëndron, madje mund të themi se si gjithmonë njerëzit tanë janë përmbajtur në kërkimin e të drejtave të tyre, të asaj çfarë u takon. Paketa, së pari, kushtëzohet të jetë "Paketa e Investimeve Strategjike" duhet të studiohet, të integrohet e të realizohet njëkohësisht me fillimin e përfundimin e ndërtimit të HEC- Skavicës", shkruan Hysen Uka.

Lëvizja e tij për t'i kërkuar qeverisë rritjen e investimeve në Dibër është kundërshtuar në rrejet sociale, por ka gjetur një mbështetje të banorët që banojnë përgjatë luginës.

Frika se qeveria mund të silltet me pronat e tyre, njësoj siç po silltet me investime të tjera, ku prishen shtëpi dhe njerëzit braktisen në rrugë, i ka nxitur njerëzit të bashkohen rreth kësaj ideje.

PROTESTA NË NEW YORK: A KA VEND PËR SHPRESË?

Protestat kundër Skavicës u zhvilluan më 4 nëntor 2021 para selisë së OKB-së. Protesta e organizuar nga komuniteti dibran në bashkëpunim me organizatën "Albanian Roots - Rrënjët Shqiptare", nuk dha rezultatet e dukshme. Ndërsa në Shqipëri pritej që zëri i këtij komuniteti të shkonte pranë departamentit të shtetit ose organizatat mjedisore, duket se kjo nuk ndodhi, së paku deri më tani. Hyrja e kompanisë Bechtel u interpretua si një investim i qeverisë amerikane, ndaj edhe një reagim i departamentit të shtetit - pas protestës së New York-ut, pritej nga qytetarët në Dibër. Por me sa duket kjo do të jetë e vështirë, së paku për momentin, pasi protestat e shqiptarëve në Amerikë nuk priten të ketë efekte, për sa kohë që nuk përfaqësojnë ndonjë organizatë të regjistruar ligjrisht në SHBA.

Më 14 nëntor 2021, një protestë u zhvillua në qytetin e Peshkopisë, ku qindra qytetarë u mblodhën dhe kundërshtuan me parulla dhe fjalime ndërtimin e hidrocentralit. Në pamje të jashtme protesta u duk si një bashkim i shoqatave dhe individëve që kundërshtojnë projektin. Nisma për të mbledhur firma dhe nisur një peticion të ri drejt qeverisë rezultoi në fakt një mbledhje firmash për krijimin e një organizate të re, atë të Aleancës për Mbrojtjen e Dibrës.

"Sot në Peshkopi u lidh besa për themelimin e Aleancës për Mbrojtjen e Dibrës nga rreziku katastrofik, siç mund të jetë përmbajtja nga ujëmbledhësi Skavica. Ne do të vazhdojmë betejën ligjore deri në ndalimin e ndërtimit të H/C Skavica", - shkruante Zenel Hoxha, themeluesi i Aleancës, në faqen e tij në Facebook.

Burrat e protestës dolën në një fotografi së bashku - në pamje si besëlidhje, - që rezultoi në një përçarje shumë shpejt. Drejtuesit e organizatave akuzuan njëri-tjetrin për "tradhti".

PA BISEDIME

Deri më sot qeveria nuk ka lënë asnjë shteg të hapur se Skavica mund të mos ndërtohet. Ajo e ka bërë të qartë përmes ministres Balluku dhe zyrtarëve të tjerë se ky proces duhet të ecë përpara; madje është nënkuptuar se kush është kundër, është kundër "interesave të Shqipërisë". Me fjalë të tjera,



"Fakti që qeveria shqiptare është e angazhuar për ndërtimin e Skavicës, është një realitet i ri, me të cilin duhet të përballemi. Është një mundësi për të zgjedhur mes Dibrës dhe largimit prej saj, shpërbërjes së saj. Është një mundësi që jo vetëm të kërkojmë ndërtimin e rrugës "Lidhja e Prizrenit", por të kërkojmë edhe projekte të tjera me qëllim mosbraktisjen e Dibrës, ku vendin më të rëndësishëm në këtë paketë investimesh e zë ndërtimi i qytetit "Gjergj Kastrioti", në trojet autentike të Heroit Kombëtar. Është koha për të vlarë mendjen për ide e projekte, jo për të sulmuar idetë e njëri-tjetrit"

kush kundërshton dhe kush nuk është dakord, nuk është gjë tjetër veçse antishqiptar.

Ky është një qëndrim krejt dashakeq i përfaqësuesve të qeverisë. Kjo ka nxjerrë në pah arrogancën e qeverisjes, si dhe ka ngritur në nivelet më të larta përçmimin dhe fyerjen që u bëhet banorëve të luginës së Drinit. Sikur të mos mjaftonte kjo; ajo i mëson argumentit se një nga avantazhet e ndërtimit të HEC është shpëtimi i fushës së nënShkodrës; duke i trajtuar kështu në mënyrë të pabarabartë shtetasit e vet: ca duhen shpëtuar e ca duhen përmblytur e shpërgulur. Këta të fundit, madje, edhe si "antishqiptarë".

Përpjekjet për kundërshtimin e HEC Skavica deri më sot kanë dështuar, pasi me përjashtim të pak zërave, zyrtarisht protestat i kanë udhëhequr individë që nuk kanë parë dot përtej "shtëpisë së tyre". Nuk ka pasur një përpjekje për t'i bashkuar fuqitë dhe energjitë, argumentet dhe faktet që të vërtetojnë demin që HEC i Skavicës bën në Dibër.

Banorët nuk duhet të kenë asnjë droje për të qenë të hapur me të gjitha mundësitë për variantet e Skavicës, për t'u bërë më e mira për banorët dhe vendin. Është koha që banorët të bëhen bashkë, jo vetëm për ta kundërshtuar, por edhe për të kërkuar më shumë investime në të gjitha fushat e ekonomisë, në mënyrë që edhe nëse vendoset të ndërtohet, banorët nuk duhet të shpërgulen. Ata duhet ta ringrenë jetën e tyre rreth asaj toke dhe në ato troje. Braktisja e Dibrës nuk duhet të ndodhë.

Është koha të kërkojmë ngritjen e zërit të shoqërisë civile, mbështetjen nga organizatat mjedisore dhe ato që mbështesin liritë dhe të drejtat e njeriut.

OPINION

Dibra - referendum popullor për ti thënë JO Skavicës

Nga ABDURAHIM ASHIKU

Shans që nuk i vjen asnjë komuniteti në ditë zgjedhesh.

Armë e fortë në duar të Dibranëve për ti thënë me referendum popullor "JO SKAVICËS".

Dhe ky shans vjen më 6 mars, ditën kur Dibra do të votojë për kryetarin e saj të Bashkisë.

Në internet janë shfaqur emra, madje ndonjëri ka dalë në një portal me zë e figurë.

Një listë me pesë emra për paravotim ka dalë nga partia socialiste.

Nga të pestë njeri është veçuar si më i përshtatshmi...

Ka filluar beteja elektorale. Janë ngritur temperaturat edhe pse këto ditë ata shënojnë minus 20 gradë.

Në Skavicë, atë fshat të Kukësit që këto kohë ka qenë më i përfolur dhe i më nëmur se kurrë për digën që do të mbysë, do të zhbëjë përgjithmonë luginën e Drinit të Zi, luginën pjellore e historike si asnjë trevë tjetër, nga Gjorica në Skavicë, u bë më 19 janar 2022 protestë, një thirrje për ti thënë JO SKAVICËS...

Ajo shkëndijë në prag zgjedhesh duhet të shndërrohet në flakë, në një thirrje, një besa-besë që nuk është parë dhe dëgjuar ndonjëherë në Dibër përveçse kur i ka hasmi tek dera, kur serbi e ka dashtë të vetën luginën madhështore të Drinit të Zi e është ndalë nga pushka e bashkuar e dibranëve mbarë.

Ajo duhet të shndërrohet në një referendum popullor për ti thënë PO DIBRËS, JO SKAVICËS.

Shoqata ka ardhë koha ta thotë fjalën duke nxjerrë nga gjiri i vet një intelektual që si askush tjetër ka qenë në ballë të betejës për Dibrën siç e ka krijuar natyra.

Unë do të propozoja NJË, një njeri që i mbyten jo thjesht trojet fizike por shpirti i tij prej dibrani. Një njeri që betejën për Dibrën e ka filluar me protestën e tij për mbrojtjen e Radikës për ta vazhduar ditë për ditë e orë për orë për mbrojtjen e Dibrës.

Mendimi im është që në listë për kryetar bashkie, mbështetur nga shoqatat për mbrojtjen e Dibrës të jetë intelektual Munir Ramadan Hoxha.

Për të duhet të votojnë të gjithë ata që e kanë në shpirt Dibrën dhe e duan atë të bukur e të begatë siç bënte thirrje i ndjeri Murat Koltraka: LËRINI LUGINËN E DRINIT TË ZI TË BUKUR SIÇ E KA DHËNË ZOTI ("Po Dibrës! Jo Skavicës" faqe 106 - 113)

Ka ardhë koha që dibranët me votën e tyre të fshehtë, tu thonë JO kandidatëve që u ofrojnë partitë politike, ta japin një herë të vetme votën e tyre për Dibrën.

Ka ardhë koha që Dibrës ti dalë zani nga dritaret e ngushta të kullave në fushën e madhe ku trimëritë dhe puna është shkruar me gjak e me djersë si asnjë trevë e vendit.

Dhe kjo fushë për të, për të sotmen dhe të afërmen e saj, është 6 marsi 2022.

Kryetar bashkie në Dibër duhet të dalë një bir i saj. Ai që e donë me shpirt dhe e mbron me të gjitha mënyrat demokratike.

Me parullën demokratike "PO DIBRËS! JO SKAVICËS!", si një thirrje, si një kushtim, si një mesazh për brezat duhet të mbushet çdo ballë shtëpie, pallati, rrugë, rrugice, kodër, mali...

Dhe secili të shkojë para kutisë së votimit me vendimin ti thotë Dibrës "Të dua! Je imja dhe jam yti!"

23 janar 2022

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë. Komentet ose opinionet tuaja botohen bazuar mbi lirinë e gjithësecilit, pa qëllim fyerje apo denigrim të individëve apo grupeve të ndryshme shoqërore dhe politike. Për të botuar opinionin/komentin tuaj mund të na shkruani në <rrugaarberit@gmail.com>

"Stop Skavica" - thirrja që duhet të na bashkojë

Nga FERZILETA GJIK*
* Ferzileta Gjika është kandidatë për doktore të shkencave në Graduate Center City University of New York. Aktualisht ajo mban titullin Adjunct Assistant Professor, po pranë CUNY (Universiteti i qytetit të New York-ut)

Po bëj një përpjekje modeste për të folur në emër të bashkëatdhetarëve të mi dibranë, me shpresën për të rritur ndërgjegjësimin kundër ndërtimit të digës së Skavicës, e cila nuk është thjesht nocion i sakrificës së njerëzve për zhvillimin kombëtar, por paraqet dilemën për komunitetet lokale të Dibrës, që nuk janë konsideruar në vendimmarrje në lidhje me projektin famëkeq të Skavicës.

Sipas Komisionit Botëror për Digat (ECD, 2000: 1-2), "konfliktet mbi digat janë më shumë se konfliktet për ujë. Ato janë konflikte mbi zhvillimin njerëzor dhe vetë jetën." Janë mbi 35 fshatra që do të mbulojnë me ujë dhe mbi 60,000 persona të prekur nga diga e Skavicës do të shpërngulen. Ankesat e tyre shpërfillen dhe protestat e tyre thjesht njihen si grupe të vogla që shkaktojnë trazira politike.

Miratimi i një dige të madhe si ajo e Skavicës, pa marrë parasysh zërat e banorëve autoktonë, reflekton idenë se pushteti aktual shkel të drejtat e njeriut të përcaktuara në kushtetutë dhe në konventën e të drejtave të njeriut. Me avancimin e teknologjisë dhe shkencës, sot ka shumë mënyra të tjera për të marrë energji duke përdorur energjinë diellore apo energjinë e erës.

Ndërtimi i digës së Skavicës nuk ka një vlerësim të qartë për rezultatet mjedisore, e lëre më për pasojat socio-kulturale. Për banorët vendas të Dibrës, jeta e të cilëve është jashtëzakonisht e lidhur me tokën, ujë dhe burimet natyrore, zhvendosja e detyruar është më e madhe se humbja e aseteve financiare, si traditat, historia, kultura dhe identiteti i tyre. Shoqata për Mbrojtjen e Drinit të Zi është gjobitur si një mënyrë nga qeveritaret për të shuar zërin e komunitetit dibran. Historitë e ankesave të tyre mbahen të pashfaqura nga mediat e kontrolluara nga qeveria.

Diga e Skavicës shquhet si një nga konfliktet famëkeqe mes qeverisë shqiptare dhe banorëve vendas të Dibrës, për trajtimin e padrejtë të komuniteteve të prekura dhe për të krijuar dëme të pakthyeshme mjedisore. Ndikimet që rezultojnë përfshijnë shkatërrimin e të gjithë Dibrës si rajon dhe heqjen e Dibrës nga harta e Shqipërisë, duke shkatërruar kështu të gjithë komunitetin dibran dhe identitetin e tij. Zëri i komunitetit nuk është dëgjuar dhe as që janë përmendur se ekzistojnë në planet e Skavicës. Për ironi, qeveritarët kanë përmendur komunitetin e Kukësit që kanë marrë leje dhe kanë rënë dakord për ndërtimin e Skavicës, duke injoruar ekzistencën e 34 fshatrave të Dibrës që do të fundosin nën ujë. Ju bëj thirrje, jo vetëm komunitetit të Dibrës, por të gjithë shqiptarëve që të ndalojnë ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës. Ne nuk duam ti zëvendësojmë shtëpitë tona me digën e Skavicës. Nëse humbim Dibrën do të humbim përgjithmonë një pjesë të Shqipërisë. Kjo tokë është shtëpia jonë, kultura jonë, historia jonë identiteti ynë. Kjo tokë ruan mjedisin natyror, speciet e ndryshme dhe pyjet. Të parët tanë janë kujdesur mirë për të dhe ne do të vazhdojmë në të njëjtën rrugë. Sot duhet të jemi të gjithë të bashkuar për të luftuar projektin e digës së Skavicës në Dibrë të Shqipërisë. Ftoj komunitetet lokale, ambientalistët, studiuesit, mbrojtësit e të drejtave të njeriut, së bashku me të gjitha organizatat mjedisore kundër projektit të Skavicës.

Si komunitet i Dibrës, ne bëjmë thirrje që çdo studim i digave të reja të përfshijë mundësi të shumta për kontributin e publikut, shumë përpara se të kalojë në procesin



PETICION NGA KOMUNITETI SHQIPTAR NË AMERIKË

Peticion drejtuar:
Presidentit të Shqipërisë Ilir Meta,
Kryeministrit Edi Rama,
Ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë,
znj. Belinda Balluku

Zoti President, komuniteti shqiptaro-amerikan me qendër në New York, SHBA, i themi JO Digës së Skavicës dhe PO alternativave energjetike.

Projekti i Digës së Skavicës çënon proceset ligjore dhe kushtetutën shqiptare, është shkatërrues për mjedisin, shkatërron identitetin dhe kulturën dibrane dhe identitetin e popullit shqiptar dhe është kundër interesit kombëtar të vendit. Është krejtësisht e pakuptueshme se si mund të jetë dhënë një leje mjedisore për një projekt hidroenergetik në një shtrirje lumi me vlerë ekologjike dhe të rrallë sa ky i rajonit i Drinit të Zi!

PETICION KUNDËR NDËRTIMIT TË HIDROCENTRALIT TË SKAVICËS

Ne, shqiptarët e Amerikës, qëndrojmë kundër projektit të digës së Skavicës, sepse ky projekt:

1. Do të ndikojë në zhdukjen e identitetit dibran dhe atij shqiptar, bashkë me trashëgimet kulturore, historike dhe antike ku ndodhen rreth 60,000-110,000 shqiptarë nga Dibra [të njohur si dibranë].
2. Po përshpejtohet nga ana e procesit të saj ligjor, veçanërisht është mohuar e drejta e dibranëve për fjalën e lirë, paraprake dhe të informuar sipas Kushtetutës së Shqipërisë.
3. Nuk konsideron alternativa të tjera për sigurimin e energjisë në vend. Sot ekzistojnë alternativa më të mira sesa ndërtimi i hidrocentralit të madh të Skavicës dhe duhet të merren parasysh në planifikimin e projektit. Burimet e tjera të energjisë – që vijjnë nga era dhe dielli – janë provuar të jenë ekonomikisht konkurruese, mund të ndërtohen më shpejt dhe nuk përkeqësojnë klimën në vend.
4. Do të shkatërrojë biodiversitetin dhe habitatin e shumë specieve në më shumë se dhjetë mijë hektarë të qarkut të Dibrës dhe do të rrezikojë 60,000 banorë në rrjedhën e poshtme me rrezikun e përmytjeve masive, pasi kjo digë nuk mund të mbajë prurje të mëdha ujërash nga lumi;
5. Do të sjellë një kredi të panevojshme

zyrtar të rishikimit të qeverisë. Mundësitë e shumta për kontributin publik do t'i lejojnë publikut shqiptar të ekspozojë çdo supozim të gabuar në lidhje me vlerësimet e kërkesës dhe ofertës, si dhe çdo problem tjetër mjedisor dhe ekonomik, qoftë afatshkurtër apo afatgjatë.

Sipas shumë ekspertëve të energjisë së

prej 530 milionë eurosh nga SHBA, duke përkeqësuar më tej ekonominë tonë të zhytur në borxhe dhe do t'ju kushtojë trefish për ta mirëmbajtur.

6. Do të jetë e domosdoshme që çdo shqiptar, përfshirë edhe ata jashtë Dibrës, të mbajnë mbi supë borxhin.
7. Ka një jetëgjatësi të shkurtër për shkak të shkallës së lartë të sedimentimit në zonë.
8. Gjeneron kosto të larta të mirëmbajtjes së rezervuarëve dhe një jetëgjatësi relativisht të shkurtër, pasi ngarkesa e lartë e sedimenteve të grimcave të imta dhe të trashë do të mbushë rezervuarin.
9. Si pasojë e ndërtimit të hidrocentralit, Skavica do të ndikojë në rritjet e rrezeve të aktivitetit sizmik në qarkun e Dibrës.
10. Si pasojë e kostos shumë të lartë të mirëmbajtjes, mund të bëjë që qeveria jonë të dorëzojë territorin e Dibrës për të shlyer kredinë.

Në përputhje me këto rreziqe, ne, komuniteti shqiptar i Dibrës i bëjmë thirrje qeverisë shqiptare, konkretisht Presidentit të Shqipërisë Ilir Meta, Kryeministrit Edi Rama dhe Ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë Belinda Balluku:

1. Të bihet dakord për një periudhë kohore në muajt në vijim (janar - prill) të vitit 2022 për një rishikim të plotë të planeve aktuale të zhvillimit të hidrocentraleve në pellgun e lumit Drini i Zi.
2. Krijimi i një "Tryezë të rumbullakët shkencore të Skavicës" ku përfshihen ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë për të lejuar marrjen e vendimeve të informuara për çështjet kyçe të identifikuar në lidhje me pellgun ujëmbledhës të lumit Drini i Zi.
3. Ndiqni angazhimet politike dhe ligjore të Shqipërisë për të përmbushur konventat ndërkombëtare si dhe kërkesat e Bashkimit Evropian.
4. Të shqyrtohen alternativa të tjera energjia si ajo diellore, nga era, gjeotermale dhe të ndalohet kategorikisht ndërtimi i një hidrocentrali të madh në Shqipëri me përmasat si ajo e Skavicës.
5. Të dëgjohet zëri i banorëve të Dibrës që ndikohen drejtpërdrejt nga përmytja e vendit të tyre dhe fshatrave fqinjë të rajonit të Dibrës, identiteti, historia, kultura dhe shtëpitë e trojet e të cilëve rrezikohen të zhduken përgjithmonë.

30 dhjetor 2021

rinovueshme, sistemi i erës dhe diellit janë mënyrat më të avancuara, mënyrat më të mira të energjisë së rinovueshme, duke ruajtur mjedisin dhe duke shpëtuar lumenjtë dhe tokën tonë.

Mbështetja për një digë si ajo e Skavicës duhet refuzuar në mënyrë të konsiderueshme, sepse populli shqiptar duhet të

Dibra është në kërkim të një përfaqësuesi që mirëpret mundësitë për të deleguar dhe gjetur mënyra për t'i përfshirë të gjithë në procesin e vendimmarrjes dhe për të vlerësuar ndryshimin. Përfaqësues të tillë dëgjojnë dhe vlerësojnë synimet në lidhje me hyrjen dhe disponueshmërinë për reagime. Drejtuesit proaktivë krijojnë një mjedis të sigurt dhe mbështetës, duke nxitur punë krijuese dhe produktive ku dibranët ndihen të motivuar dhe të vlerësuar.

mbaj vetë barrën e ndërtimit të digave, si tatimpagues për të shlyer kredinë.

Kur zëri i dibranëve nuk është dëgjuar dhe është shuar qëllimisht, ky është një shqetësim kombëtar dhe nuk i përket vetëm Dibrës. Vlerësimi dhe konsiderimi i ideve dhe strategjive midis të gjitha organizatave dhe individëve që kontribuojnë në nismën "Stop Diga e Skavicës", është mjaft rëndësishme për vetë urgjencën e problemit në fjalë. Këto kompetenca thelbësore kontribuojnë në suksesin e të qenit lider për të bashkuar njerëzit për të njëjtin qëllim për projektin "Stop Skavica".

Dibra është në kërkim të një përfaqësuesi që mirëpret mundësitë për të deleguar dhe gjetur mënyra për t'i përfshirë të gjithë në procesin e vendimmarrjes dhe për të vlerësuar ndryshimin. Përfaqësues të tillë dëgjojnë dhe vlerësojnë synimet në lidhje me hyrjen dhe disponueshmërinë për reagime. Drejtuesit proaktivë krijojnë një mjedis të sigurt dhe mbështetës, duke nxitur punë krijuese dhe produktive ku dibranët ndihen të motivuar dhe të vlerësuar.

Është detyra jonë si dibranë, si shqiptarë, të mbrojmë tokën, shtëpinë, historinë, kulturën, identitetin dhe vendin tonë.

I ftoj të gjithë drejtuesit intelektualë dibranë të jenë të guximshëm, të ofrojnë ndihmë, t'u ofroni kohën dhe ekspertizën tuaj të gjithë atyre në nevojë. Përforsimi i të gjitha lidhjeve ekzistuese në planin e mbrojtjes së lumit Drin i Zi dhe krijimi i rrjetëve të reja me organizata të tjera të ngjashme mjedisore, krijimi i një platforme dhe një plani për të ndjekur dhe dokumentuar të gjithë hapat krijon një domozdoshmëri urgjente. Niveli i ndikimit të komunikimit përcaktohet nga aftësia jonë për ta përdorur atë.

Sfida për ndalimin e Skavicës, ekspozon domosdoshmërinë e zhvillimit të një pune të mirëfilltë dhe të koordinuar mes të gjithë njerëzve. Gjatë periudhave të tilla të vështira, është e domosdoshme që organizatat të ofrojnë hapësira të sigurt për të gjithë njerëzit për të diskutuar çështjet që i prekin. Fleksibiliteti dhe komunikimi janë mënyra kyçe për të forcuar qëndrueshmërinë individuale dhe të përbashkët, midis të gjithë anëtarëve dhe midis organizatave. Liderhipi intelektual mund të tregojë një përkushtim të vërtetë ndaj burimit të tij më të mirë – popullit tonë të Dibrës dhe ta dijë se këta njerëz duhet t'u besojnë vendimeve tuaja.

Vetëm të bashkuar mund të ndalojmë ndërtimin e Skavicës.

* Ferzileta Gjika është kandidatë për doktore të shkencave në Graduate Center City University of New York. Aktualisht ajo mban titullin Adjunct Assistant Professor, po pranë CUNY (Universiteti i qytetit të New York-ut)

Votuesit dibranë mund e duhet të dalin në zgjedhje me një kusht: heqjen zyrtarisht, me vendim të Kuvendit, ndërtimit të hidrocentralit të Skavicës. Pa këtë - votë nuk ka. Zgjedhje - nuk ka!

opinione

Asnjë në votim: Dibra Po! Skavica Jo!

Nga ABDURAHIM ASHIKU

Dibra do të ketë zgjedhje brenda dy muajve. Zgjedhje për kryetar bashkie. Lajmi po qarkullon nga Presidenca në Komisioni Qendror të Zgjedhjeve. Nga Meta te Celibashi. Nga Celibashi tek Meta...

Partitë politike ende janë pa zë, pa kandidatë, pa grupe patronazhistësh, pa çanta të mbushura me para për blerje votash... Heshtje si në tablonë "Qetësi në Shqipëri" të luftës Ruso-Turke...

Është shansi që Dibra ta thotë fjalën e saj. Të fortë e pa kompromis. Me një zë. Si një shekull më parë kur e hodhi serbo-jugosllavin në Drinin e Zi dhe ia mbushi shpinën me plumba. Jo me plumba e besa besë kundër shkajut, por me votë e me besa-besë për ta mbrojtur Dibrën, luginën e saj mbush me varre betejash të mëdha historike si 18 nga 25 betejat fitimtare të Gjergjit, të Gjon Dibranit

kundër pushtuesit otoman, betejash kundër serbit, nemces, italianit, gjermanit... Mbush me lavdi e krenari...

Dibra ka shansin që nuk i vjen dhe nuk do ti vijë më kurrë. Ka shansin ti thotë shtetit të vet, partive politike majtas - sot në pushtet e djathtas - dje në pushtet, parti që për të mbyl Dibrën që të shpëtojë Shkodra janë vënë si qetë në zgjedhje për ta shkullur nga themelet atë, për ti përdhosur varret, për ti harruar emrin.

Votuesit dibranë mund e duhet të dalin në zgjedhje me një kusht: heqjen zyrtarisht, me vendim të Kuvendit, ndërtimit të hidrocentralit të Skavicës. Pa këtë - votë nuk ka. Zgjedhje - nuk ka!

Për ndryshe - Dibër nuk do të ketë!

Mos e humbni këtë rast.

Dibra duhet të mbetet Dibër si e ka dhënë Zoti!

Athinë, 16 janar 2022

FEJTON

Vjosa - park kombëtar, Drini i Zi - çark... kombëtar

Nga ABDURAHIM ASHIKU

Dhe një zë që thërret: "Kryeministri që do të realizojë ndërtimin e Skavicës do të mbetet në historinë e Shqipërisë"

Edi Rama e mbyl Dibrën pa ju dridhë dora. Sigurisht në se në Dibër nuk ka mbet asnjë dibran.

Vjosa, bëhet e ditur sot, se u shpall Park Kombëtar, lumë që mbrohet jo vetëm nga shteti por edhe nga bota.

Si dashamirës i natyrës në çdo pëllëmbë të hapësirës mbarëshqiptare u përcjell respektin tim përmetarëve, tepelinasve, fierakëve, vlonjatëve..., për betejën dhe fitoren e tyre. Ata arritën që të shkulin nga themelet e ferro betonta, që tash më se dy dekada herë ngrihet një metër e herë ulen dy metra, hidrocentralin e Kalivaçit, dështimin katastrofë të kryeministrave të këtyre tre dekadave.

Dy dekada betejë publike, me zëra ndër-kombëtarë, me vikama, sa buçima e presidentit të republikës kapi "qiellin e shtatë"

Sikur të ndodhte kështu edhe me Drinin e Zi, me atë që pas mbyljes nga dy liqene të anën tjetër të kufirit shqiptaro-shqiptar, do të kishte edhe Dibra lumin e vet të egër. Dhe jo vetëm Dibra por edhe Shqipëria, edhe Ballkani, edhe Evropa.

Në Skavicë, fshat i Kukësit, në atë ngushticë që duket sikur takohen majat e maleve, ku Drini i Zi e ndjen veten më ngushtë se kurrë, një grup dibranësh që nga hurdha e re mbi Drin u mbyllet e kaluara, e ardhmja, historia, gjeografia, pasuria, varret e trimave që e mbrojtën si në asnjë trevë tjetër në betejat epike, Dibrën, duke u thënë ndal turqve osmanlinj me kordhëtarin e madh Gjergjin e Gjon Dibranit në krye dhe duke tharë përgjithnjë ëndrën serbe për të dalë në Drin e për të marshuar për ta prerë për brezi Shqipërinë me krismën-top të Eles Isufit... shkuan të mësojnë ecurinë e punimeve për ndërtimin e digës së Skavicës, digë e marrë përsipër nga një kompani amerikane private, me bekim zyrtar shtetëror të ministres Balluku, e cila vuri në plan të parë mbrojtjen e Shkodrës nga përmbytja dhe bekim diplomatik të ambasadores së SHBA në Tiranë Juri Kim.

Grupin nuk e lanë të afrohej atje ku punohej, atje ku gërmohej, atje ku Drini devijojë. Sekret i madh në natyrë të virgjër...

Ata, një nga një e thanë fjalën, argumentin dhe protestën e tyre në mbrojtje të vatrave familjare e të vatrës së madhe - Dibrës mbarë.

I përcollim me zë e figurë televizionin privat Tv. Dibra News i Islam Shehut.

Kaq.

Televizionet e portalet kombëtare shqiptare që nuk lënë lajm divorcesh pa përcjellë me zë, figurë e studio analistësh, nuk dhanë asgjë.



Po përgatitet mbytja e një treve të lashtë, asgjësimi i saj përgjithmonë dhe media shqiptar hesht. Asnjë zë nuk qarkullon se ku do të shkojnë ato dhjetëra mijëra dibranë që mbeten pa plëng e pa shtëpi. Askush nuk flet se sa do të shpërblehen pronarët për çdo metër katrorë të mbytur, për çdo shtëpi të zhytur. Askush. As ministria e financave, as ministria e bujqësisë, as kryeministri, as presidenti, as kryeparlamentarja, as bashkia. ASKUSH.

Po përgatitet mbytja e një treve të lashtë, asgjësimi i saj përgjithmonë dhe media shqiptar hesht. Asnjë zë nuk qarkullon se ku do të shkojnë ato dhjetëra mijëra dibranë që mbeten pa plëng e pa shtëpi. Askush nuk flet se sa do të shpërblehen pronarët për çdo metër katrorë të mbytur, për çdo shtëpi të zhytur. Askush. As ministria e financave, as ministria e bujqësisë, as kryeministri, as presidenti, as kryeparlamentarja, as bashkia. ASKUSH.

Ndërkohë që po i vija pikën e fundit, një zë kalon Atlantikun e ndalet e nja beh në "Dritarja Xhunga" e vikat: "Kryeministri që do të realizojë ndërtimin e Skavicës do të mbetet në historinë e Shqipërisë".

Dhe e kishte seriozisht me argumentin se si asistent i tij këtë e ka dëgjuar ta thotë "profesor Petrit Radovicka" (!).

Dhe menjëherë i vjen në ndihmë një komentator pa identitet "raul" me një thagmë që se mban asnjë kandar...

"Kryeministri legjendar i Shqipërisë për 27 vjet Mehmet Shehu kishte në tavolinë planin dhe projektin e Skavicës me firmën e prof. Dr. Petrit Radovicka, legjenda dhe krenaria e hidroenergjetikes shqiptare dhe e Universitetit Politeknik të Tiranës. Po të mos ishte vrratë Mehmet Shehu sot Shqipëria do të krenohej me veprën energjetike më të madhe në Ballkan (!), Skavicën, dhe Shqipëria do të ishte e garantuar deri në vitin 2100 me energji elektrike, bile edhe Kosova, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi dhe ndofta edhe Greqia (!)".

"Skavica nuk do të bëhet, komenton "DREJTËSIA". Nuk shuhet Dibra e dibranët, pa le se ç'thonë ata që se njohin historinë e Dibrës.

E vërtetë është se kryeministri që do të realizojë Skavicën do të mbahet mend në histori, por si kryeministër jo njerëzor.

Nuk rrihet Dibra me kamxhik zoti kryeministër. Dibra i ka rrënjët thellë në histori dhe do të mbetet historikisht Dibra heroike.

Nuk zhduket për kollaj ore jo."

Mehmet Shehu njihet në Dibër si kriminel i më i madh i saj, njeriu që shkrumboi deri edhe pulat në kotec në Fushë Alie e që tërë kohën nga gjuha e tij vetëm urrejtje për Dibrën dilte. Ai e mbyste Dibrën me dëshirën dhe egërsinë që e karakterizonte.

Sigurisht po ta kishte në dorë.

Edi Rama në këto dekada në pushtet ka treguar se din të shkullë, din të mbyllet. Ai e mbyl Dibrën pa ju dridhë dora.

Sigurisht në se në Dibër nuk ka mbet asnjë dibran.

27 janar 2022

VËZHGIM

Trishtimi që vjen nga gjuha...

Nga BASHKIM LAMI

Miqtë e mi, mundohuni të ndiqni shembuj pozitiv në shoqëri dhe mos u futni aty ku nuk dini, se dëmtoni rëndë edhe ato vlera reale tuajat, që ju ka dhënë Zoti!

Pse u trishtova kur lexova në një portal të dibranëve në FB? Portalet që shkruajnë për Dibrën dhe Bulqizën i lexoj me vëmendje. Bëj pëlqime dhe komentoj, por jo në çdo rast.

Këto ditë më shfaqet portali X që shtronte një pyetje dhe unë lexova dy komente të momentit. Aty për aty më shtyu dëshira për të kuptuar se si do të jetë reagimi i komentuesve. I lexova të gjitha komentet e replikat dhe kur përfundova mbeta shumë i zhgënjyer për nivelin e ulët të të menduarit dhe të të shprehurit të qytetarëve.

E para, në atë shumicë komentesh vetëm tre apo katër komente ishin të vlerësueshëm, që jepnin opinion me logjikë realiste, edukative e të shkruar me kujdes, që i lexova edhe për së dyti. Atëherë pyeta veten pse kaq pak mençuri në gjithë këtë shumicë pjesëmarrësish në këtë tavolinë debati.

Kjo gjendje mjerane e popullit tim është arsya kryesore, që ne jemi në shumë vite nën këmbët e mashtruesve, që na shkatërruan Atdheun, na përdhosën demokracinë e na morën lirinë, më të çmuarën që na duhet për dinjitet njerëzor.

E dyta, që mbeta i zhgënjyer ishte realiteti i hidhur, që në shumicë komentuesit ishin gjysmë analfabet, që për ti kuptuar duhej një përkthyes talent shqip - shqip. Disa raste nuk arrita t'i kuptoj fare se çfarë shkruajnë.

E treta, që më zhgënjoi pafundësisht ishte se në shumicë u kishte mbetur në gojë fjala "m....", sepse nuk kishin shkruar fjalë tjetër. Pyeta veten. Deri këtu ka mbërritur niveli i popullit tim? Vallë të jenë kaq shumë gjysmë analfabetë, që vetë "m...." ju paska mbetur në gojë, për tu mblaçitur.

Pikërisht këtë nuk do të doja kurrë të ndodhë për askënd, por veçanërisht për miqtë e mi.

Shyqyr Zotit, që shpejt u kthjellova, sapo mendova që aty nuk ishin futur fare të mençurit, sidomos dibranët që shquhen për mençuri. Para kësaj situatë mendja më thotë se kjo gjendje mjerane e popullit tim është arsya kryesore, që ne jemi në shumë vite nën këmbët e mashtruesve, që na shkatërruan Atdheun, na përdhosën demokracinë e na morën lirinë, më të çmuarën që na duhet për dinjitet njerëzor.

Së fundi, një thirrje për miqtë e mi. Ju jeni njerëz të mirë për vete dhe për familjet tuaja. Mundohuni të ndiqni shembuj pozitiv në shoqëri dhe mos u futni aty ku nuk dini, se dëmtoni rëndë edhe ato vlera reale tuajat, që ju ka dhënë Zoti!

(Marrë nga faqja në FB e autorit)

Dështimi ekonomik-financiar është më i dukshmi; pusi 9 konsumoi 26 milion e Euro nga rreth 14 milion të parashikuara në projektin fillestar dhe jo vetëm për shkak të një shpërthimi hidrogjeni shkatërrues që ndodhi në të. Këtë shifer unë e përkthej në rëndimin e kostos së mineralit me rreth 45 dollarë për ton krom të shitur.

Bulqiza sërish në udhëkryq



Miniera e kromit në Bulqizë. Foto: Mahir Jangulli

Pa mohuar dy arritje të bujshme të AlbChromit në Bulqizë, përfundimin e hapjes së traverbankut të Klosit dhe ndërtimin e pusit nr. 9 që mundëson shfrytëzimin e mineralit të pasur të kromit në nivelet 17-22 e ndoshta deri në nivelin 24 – veprimtarinë tjetër të saj do ta çmoja të dështuar.

Nga MARTIN CUKALLA

Nuk bëhet fjalë për krahinën a për qytetin, dhe as gjithë minierën që përfshin vendburimin e Kromit të Bulqizës. Këtu flitet për zonën veriore të Bulqizës, minierë që menaxhohej nga Grupi Balfin si pjesë e koncesionit të AlbChrome që nga viti 2007.

Ishte për t'u përhëndetur kalimi në dorë të biznesit shqiptar të degës më të rëndësishme minerare të vendit, asaj të kromit, me shpresën që ecuria do të ishte jo thjesht fitimprurëse për koncesionerin, por edhe për shtetin shqiptar, komunitetin bulqizak dhe punëtorët e minierës.

Dhe unë publikisht e përhëndeta.

Tani, thashethemi që qarkullonte tash sa vjet, vjen si lajm i trishtë se AlbChrome u shit tek grupi turk "Yldirim".

Pa mohuar dy arritje të bujshme të AlbChromit në Bulqizë, përfundimin e hapjes së traverbankut të Klosit dhe ndërtimin e pusit nr. 9 që mundëson shfrytëzimin e mineralit të pasur të kromit në nivelet 17-22 e ndoshta deri në nivelin 24 – veprimtarinë tjetër të saj do ta çmoja të dështuar.

Nuk do të kishte rëndësi asnjë vështrim i kësaj çështjeje, nëse nuk do të çmonim zonën "Bulqiza Veri" si të vetmen ku aktualisht nxirret krom nga blloqe minerare të pacënuar. Minierat e tjera që rrodhën nga copëzimi i Bulqizës e Batrës, e që numërohen mbi 50 të tilla, nxjerrin krom nga punimet e vjetra e zgjatimet e tyre, çka në termin minierar do të thotë që kemi të bëjmë me miniera në shuarje.

Për perspektivën e afërt, kjo përkthehet se po vjen një vit që prodhimi aty të ndërpritet.

Të shmangësh zonën veriore të Bulqizës nga prodhimi i kromit do të thotë të shmangësh perspektivën e prodhimit të kromit të pasur në vendin tonë. Dhe të mos harrohet se, me këtë krom janë të lidhura ngushtë dhe dy qendrat e metalurgjisë së tij: Elbasani e Burreli.

Nëse do vlerësohej që dështimi në AlbChrome lidhet me politikën, flitej se pas kësaj qëndron rënia e një politikani të lartë me interesa ekonomike në koncesion, nuk do përceptohej si dështim.

Dështimi ekonomik-financiar është më i dukshmi; pusi 9 konsumoi 26 milion e Euro nga rreth 14 milion të parashikuara në projektin fillestar dhe jo vetëm për shkak të një shpërthimi hidrogjeni shkatërrues që ndodhi në të. Këtë shifer unë e përkthej në rëndimin e kostos së mineralit me rreth 45 dollarë për ton krom të shitur.

Më tej mund të numërojmë si dështime:

- Shteti, komuniteti lokal dhe punëtorët nuk përfituan çka kishin shpresuar;
- Edhe disa problem teknike që lidhen me thellësinë kritike ku zhvillohet aktualisht shfrytëzimi, nuk gjetën zgjidhjet e përshatshme tekniko-ekonomike;

Dhe më e rëndësishmja.

- Kufijtë e trupit për të shtuar rezerva të reja të mineralit të kromit, nuk u shtynë në

Qeverisja aktuale dhe autoritetet lokale të Bulqizës kanë në dorë tani, (më pas do të jetë vonë, mendoj unë) ta ruajnë edhe për 15-20 vjetët e ardhshëm nivelin e prodhimit e të punësimit të sotëm në minierat e Bulqizës, ose aty në Bulqizë do shihen stoqet e gurëve që u nxorrën dikur nga galeritë, shtëpi të braktisura qytetarësh dhe do të lexohet një histori e përmbyllur kromi.

asnjërinë anë të kësaj pjese të vendburimit.

Grupi Balfin i dha duart AlbChrome dhe pak rëndësi ka tanimë, fitoi apo humbi nga "loja" me Bulqizën.

Rendësi kanë dy gjëra:

- Koncesionin e kromit e mori një firmë turke, dhe pa e paragjykuar, theksoj që Turqia është një nga tre vendet e para në botë me prodhim të konsoliduar të kromit të paktën në 70 vjetët e fundit.

Tregu i kromit vuan përherë jo pasojat e mungesës së tij në treg, por faktin që ka përherë tepërcë minerali, çka favorizon konsumatorët dhe vë në vështirësi shitjeje prodhuesit tanë edhe pse aftësitë metalurgjike të kromit shqiptar janë më të mira se ai që prodhohet tjetërkund.

Politika zhvillimi në burimet minerare të një vendi tjetër bëjnë, jo vendet që i prodhojnë ato minerale, por vendet që i konsumojnë.

Dhe së dyti:

- A po i kërkohet koncesionarit të ri një program gjeologjik kërkim-zbulimi për të përtërirë, nëse mundet, gjendjen e rezervave të kromit të pasur? Po marrëdhënia e tij me komunitetin dhe puntorët si do jetë?

Qeverisja aktuale dhe autoritetet lokale të Bulqizës kanë në dorë tani, (më pas do të jetë vonë, mendoj unë) ta ruajnë edhe për 15-20 vjetët e ardhshëm nivelin e prodhimit e të punësimit të sotëm në minierat e Bulqizës, ose aty në Bulqizë do shihen stoqet e gurëve që u nxorrën dikur nga galeritë, shtëpi të braktisura qytetarësh dhe do të lexohet një histori e përmbyllur kromi.

**Martin Cukalla është inxhinier i industrisë minerare, i cili për mëse 35 vjet ka drejtuar sektorët më të vështirë të minierave shqiptare nga jugu në veri të vendit. Ka një eksperiencë të madhe në fushën e shfrytëzimit të minierave, por edhe të drejtimit të tyre. Cukalla ka mbajtur detyrën e ish-zv. ministrit të Industrisë së minierave dhe ish-drejtor i Minierës së Bulqizës para viteve '90-të.*

<https://www.bulqizaima.al/serish-ne-udhekryq-bulqiza/>

BUJTINAT MIKPRITËSE



BUJTINA KONAKU I DIBRËS
Vendndodhja: Tomin Tel: 0692053492
E-mail: aminosalkurti@gmail.com



BUJTINA E JUFKAVE
Vendndodhja: Peshkopi Tel: 069 937 7337
E-mail: agro_zerja@yahoo.com



GUEST HOUSE SABRIU
Vendndodhja: Rabisht Tel: 069 511 4003
E-mail: guesthousesabriu@gmail.com



KULLA HUPI
Vendndodhja: Dushaj, Bulqize
Tel: 068 837 3793
E-mail: kullahupi5@gmail.com



BUJTINA ARBRI
Vendndodhja: Arras, Fushë-Çidhën
Tel: 068 650 6061
E-mail: markuvladimir@yahoo.com



GUESTHOUSE TERSHANA
Vendndodhja: Peshkopi Tel: 0218 20306
E-mail: bujtina.tershana@outlook.com



BUJTINA GOLECI
Vendndodhja: Rabisht Tel: 069 642 9888
E-mail: fitimgoleci1@gmail.com

Sokol Mati: Industria minerare do të goditet fort nga kriza e energjisë, disa subjekte mund të mbyllën

Tëksa kërkesa për lëndë të para në tregjet globale mund të ndikojë sektorin minerar global në përgjithësi, në Shqipëri është e vështirë të parashikosh zhvillimet e këtij viti.

Për ekspertin e sektorit minerar, Prof. Dr. Sokol Mati, 2021 ishte i vështirë për subjektet që operojnë në këtë lloj aktiviteti, edhe për shkak të klimës së biznesit të vështirë, me burokraci të shumta e legjislacion të mbivendosur.

Ai nënvizon se sektori i metaleve parashikohet të ketë rritje të lehtë të çmimeve, por ky efekt pozitiv do të shuhet nga kostoja e energjisë, e cila do të ndikojë thellësisht aktivitetin.

Si ishte viti 2021 për sektorin minerar në tërësi? Si u ndikua situata nga rritja e kërkesës për lëndë të para post-pandemi dhe çmimet?

Viti 2021, i parashikuar i vështirë nga vetë ecuria e vitit 2020 dhe nga fakti që për sektorin minerar, tashmë parashikimet me një luhajtje çmimesh larg logjikës normale të papashmeve bëjnë që të mos jesh realist, rezultoi pozitiv për një shumicë të madhe të subjekteve minerare.

Duhet nënvizuar, nga raportimet e 9-mujorit të vitit 2021, se për kompanitë e mesme dhe të mëdha, rezultoi me një bilanc të përmirësuar vjetor. Kjo falë ndryshimeve të qenësishme graduale, në rritje, të çmimeve të metaleve kryesore që ne prodhojmë si bakri, nikeli, dhe në nivele më të ulëta relativisht dhe të kromit.

Gjatë vitit u vu re një rritje e ndjeshme e prodhimit në bakër, me rreth 80% krahasuar me vitin 2020 (viti 2020 – prodhim mineral bakri 333715 tonë, koncentrat bakri 28181 tonë – burimi AKBN), shpresohet për 8-12% rritje në nikel (viti 2020 – xeheror hekur nikeli 432673 tonë – burimi AKBN), pasi gjithësi çmimet e nikelit, pavarësisht rritjes së tyre globalisht, nuk japin ndikim të drejtpërdrejtë të ne, pasi ne nuk kemi objektet tona përpunuese.

Ndërsa në krom, rritja e çmimeve, e qëndrueshme gjatë gjithë periudhës, bëri që sidomos kompanitë e mesme dhe të mëdha (sipas vlerësimit tonë) të rrisnin prodhimin në krahasim me 2020 (krom 626627 tonë, koncentrat kromi 30861 tonë, ferrokrom 53543 tonë – burimi AKBN). Përqindjet për kromin janë pak evazive, pasi një pjesë e prodhimit nuk është raportuar, ngaqë nuk është shitur ndikuar nga çmimet e ulëta për të mos u bërë subjekt i pagimit të rentës.

Gjatë 2021 u vu re që pothuajse gjithë kompanitë që vazhduan punën, vijuan dhe të shisnin me fitime të vogla, por të qëndrueshme, duke u munduar të mbulojnë humbjet e pësuar në periudhën e pandemisë. Situata ishte jo e njëjtë për kompanitë e vogla, duhet të kemi parasysh që gjatë vitit 2020, 217 subjekte (ku rreth 60% i përkasin kompanive të vogla të kromit) nuk prodhuan fare, ato nuk mundën të realizonin as investime dhe si të tilla, pavarësisht se nuk ka një raportim përfundimtar për 2021, pritjet që një shumicë e madhe e tyre të mbyllën. Disa prej tyre vazhduan të prodhonin gjatë 2021.

Për sa u përket subjekteve që punojnë në materialet ndërtimore, situata e tyre, në logjikën e ecurisë së sektorit të ndërtimit këto dy vite duhet të jetë pozitive. Por realisht, në vlerat e statistikave të raportuara, nuk vërehet ndonjë ndryshim i madh që të reflektojë numrin e madh të ndërtimeve në këto vite. Numri



Galeritë e kromit në minierën e Bulqizës. Foto: Sami Curri (bulqizaim.al).

i punonjësve, nga 5187 punonjës në 2020, ka shënuar rritje, falë rikthimit në prodhim të disa objekteve minerare të mbyllura.

Po për sektorin minerar shqiptar, çfarë është vënë re, a po fitojmë më shumë nga kjo panoramë e re, apo po humbasim?

Pavarësisht ecurisë pozitive të tremujorit të fundit të 2020 dhe të këtij viti, në sektor vihet re një ngërç i madh i shkaktuar nga vetë ne. Është e vërtetë që kemi fituar më shumë në disa sektorë dhe çmimet e metaleve na favorizuan, po ashtu dhe globalisht kërkesa që lëndët e para për metale është rritur, falë tendencës për energjitë e pastra.

Këto dy elemente nuk po përkthehen në veprime strategjike konkrete pragmatiste, afatshkurtër dhe afatmesme, për nxitjen e sektorit. Humbjet në biznesin minerar të dy viteve të fundit, me probleme të organizimit të strukturave të tij, kërkojnë nga strukturat shtetërore, mendësi të re në qasjen e tyre për përmirësimin e klimës së biznesit.

Përkundrazi, vërehet bashkëveprim i vonuar i strukturave përgjegjëse me biznesin. Gjatë vitin 2021 është vazhduar me hartimin e akteve ligjore, që mbivendosin njëri-tjetrin, duke bërë që kakofonia e ligjeve të cilat mbulojnë sektorin (legjislacion minerar, mjedisor, të taksave) të jetë një mjet në dorë të administratës.

Por, nuk ka qenë një mjet për të mbështetur sektorin dhe për të rritur të ardhurat prej tij, si për biznesin dhe për shtetasit shqiptarë, por për vendime arbitrare jo rrallë të jashtëligjshme, me shumë vështirësi për të gjetur zgjidhje administrative, apo dhe gjyqësore, si në aspektin e përfitimit të së drejtës, por dhe të afateve të saj, të cilat kanë shkaktuar bllokime jo të vogla të prodhimit minerar.

Mendësia e re që shprehet në dokumente strategjike apo diskutime të ndryshme nuk po përkthehet realisht në ndikim pozitiv. Mbështetja ligjore, e dhënë për përpunimin e metaleve nga të gjitha veprimet, apo masat e institucioneve shtetërore, nuk ka qenë e tillë, promovimi i burimeve të reja ende mun-

gon, dhe kjo vërehet në mosrespektimin e afateve të publikimit të planeve të zhvillimit.

Gjatë vitit 2022, efekti pozitiv i tregut të lirë të energjisë elektrike, në konceptin e një ekonomie të lirë, nuk do të sjellë avantazh për industrinë përpunuese të mineraleve, e cila, në strukturën e koston, energjinë e ka në nivelet 30-50% (pasurim, metalurgji).

Subjektet janë të papërgatitura, konkurrueshmëria në treg është shumë e vogël, niveli i çmimeve me ndryshim me herë, mund të çojë në mbyllje të objekteve përpunuese dhe në këtë mënyrë, dhe të minierave prodhuese, pasi produkti përfundimtar nuk do të jetë efektiv me gjithë rritjet e çmimeve të ndodhura globalisht, duke e bërë industrinë tonë minerare jokonkurruese për disa sektorë të saj.

A ka pasur interes për investime nga kompanitë? Po shitblerje, për shkak të pasojave që la periudha e pandemisë?

Në situatën globale të rritjes së çmimeve dhe kërkesës në rritje për xeherorë, sidomos për bakër, nikel, kobalt, nuk është vërejtur gjatë 2021 ndonjë interes real, i shprehur dhe i përkthyer në investime të reja. Efekti negativ i pandemisë i viteve 2019-2020 nuk u përkthye me një rritje të investimeve të reja në sektor. Përkundrazi, fakti që disa prej kompanive minerare synojnë të nxjerrin në treg të drejtat minerare me investimet e realizuara në to tregon që ka problematika në vetë ecurinë e sektorit.

Këto problematika fillojnë nga moszbatimi korrekt i ligjit, tendenca e zbatimit të urdhrat të eprorëve dhe jo ligjit nga administrata shtetërore, të mbivendosjes së ligjeve të fushave të ndryshme që lidhen me sektorin, promovimit të pakët, mungesës së vazhdimësisë në rivlerësim të potencialit tonë minerar sipas standardeve ndërkombëtare.

Zhvillimi i qëndrueshëm në gjykimin tim, kërkon: liri të zhvillimit ekonomik të bazuara në ligje; ligje, të cilat gjatë hartimit janë transparente, gjithëpërfshirëse, të mirëpërcaktuara, pa ekuivokë interpretimi,

jo të mbivendosur nga legjislacione të tjera, të qëndrueshme në kohë; ligje të miratuara me debat real dhe të zbatuar me rigorozitet nga institucione të qëndrueshme ligjore, që përbëhen nga një administratë e përzgjedhur me ligj, e qëndrueshme dhe e aftë profesionalisht, që respekton ligjin dhe jo urdhrat e porosistë.

Administrata duhet të punojë shumë në përmirësimin e klimës së biznesit, partneritetit dypalësh biznes – shtet, t'i mëshojë më shumë funksionit këshillues, orientues, mbështetës për biznesin në konceptin administrativ dhe teknik dhe jo thjesht të mbikëqyrjes dhe të vendimeve arbitrare.

Si e prisni vitin 2022, duke pasur parasysh se mungesa e lëndëve të para do të vazhdojë të ushtrijë presion mbi industri të ndryshme dhe zinxhirët e furnizimit të mbetën të paqëndrueshëm? Po çmimet?

Çmimet e metaleve do të jenë në këto nivele, ndoshta dhe më pak rritje, gjë e cila do të favorizojë sektorin e metaleve i cili gjithësi do të goditet fort nga çmimi i energjisë dhe këto dy ndikime që kundërshtojnë njëri-tjetrin e bëjnë të paqartë situatën.

Planet e investimit nga aktorët kryesorë të sektorit të metaleve po afrohen në kohë, dhe kjo ka efektet e saj dhe në rritje të punësimit. Po rritet vështirësia e gjetjes së personelit të kualifikuar, jo vetëm për shkak të largimeve masive nga zonat rurale, por dhe të nivelit të ulët profesional të inxhinierëve të rinj të nxjerrë nga shkollat tona.

Sektorët e tjerë të tregut vendas, kryesisht ata të materialeve ndërtimore, do të vazhdojnë të kenë një punë që qëndrueshme, mbështetur nga fakti i nivelit të ndërtimeve në vend, por dhe ato të eksporteve të gurëve dekorativë, në një kërkesë të rritur rajonale do të kenë rritje të qëndrueshme.

Marrë nga monitor.al.

Linku i botimit original:

<https://www.monitor.al/minerari-do-te-goditet-fort-nga-kriza-e-energjisë-disa-subjekte-mund-te-mbyllën-2/>

“Pavarësisht krimeve që mund të kishin kryer, edhe ata ishin njerëz, dhe të paktën pas vdekjes e meritonin të kishin një varr si të gjithë njerëzit e tjerë”

Varret e viktimave të komunizmit mbulohen nga stoqet e kromit

“Kampi i të burgosurve i hapur në vitet ‘50, me punën e detyruar të të burgosurve të tij, ndikoi fuqishëm në rritjen e prodhimit të nxjerrjes së kromit. Por qëndrimi i zyrtarëve të regjimit komunist ndaj tyre ishte dhe mbeti tejet ç’njerëzor”

Nga HYSEN LIKDISHA*

Dhjetëra ish të burgosur në kampin e Burgut të Bulqizës, që ndërruan jetë në rrugë natyrale ose për shkak të aksidenteve gjatë punës së detyruar në minierë, nuk u gjenden varret. Një numër i konsiderueshëm të burgosurish “ordinerë”, të dënuar nga regjimi komunist i kohës me punë të detyruar në minierën e Bulqizës, që vdiqën gjatë vuajtjes së dënimit, u varrosën në afërsi të burgut, pa as më të voglën mundësi identifikimi të varreve të tyre.

Inxhinieri gjeolog në minierën e Bulqizës, Jorgo Kola, që punoi 32 vjet në galeritë e kësaj miniere, tregon se kampi i të burgosurve i hapur në vitet ‘50, me punën e detyruar të të burgosurve të tij, ndikoi fuqishëm në rritjen e prodhimit të nxjerrjes së kromit. “Por, përkrah këtij kontributi të vyer që jepnin me punën e tyre të burgosurit, qëndrimi i zyrtarëve të regjimit komunist ndaj tyre ishte dhe mbeti tejet ç’njerëzor”, thotë inxhinieri.

“Të paktën 40 deri në 50 persona të burgosur në këtë burg – vazhdon të tregojë ai – të cilët vdiqën në rrugë natyrale ose aksidentalisht, varroseshin në afërsi të burgut gjatë natës në kushte misterioze dhe fshehtësi të plotë, larg syrit të njerëzve dhe të afërmit e tyre as që njoftoheshin, por e merrnin vesh kur vinin për t’u takuar me ta”. tregon Kola.

Puna ndër vite në galeritë e minierës, bëri që këta varre të mbuloheshin me sterile kromi, ku aktualisht pak gjurmë të këtyre varreve, për të mos thënë fare, mund të dallohen. Ndërkohë, ka pasur raste kur vdekjet e të burgosurve kanë ardhur edhe aksidentalisht, nga puna në galeritë e kromit. “Në një aksident të ndodhur në zonën jugore



Zona e parë krom-mbajtëse në Bulqizë. Foto: Sami Curri

Në fillim të viteve ‘90 shumë familjarë dhe të afërm të të burgosurve të regjimit komunist, që vdiqën gjatë vuajtjes së dënimit në Burgun e Bulqizës, kanë ardhur në qytezën e minatorëve për t’u interesuar për gjetjen e varreve të të afërmeve të tyre. Por, në asnjë rast një gjë e tillë nuk është mundësuar, pasi sterili i mineralit ka zhdukur përfundimisht çdo gjurmë të tyre.

të minierës – kujton inxhinieri Jorgo Kola – nga zjarri i rënë në një nga galeritë e thella të kësaj zone, humbën jetën 11 të burgosur që u dogjën nga flakët apo u asfiksuan nga

tymi. Por nuk u lejua që trupat t’u jepeshin familjeve të tyre për t’i varrosur”.

Sipas Kolës, i vetmi ndryshim në varrosjen e këtyre 11 të burgosurve ishte se u lejua varrosja e tyre në varrezat e qytetit të Bulqizës. Në fillim të viteve ‘90 shumë familjarë dhe të afërm të të burgosurve të regjimit komunist, që vdiqën gjatë vuajtjes së dënimit në Burgun e Bulqizës, kanë ardhur në qytezën e minatorëve për t’u interesuar për gjetjen e varreve të të afërmeve të tyre. Por, në asnjë rast një gjë e tillë nuk është mundësuar, pasi sterili i mineralit ka zhdukur përfundimisht çdo gjurmë të tyre.

Kërkimet e familjarëve vazhdojnë edhe sot. Në verën e vitit të kaluar, tregon inxhinier Jorgoja, erdhi një djalë emigrant në Angli që

kërkonte varrin e babait të tij. Vetëm sa e çova te zona e varreve, ku edhe ai vetë, thotë inxhinieri, u bind se gjetja dhe identifikimi i varrit të babait të tij ishte e pamundur.

“Pavarësisht krimeve që mund të kishin kryer, edhe ata ishin njerëz, dhe të paktën pas vdekjes e meritonin të kishin një varr si të gjithë njerëzit e tjerë”, thotë inxhinieri Kola, i cili i ka njohur shumë nga këta të burgosur të mbetur pa varr, pasi për dekada me radhë ka drejtuar punimet në galeritë e minierës së Bulqizës.

Marrë nga bulqizaim.al. Titulli është i redaksisë. Titulli i botimit original: “Stoqet e kromit në Bulqizë “fshijnë” varret e viktimave të komunizmit”

Pajtohu në gazetën **RRUGA E ARBËRIT** pranë çdo filiali të **POSTËS SHQIPTARE** në të gjithë Shqipërinë. Një pajtim vjetor kushton 600 lekë.

Mbështetja financiare përmes pajtimeve është mënyra e vetme dhe më e mira për një gazetë të lirë në shërbim të publikut.



Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit www.rrugaearberit.com. Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë. Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:

Raiffeisen Bank, Rruga e Arberit. Nr. Ilog. në lekë: 0010036640. IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

PAJTIMET TUAJA JANË E VETMJA MBËSHTETJE PËR TË RUAJTUR LIRINË DHE VAZHDIMËSINË E GAZETËS!

Një rast i rrallë, një shans që dibranët ti thonë me votë masive popullore JO SKAVICËS, jo zhdukjes përgjithmonë të luginës së Drinit të Zi, jo shuarjes së gjithçkaje që ka krijuar zoti e rob, me vullnet hyjnor, me gjak e me djersë, me përkushtim e sakrificë si asnjë krahinë e vendit të shqiptonjave.

Rasti është që në zgjedhjet 6 marsit Dibra popullore, nga Bllata në Draj Reç, nga Ilnica e Vasija e Kalasë së Dodës në Krej Lurë e Monasdre, të zgjedhë njeriun e vet që në krye të bashkisë të bëjë betejën epike për ta mbrojtur Dibrën.

Nga letërkëmbimet që kam bërë këto ditë nga mëngjesi në darkë vonë zgjedha njërin për tu hapë rrugë të tjerëve, letërkëmbimin me Dr. Prof. Nazmi Koçin, njeriun që më shkruan:

"Më mbytet Dibra, dhe Dibra është unike me fushë e malësi, kur dëmtohet një pjesë, dëmtohet e gjitha, kur vdes një pjesë ka vdekur e gjithë Dibra. Ne e dimë si kanë jetuar bashkë në luftë e në paqe, asnjëra nuk jeton dot pa tjetrën".

Abdurahim Ashiku

I dashur Abdurahim!

E lexova me vëmendje propozimin tuaj dhe jam plotësisht në një mendje me ju, "Për Dibrën".

Ka kohë që po matem të bëj një prononcim, por kam qenë i zënë me problemet e mia, megjithëse e kam të qartë se ky është sot halli me i madh i çdo dibrani që e quan veten të tillë.

Ajo që më shqetëson është qetësia olimpike e dibranëve. Mendoj se ka dy shkaqe:

Njeriëshhtë prej inteligjencës së tyre, që rrinë e mendohen para se të flasin me mençuri në kuvend.

Tjetri më duket disi naiv dhe ngjason me atë fabulën e "gomarit" që kur po e hante ujku, shpresonte se ishte nëëndërr. Mjerisht kjo nuk është eëndërr.

Mua personalisht e të parëve të mi nuk na mbytet asgjë nga kjo vepër. Por mbytet Dibra dhe Dibra është unike me fushë e malësi, kur dëmtohet një pjesë, dëmtohet e gjitha, kur vdes një pjesë ka vdekur e gjithë Dibra. Ne e dimë si kanë jetuar bashkë në luftë e në paqe, asnjëra nuk jeton dot pa tjetrën. Prandaj dhe argumenti se mbytet kaq ha tokë e preken nja 20.000 banorë që duhet të dalin muhaxhirë, nuk më duket i drejtë, pasi për mua preket e gjithë Dibra, arkeologjia, historia, kultura, ekonomia, popullsia dhe tërësia e Dibrës. E për këtë ti ke bërë një libër me plot argumente. Vetëm një pyetje prej Dibrani po ta bëj privatisht:

A thua ka lidhje edhe kjo vepër me Ballkanin e hapur?

Sistemi i mëparshëm me plot eksperience në ndërtimin e Hidrocentraleve e mbajti 50 vjet nësirtarëkëtë projekt. Por atëherë para se të mbytej Kukësi i vjetër, ishte ndërtuar Kukësi i ri dhe unë e kam parë këtë me sy në vitin 1976, kur një brigadë arsimtarësh dhe 2

Në emër të një qëllimi të madh e të një ideje fisnike, kemi mundësi të luftojmë dhe besoj se fitojmë. Ndryshe më mbetet të përmend fjalët e Elez Isufit në telegramin e tij dërguar qeverisë së Lushnjës në vitin 1921 kur zhvillohej beteja e Lan Lurës. Afërsisht ai thoshte "Qeveria juaj duhet të na ndihmojë në këtë situatë kritike, ndryshe "për mua plakun qenka thënë të vdes pa atdhe e pa erz".

Dibra është unike. Kur vdes një pjesë, ka vdekur e gjithë Dibra



mjekë shkua dy muaj në aksion në Fierzë. Ky nxitimi i sotëm, pa marrë asnjë masë, më duket aventurë. Prandaj kam dhënë një mendim modest:

"Ndërtimi i Digës së Skavicës duhet të fillojë nga baza".

Dhe nuk e kam fjalën thjeshtë për anën ndërtimore të një dige, por për gjithëkëtë proces. Ai duhet të fillojë atje, në bazë, me banorët e faktorët e interesit atje. Le të jetë zgjedhja e Kryetarit të Bashkisë, "kazma e parë" e themelit në bazë.

Të përqafoj dhe të mbeshtes përzemërsisht, jo vetëm ty, por në radhë të parë Dibrën historike dhe të lavdishme të trojeve shqiptare, brenda e jashtëkufijve e mbetem një ushtar në mbrojtje të saj.

Miku yt, Nazmi Koçi
Tiranë, 24 janar 2022

I dashur Nazmi!

Fjalët tuaja më ngrohën këtë mesditë athinase ku bie dëborë si në vakt në Peshkopi, në tërë Greqinë, në tokë dhe në ishuj.

Gjithnjë ta kam shënuar në kujtesën time fjalën tënde me peshë. As mua e as ty nuk na mbytet gjë Skavica por siç thua ti "preket e gjithë Dibra, arkeologjia, historia, kultura, ekonomia, popullsia dhe tërësia e Dibrës". Unë hodha në internet, ua dërgova me adresë elektronike shumë dibranëve (Ademi më inkurajoi i pari, ti i dyti), thirrjen time duke shënuar në fund "Unë e thashë fjalën time dhe u çlirova".

Është rasti që dibranët tu kthejnë krahët partive dhe ti hapin krahët e të marrin në gjë Dibrën. Për mua kandidati që kam paraqitur i ka të gjitha për të qenë kryetar bashkie e barrikadë për ti thënë jo Skavicës. Mjaftojnë një numër firmash (shoqatat janë të privuara në kandidimi në zgjedhje), një propagandë e fuqishme duke shfrytëzuar të gjithë resurset dibrane që e duan Dibrën. Edhe ata që nuk votojnë në Dibrë mund e duhet të bëhen agjitorë, tu kërkojnë njerëzve të gjakut e të miqësisë atje ti lënë partitë dhe të votojnë për Dibrën. Edhe unë, edhe ti, kemi njerëz që na e dëgjojnë fjalën. E di se do të hasim në një barrikadë të fortë. Patronazhistët dhe zyrtarët do të na kundërvihen me lloj - lloj epitete. Atyre duhet tu themi me urtësi që t'ia japin votën kandidatit të Po Dibrës. Vota është e fshehtë.

Të uroj i dashur një javë të mbarë, një javë që ngricat dhe temperaturat e ulëta nuk

janë asgjë përpara asaj që kemi përpara, mbrojtjen e Dibrës.

Është shansi i artë. Zgjedhjet e 6 marsit duhet të shndërrohen në referendum për ti thënë JO SKAVICËS

Pres zërin tënd intelektual të vikasë siç e ke zakon.

Abdurahim Ashiku

Athinë 24 janar 2022

I dashur Abdurahim,

Përhëndetje dhe uroj të jeni mirë së bashku me Natashën.

Më vjen mirë që jemi mirëkuptuar pasi përveç vlerave intelektuale, aq sa janë, na bashkon një mision i madh, të mbrojmë Dibrën, historinë dhe lavdinë e saj nga një ç'berje e mundshme.

Kur të kam shkruajta se dëshiroj që zgjedhja e Krye bashkiakut le të jetë "kazma e parë" e themelit në bazë e kam fjalën për atë themel të një Dige të madhe, më të madhe se ajo prej betoni që e përmbyt Dibrën, të një Dige të madhe të opinionit e të shoqërisë, që e mbron Dibrën. Që e mbron dhe e ruan atësiç ka qenë qëmoti dhe siç e mbrojtën me trup e me dhëmbë të parët tanë në ato luftëra të pa barabarta, prej të cilave nuk u epën kurrë.

Sot nuk kemi përpara ata lloj armiqsh me të cilët luftuan gjyshërit tanë, por kemi ca

"Më mbytet Dibra, dhe Dibra është unike me fushë e malësi, kur dëmtohet një pjesë, dëmtohet e gjitha, kur vdes një pjesë ka vdekur e gjithë Dibra. Ne e dimë si kanë jetuar bashkë në luftë e në paqe, asnjëra nuk jeton dot pa tjetrën".

Rasti është që në zgjedhjet 6 marsit Dibra popullore, nga Bllata në Draj Reç, nga Ilnica e Vasija e Kalasë së Dodës në Krej Lurë e Monasdre, të zgjedhë njeriun e vet që në krye të bashkisë të bëjë betejën epike për ta mbrojtur Dibrën.

prej nesh, aparatçikë, fodullë e axhaminj që kanë dalë në pazarin e politikës dhe bëjnë atë që thoshin dikur të parët "shesin qen e blejnë këlyshë".

Nuk e di nëse i ke lexuar dy shkrime të Dr. Ahmet Kamberit te Gazeta "Drita" që i analizon mjaft mirë bëmat e klasës politike të pas viteve 90-të.

Unë besoj se, pas propozimit tuaj, duhet të hyjë shpejt në lojë shoqata "Çidhna dhe Kastriotët" dhe shoqatat e tjera, për të mbledhur disa firma dibranësh që duhet të jenë, nëse nuk gabo, sa 1% e numrit të zgjedhësve për Kryetar bashkie. Pastaj të shpallet kandidati dhe lufta është e hapur.

Unë mendoj se në emër të një qëllimi të madh e të një ideje fisnike, kemi mundësi të luftojmë dhe besoj se fitojmë. Ndryshe më mbetet të përmend fjalët e Elez Isufit në telegramin e tij dërguar qeverisë së Lushnjës në vitin 1921 kur zhvillohej beteja e Lan Lurës. Afërsisht ai thoshte "Qeveria juaj duhet të na ndihmojë në këtë situatë kritike, ndryshe "për mua plakun qenka thënë të vdes pa atdhe e pa erz".

Mos e thëhtë "zoti" që ne dhe shumë tjetër si ne, të vdesin pa Dibrën. Dibra i ka paguar si askush haraçistorisë dhe nuk përballon më kafshime e gjymtime të reja.

Të përqafoj me mall

Nazmi Koçi, Tiranë, 25 janar 2022

Na ndiqni:



RRUGA E ARBËRIT

<https://www.facebook.com/gazeteerajonitteDibres>

www.rrugearberit.com

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugearberit@gmail.com

NJOFTIM PËR SHOQATA DHE ORGANIZATA JOQEVERITARE

Redaksia e gazetës vendos në dispozicion të shoqatave me fokus Dibrën dhe organizatave joqeveritare hapsira për botimin e veprimtarive apo studimeve të tyre.

Kostot e botimit për shoqata dhe OJQ-të janë me kostot e botimit të gazetës.

Për më shumë informacion telefononi

në numrin **0692068603** ose shkruani

email: rrugearberit@gmail.com

Ëndrrat e Lulzimit, nga bujqësia e blegtoria, deri te turizmi

Nga **OSMAN XHILI**

Është shumë vështirë të gjesh dikë nga fshati i Obokut, në Maqellarë e të mos jetë i dalluar në tregti, bujqësi e blegtori. Lulzim Abazi bën pjesë tek ky grupi i dytë i njerëzve, pra që i janë përveshur bujqësisë e blegtorisë dhe përpjekjet e tij ka kohë që kanë çelur lule e dhënë fruta të shëndetshëm. Secili prej nesh do të dëshironte ta kishte Lulzim në grupin e miqve të tij të nderuar, pasi nga njerëzit e punës vetëm mirësi e lumturi përfitojnë të tjerët.

Pas shumë vitesh në emigracion, Lulzimi kthehet në vendlindje, për të mos u kthyer më andej. A nuk i mjaftonte vallë vendlindja për të mbajtur dhe ushqyer familjen e tij? A nuk ishte toka e tij po aq pjellore, sa dhe ajo italiane? Vështirë të gjendej lloj fruti, apo perime që nuk prodhohej në fshatin e tij, madje shumë organike, pasi dhe vaditja bëhej me ujërat e kristalta të maleve, që ngrihen krenarë sipër fshatit.

FRUTA DHE PERIME

Një hektarë tokë Lulzimi e ka të mbjellë me pemëtore. Tre dynmë mollë të llojeve Starking, Grin Smith dh Jona Gold janë mbjellë para shtatë vitesh e tani janë në kuota maksimale. Po kaq sipërfaqe është e mbjellë me qershi dhe pjesa tjetër që plotëson sipërfaqen është mbjellë para tre vitesh me lajthi. Të gjitha këto janë një aset i çmuar i kësaj familje dhe pse shpesh tregu është i vështirë dhe problematik. Por as këtu frutat nuk kanë të mbaruar, pasi Lulzimi zotëron dhe dy zabele me gështenja dhe dushqe, ku krahas kuintalëve me fruta, ai siguron dhe drutë e dimrit për familjen e tij.

Kultivimi i perimeve është po aq i shtrirë në kohë për familjen e Lulzimit. Ai për çdo vit mbjell gati pesë dynmë me kultura të ndryshme. Këtë vit arriti të marrë 40 kuintalë patate "Agraria", shumë të shijshme e të pëlqyera nga tregu. Lulzimi prodhon 100 kuintalë domate të llojit "Ahmati". Ai i sistemon bimët në rreshta të gjatë, të sistemuar në katër kate, me një prodhimtari që e shpërblen mundin e bërë. Këtyre shifrave u shtohen dhe 50 kuintalë lakra të prodhuara, 40 kuintalë qepë, 5 kuintalë hudhra, kunguj e plot asortimente të tjerë. Duhet theksuar se këtë vit çmimet e shitjes për fermerin kanë qenë mjaft të leverdishme.



Falë dhe kësaj dukurie, pa frikë mund të themi se vetëm nga perimet Lulzimi fitoi gati sa rroga vjetore e tre mësuesve. Normalisht, është dashur shumë punë e sakrificë për të ardhur në këtë përfundim, por familja e bashkuar ka ditur të bëjë realitet synimet e fillimvitet.

SYTË DHE NGA BLEKTORIA

Që kur u kthye nga emigracioni, Lulzimi ndërtoi një stallë të madhe me sipërfaqe, 100 metër katror, ku futi 100 kokë dhen. Tetë vjet Lulzimi u shërbeu atyre dhe dhentë i shërbyen atij, duke i dhënë qumësht e qengja. Më pas e ndërpreu këtë aktivitet, jo se ishte i pakënaqur, por se donte të eksperimentojte me të tjera prova, për të parë rentabilitetin e secilit. Tre ose katër lopë janë gjithmonë prezente në stallën e tij, por ai dëshiron të ndryshojë strukturën. Mendon ti heqë ato dhe të marrë pesë apo më shumë lopë të racës Simental nga Kosova.

Lulzimi e kupton se terreni kodrinor dhe malor i fshatit të tij është mjaft i përshtatshëm për mbarëshkrimin e dhisë. Ai mendon të krijojë një tufë prej 50 kokësh si fillim dhe më pas duke parë e duke bërë.

Në udhën e vështirë të këtij biznes, Lulzimi ka pasur mbështetje familjen e tij, bashkëshorten e palodhur dhe dy djemtë, Albinin dhe Premtimin, që tashmë i janë bërë krahë dhe po ja lehtësojnë mjaft situatën. Atij i dhanë mbështetje edhe shumë fermerë të tjerë të Maqellarës, pa ndihmën e të cilëve nuk do ishin arritur këto rezultate.

Fondacioni "Agrinet Albania" me qendër në Korçë, ishte njëri prej tyre. Drejtori Tomi Pikuli, profesor Ylver Bylykbashi e shumë

Krahas bujqësisë e blegtorisë, Lulzim Abazi i ka hedhur sytë drejt turizmit. Të tre këto vektorë shkrihen e bashkohen në një të vetme dhe i shërbejnë njëri-tjetrit. Lart fshatit të tij Obokut, Lulzimi ka në zotërim një pronë të bukur prej gati gjashtë dynmë. Aty ka pyje, ka drunj ahu, drunj pishe, aty ka burim me ujë të kristaltë, aty ka agulice, hithra, mullaga, lisna. Ka dhe mollë e qershi të egër, kurse pak më lart shtrihet popullacioni i boronicës. Ideja e ngritjes së një bujtine në këtë vend, nuk është as e re dhe as e rastësishme.

të tjerë u bënë miq të ngushtë të fermerëve dibranë, duke u dhënë gjithë eksperiencën dhe teknologjinë për të arritur rezultatet e dëshiruara. Me ndihmën e tyre ata u



bashkuan në shoqatë, organizuan festa e takime të ndryshme, mësuan së bashku si të bëjnë trajtimet kimike kundër shumë sëmundjeve e dëmtuesve të tjerë. Përfituan eksperiencën nga pothuaj gjithë Shqipëria, por

jo vetëm. Vijuan me vizita në Kosovë, në Maqedoni, në Greqi e shumë vende të tjera.

Jo pak me interes për Lulzim dhe gjithë fermerët e Dibrrës ishte bashkëpunimi me organizatën "World Vision". Prej tij u përfituan fidanë arash, gështenjash, apo fidanë lajthish. Jo vetëm kaq, por dhe pula për vezë, arka frutash 20 kg dhe pompa spërkatëse ishin pjesë e këtij projekti.

Një tjetër fondacion u tregua shumë bujar për Lulzim dhe fermerët e tjerë dibranë. Bëhet fjalë për "Saredin" dhe koordinatorin e tij të shkëlqyer, ekonomistin Dali Horeshka. Lulzimi përfitoi një traktor tëri "Londin" me 50 kuaj fuqi, por do të thoshim që dhjetë fermerë të tjerë nga Maqellara e patën të njëjtën mundësi.

Të gjithë këta fondacione, organizata, apo miq të mirë e bujarë e bënë më të lehtë ecjen e Lulzimit dhe të fermerëve të tjerë drejt objektivave gjithnjë në rritje. Ata u dhanë të kuptojnë se kjo botë qenka shumë diverse, se nuk paska vetëm ujçer e tigrë, por dhe njerëz të mirë e me zemër të madhe, që dinë të dhurojnë nga pasuria e tyre, për ti bërë të tjerët të lumtur.

Krahas bujqësisë e blegtorisë, Lulzim Abazi i ka hedhur sytë drejt turizmit. Ndoshta nuk u shprehëm në mënyrën më të bukur, pasi krijuam idenë se dy të parat janë një gjë, kurse turizmi është një gjë tjetër. Në fakt, të tre këto vektorë shkrihen e bashkohen në një të vetme dhe i shërbejnë njëri tjetrit. Lart fshatit të tij Obokut, atje ku dushku i liron pa luftë vendin ahut, aty ku fillojnë livadhet alpine, Lulzimi ka në zotërim një pronë të bukur prej gati gjashtë dynmë. Aty ka pyje, ka drunj ahu, drunj pishe, aty ka burim me ujë të kristaltë, aty ka agulice, hithra, mullaga, lisna. Ka dhe mollë e qershi të egër, kurse pak më lart shtrihet popullacioni i boronicës.

Ideja e ngritjes së një bujtine në këtë vend, nuk është as e re dhe as e rastësishme. Që para katër vitesh Lulzimi kulloste këtu tufën e tij të dhentëve dhe shijonte bukuritë përralore të këtyre lartësive. Por nuk ishte i vetëm. Turistë çekë, polakë dhe italianë bashkoheshin hera herës, në mënyrë spontane, duke marrë në këmbim dashuri, mikpritje, besë dhe ushqimet bio të stanit. Që nga fshati i Popinarës deri këtu duhet hapur një rrugë vetëm pesë kilometra. Më tej disa shtëpiza guri, apo druri, një kuzhinier i mirë, që mund të jetë njëri nga djemtë e Lulzimit. Qumështi, mishi, djathi që pritet me thikë, mollët, arrat e plot asortimente të tjerë do tu serviren miqve që do të vijnë nga larg dhe nga afër. Ëndrra e Lulzimit nuk është larg, nuk është e perealizueshme. Vetëm pak guxim, pak vizion, pak ndihmë dhe ajo do të shndërrohet në realitet.

Dëshironi të **BOTONI PAK KOPJE LIBRI**, por nuk mundeni sepse shtypshkronjat ju kërkojnë të paguani për një tirazh të madh... Tani nuk është nevoja të prisni... **JU OFROJMË BOTIME NGA 1 KOPJE E VETME!** Njëlloj si në shtypshkronjë... Çmime të favorshme dhe shpejtësi! Telefono: **068 65 08 441** ose shkruaj email: **mbootime@gmail.com**

BOTIMET M&B
 mbootime@gmail.com
 069 20 68 603 / 04 22 33 283
 Të gjitha botimet tona mund ti gjeni pranë librarisë sonë në Tiranë në rrugën "Isa Boletini", pranë kryqëzimit të Selvia ose mund t'i porosisni online.
 Posta brenda vendit është **FALAS**

Më 13 janar në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes kolonel Bilbil Qazim Bitrit iu dorëzua grada e lartë "Gjeneral brigade", akorduar nga Presidenti i Republikës, z. Ilir Meta, me dekretin nr. 13409, datë 5 janar 2022.

Nga HAKI PËRNEZHA

Më 13 janar në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes u organizua një ceremoni zyrtare, ku kolonel Bilbil Qazim Bitrit iu dorëzua grada e lartë "Gjeneral brigade", të akorduar nga Presidenti i Republikës, z. Ilir Meta, me dekretin nr. 13409, datë 5 janar 2022.

Ceremonia e vendosjes së gradës u zhvillua në praninë e ministrit të Mbrojtjes Niko Peleshi, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, komandantëve të forcave dhe atyre mbështetëse, kolegëve dhe familjes së gjeneral brigade Bitri.

Në fjalën e tij ministri Peleshi u shpreh i gëzuar që në kuadër të procesit të promovimit të ushtarakëve me gradë madhore, Forcave të Armatosura dhe "trupës" së gjeneralëve të promovuar pak javë më parë i shtohet dhe një gjeneral brigade Bitri.

"Ishte një promovim i merituar. Në kuadër të Aleancës apo dhe në kuadrin rajonal kemi rol të rëndësishëm për të luajtur. Për këtë na duhet dije, na duhet forcë e kompletuar dhe përgjegjshmëri. Njerëz si gjeneral Bitri vijjnë në kohën e duhur, në vendin e duhur dhe në pozicionin e duhur. Respektoj kontributin jetësor të gjeneral Bitrit në Forcat e Armatosura dhe inkurajoj ushtarakët e tjerë dhe ato që tani rekrutohen të shohin këtë rrugëtim të suksesshëm dhe të motivohen", - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Gjeneral brigade Bitri, duke ndarë emocionet me të pranishmit në ceremoni, u shpreh se: "Përjetoj emocionet e një ëndrre tek e cila guxova të besoja. Nderin dhe privilegjin që më bëhet sot ia dedikoj një "liste" të gjatë njerëzish me të cilët më lidhin 36 vite në Forcat e Armatosura. Faleminderit atyre me të cilët kam punuar e punoj. Me kanë ndihmuar e mësuar të çmoj integritetin, virtytin dhe moralin. Kanë qenë e janë shembuj frymëzimi e lidërshipi. Më kanë dhënë besim, më kanë mbështetur e më kanë vlerësuar e për këtë ju jam edhe mirënjohës. Faleminderit familjes, në mënyrë të veçantë gjysmës time më të mirë Valbonës, që ka sakrifikuar për të ma bërë më të lehtë punën, por dhe djalit dhe vajzës që, megjithëse ju kam munguar, më falin".



Udha e një Gjenerali



Ministri i Mbrojtjes:
"Ishte një promovim i merituar. Në kuadër të Aleancës apo dhe në kuadrin rajonal kemi rol të rëndësishëm për të luajtur. Për këtë na duhet dije, na duhet forcë e kompletuar dhe përgjegjshmëri. Njerëz si gjeneral Bitri vijjnë në kohën e duhur, në vendin e duhur dhe në pozicionin e duhur. Respektoj kontributin jetësor të gjeneral Bitrit në Forcat e Armatosura dhe inkurajoj ushtarakët e tjerë dhe ato që tani rekrutohen të shohin këtë rrugëtim të suksesshëm dhe të motivohen".

Ky vlerësim solli gëzim jo vetëm tek të afërmit dhe familjarët e Bilbilit, por edhe në gjithë komunitetin e zonës së Çidhnës. Në historinë e gjatë të luftërave që Çidhna ka zhvilluar kundër pushtuesve të huaj, ka nxjerrë pafund komandantë e oficerë, të cilët, edhe pse pa shkollim ushtarak, herë pas here janë vënë në krye të sfidave luftarake dhe kanë shkëlqyer, por Gjeneralë nga Krahina e Çidhnës janë të pakët e Bilbili është njëri ndër ta, në gjoksin e të cilit, këto ditë, u vendos grada e lartë ushtarake.

Nderimi që iu bë ushtarakut të lartë Bilbil Bitri ishte diçka që pritej, nëse kujtojmë rrugëtimin e gjatë e të suksesshëm që ai ka pasur që nga vitet e shkollës së mesme në fshatin Fushë Alie (1985) e deri në shkollimin dhe kualifikimet e larta e specializimet e kryera deri në ditët e sotme. Rrugëtimin drejt dijes, pas përfundimit të shkollës së mesme, edhe

pse nuk ish zgjedhja e tij, e nisi në bankat e Akademisë Ushtarake "Skënderbej", të cilën e kreu me rezultate mjaft të larta. Menjëherë pas përfundimit të Akademisë Ushtarake Bilbili filloi karrierën në ushtri si komandant toge, por në zemrën e tij tashmë ishte ndezur dëshira për të

major Bilbil Bitri.

Kjo përvojë me paqeruajtësit në Irak do të linte gjurmë të thella në jetën profesionale të komandant Bitrit. Fusha ushtarake, që tashmë ai i ishte përkushtuar, ju shndërrua në pasion i cili shtohet çdo ditë e për këtë, ai, nuk do t'i ndahej ud-



thelluar studimet në fushën ushtarake. Dhe kjo dëshirë iu plotësua Bilbilit, i cili fitoi një bursë studimi në Akademinë Ushtarake në Ankara. Vitet kaluan dhe pas përfundimit me sukses të këtyre studimeve, Bilbili kthehet në Shqipëri.

Akademia Ushtarake "Skënderbej", ku ai kishte hedhur hapat e para si ushtarak e ftoi të fillonte punë si pedagog deri në vitin 2003, kohë kur ai kaloi me repartin Komando. Ishte koha kur në Irak dërgoheshin forca paqeruajtëse për të kontribuar në ruajtjen e paqes. Edhe Shqipëria do të kishte kontigjentin e saj në atë konflikt dhe komandant i misionit të 3-të paqeruajtës shqiptar u caktua

hës së dijes. Vjeshta e vitit 2006 e gjeti në auditorët e Akademisë së Mbrojtjes "Spiro Moisiu" dhe pas përfundimit të saj me rezultate të shkëlqyera, kolonel Bitri u përzgjedh nga Komanda Qendrore Amerikane si përfaqësues i Shqipërisë që do të merrej me koordinimin e veprimeve me koalicionin ushtarak.

Duke parë profesionalizmin e lartë dhe përkushtimin në punë si dhe aftësitë e tij në fushën ushtarake, Bilbil Bitri në vitin 2009 u emërua zv/përfaqësues ushtarak kombëtar në Komandën e NATO-s në Virginia USA. I ndodhur në mjediset ku përpunoheshin politikat e mbrojtjes së Aleancës më të madhe ushtarake,

Kudo ku shkoi e punoi Bilbil Bitri rrezatoi kulturë, korrektesë dhe profesionalizëm ndaj dhe rrugëtimi i tij drejt dijes do të vazhdonte...



Presidenti Meta dekreton dhënien e gradës madhore “Gjeneral Brigade”, Kolonelit Bilbil Qazim Bitri

DEKRET

**PËR
DHËNIE GRADE**

Në mbështetje të nenit 92 germa “d” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të pikës 3, germa “a”, të nenit 9, të ligjit nr.64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes me nr. 6308/1 prot., datë 31.12.2021,

Dekretoj

Neni 1

Kolonel **Bilbil Qazim BITRI**, me detyrë “Drejtor” i Shtabit të Përgjithshëm, në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, i jepet grada “Gjeneral Brigade”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

Nr. i Dekretit 13409
Tiranë, më 05.01.2022

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
ILIR META



Gjithë ky aktivitet brilant e i ngjeshur i ushtarakut Bilbil Bitri bëri që edhe Presidenti ta vlerësojë me gradën e lartë “Gjeneral Brigade”. Kjo gradë e lartë ushtarake tashmë nuk ndodhet vetëm në kraharorin e ushtarakut të nderuar Gjeneral Brigade Bilbil Bitrit, por edhe në zemrat e çdo banori të Çidhnës dhe Dibrës.

Kudo ku shkoi e punoi Bilbili rrezatoi kulturë, korrektesë dhe profesionalizëm ndaj dhe rrugëtimi i tij drejt dijes do të vazhdonte. Në vitin 2016-2017 ai fitoi të drejtën për të ndjekur Kolegjin e Luftës në USA, të cilin e përfundoi me sukses, duke fituar edhe “Master shkencor” në studimet strategjike.

Në revistën “Mbrojtja” të shtatorit 2018, kolonel Bilbil Bitri konsiderohet “...ndër ushtarakët më me eksperiencë” dhe më poshtë, po kjo revistë ushtarake vlerëson se koloneli zotëron “...eksperiencë të jashtëzakonshme dhe nivelin e lartë profesional...”.

Pas këtyre vlerësimeve dhe kualifikimeve të njëpasnjëshme, kolonel Bitri, emërohet Drejtor i BE-së dhe NATO-s në Ministrinë e Mbrojtjes. Pak më vonë, koloneli emërohet në Komandën e Forcave Tokësore e më pas Shefi i Shtabit të FT, detyrë që e vazhdoi deri në vitin 2019. Gjatë kësaj periudhe Bilbili kreu me sukses një tjetër Master Shkencor, tashmë në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Old Dominion University në Virgjina dhe UET. Menjëherë pas këtij kualifikimi kolonel Bitri u emërua Drejtor në Shtabin e Përgjithshëm e më pas Drejtor i Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm. Që nga janari 2021 kolonel Bitri kryen detyrën e Drejtorit të Shtabit të Përgjithshëm të FA.

Pas gjithë kësaj paraqitje të kolonel Bitrit, përmendim se në «gjoksin» e tij prej dekadash janë «mbërthyer» një numër i pafundëm medaljesh e dekoratash të dhëna si nga autoritetet shqiptare, edhe nga ato ndërkombëtare. Si njohës i mirë i disa gjuhëve, Bilbili është ftuar si lektor dhe ka referuar në shumë konferenca ndërkombëtare. Referimet e shumta në seminare, kurse, specializime në vende si Holandë, Gjermani, Turqi, Amerikë etj., janë shoqëruar me një numër botimesh të tij të karakterit ushtarak e strategjik.

Gjithë ky aktivitet brilant e i ngjeshur i ushtarakut Bilbil Bitri bëri që edhe Presidenti ta vlerësojë me gradën e lartë “Gjeneral Brigade”.

Kjo gradë e lartë ushtarake tashmë nuk ndodhet vetëm në kraharorin e ushtarakut të nderuar **Gjeneral Brigade Bilbil Bitrit**, por edhe në zemrat e çdo banori të Çidhnës dhe Dibrës, të cilët u gëzohen pafund sukseseve të bijve të tyre.

Rrugëtim të mbarë Gjeneral Bilbil Bitri!

Ky vlerësim solli gëzim jo vetëm tek të afërmit dhe familjarët e Bilbil, por edhe në gjithë komunitetin e zonës së Çidhnës. Në historinë e gjatë të luftërave që Çidhna ka zhvilluar kundër pushtuesve të huaj, ka nxjerrë pafund komandantë e oficerë, të cilët, edhe pse pa shkollim ushtarak, herë pas here janë vënë në krye të sfidave luftarake dhe kanë shkëlqyer, por Gjeneralë nga Kraha e Çidhnës janë të pakët e Bilbili është njëri ndër ta, në gjoksin e të cilit, këto ditë, u vendos grada e lartë ushtarake.



Në «gjoksin» e kolonel Bitrit prej dekadash janë «mbërthyer» një numër i pafundëm medaljesh e dekoratash të dhëna si nga autoritetet shqiptare, edhe nga ato ndërkombëtare. Si njohës i mirë i disa gjuhëve, Bilbili është ftuar si lektor dhe ka referuar në shumë konferenca ndërkombëtare. Referimet e shumta në seminare, kurse, specializime në vende si Holandë, Gjermani, Turqi, Amerikë etj., janë shoqëruar me një numër botimesh të tij të karakterit ushtarak e strategjik.

NATO-s, Bilbili kuptoi se karriera brilante e deritashme kërkonte plotësimin e studimeve në fushën së cilës tashmë i ishte përkushtuar.

Për këtë arsye, menjëherë pasi kreu me sukses detyrën në zyrat e NATO-s, u regjistrua në Kursin e Lartë të Oficerit në Akademinë e Forcave të Armatosura, të cilin, si dhe në rastet tjera, e përfundoi me rezultate të larta. Tashmë kolonel Bilbil Bitri ishte një ndër oficerët më të kompletuar që kish shërbimi ynë i FA-së, ndaj dhe Shtabi i Përgjithshëm i saj e emëroi Drejtor të Kabinetit të Shefit të Shtabit dhe pak kohë më pas Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit e Monitorimit të Mbrojtjes.

Historia e Skënderbeut apo përmendja e veprave të tij luftarake nuk mund të bëhet pa përkrahje, ku më shumë e ku më pak, nga autorë të ndryshëm aspektet e jashtme fizike apo karakterin e këtij Kalorësi të Madh.

histori

Humanistët e shekullit XV-XVI për figurën e Skënderbeut

Nga ILIA KARANXHA

Historia e Skënderbeut apo përmendja e veprave të tij luftarake nuk mund të bëhet pa përkrahje, ku më shumë e ku më pak, nga autorë të ndryshëm aspektet e jashtme fizike apo karakterin e këtij Kalorësi të Madh.

Marino Segono (? - 1486), si i pari biograf i Skënderbeut, në mos e ka njohur atë personalisht, fakt që ka pak të ngjarë, ka pasur mundësi të merrte informacione nga persona që kanë qenë fare afër Skënderbeut. Shkrimet e këtij peshkopi, në përgjithësi, nuk bazohen në burime të shkruara, por kryesisht nga kontaktet e ndryshme e të shumta me njerëzit.

Në atë kohë zona e Ulqinit, Tivarit me Manastirin e Rotecit, ishin shkelur shumë herë nga vetë Skënderbeu. Për më tepër, kishin kaluar vetëm 12-13 vjet nga vdekja e tij dhe nuk mund të ishte një punë e vështirë për një peshkop të mblidhte informacionet e nevojshme nga bashkëluftëtarë, të afërm apo dëshmitarë sympamës të Skënderbeut.

Veç këtyre kontakteve le të kujtojmë këtu martesat e sundimtarëve të Malit të Zi me familjet princore shqiptare. Stefano Černo- evič (? - rreth 1490) që ishte martuar me të motrën e Skënderbeut, Maria Kastriotin ndërsa i biri i saj Giovanni (ose Ivan) Černo- evič (1469-1514) kishte marrë për grua Jozafa Arianitin, pra motrën e Andronika Arianitit, d.m.th. gruan e Skënderbeut.

Në këto kushte është mëse normale që dëshmitarëve të Segonos t'u jepet një vlerë me e madhe në ballafaqim me shkrimet e mëvonshme biografike. Është Segono ai që na informon se në oborin e sulltanit, Skënderbeu edhe pse qëndronte si peng, "qysh nëntëmbëdhjetë vjet u bë sanxhak, d.m.th. udhëheqës i një kompanie kalorësish. E me që kishte pamje mbretërore u bë shumë i nderuar nga Murati..."


Në vazhdim Segono na flet për shpatën e Skënderbeut, që me një të goditur priste në mes një dem dhe se për të njëjtën shpatë ishte interesuar edhe vetë sulltan Mehmeti. Dëshmia duket se nuk ka qenë një legjendë qytetare dhe këtë fakt nuk do mungojë ta përmendë edhe Marin Beçikemi.

Në lidhje me trimëritë e forcën fizike të Skënderbeut vlen si fakt i vërtetë edhe nga dëshmia e pavarur që na ka transmetuar Marc Antonio Coccio Sabelico (1436-1506) mbi të atin e tij, i cili ishte krenar që e kishte parë personalisht Skënderbeun që "bënte trimëri aq të mëdha dhe aq të shumta sa që me të drejtë ai vetëm u kallte armiqve më shumë tmerr se gjithë kalorësia".

I njohur me këto dëshmi të drejtpërdrejta në të njëjtën hulli do të shkojë edhe humanisti ynë Marin Beçikemi - ndryshe Barleti (1468-1526), i cili si mjeshër i përshkrimeve, nuk do mungojë të na paraqitë pamjen fizike të Skënderbeut:

"Si peng tek turqit, ai ishte i admiruar nga të gjithë për shtatin e tij prej atleti. Ishte trup madh e i drejtë (si filiz), kishte krahë të tillë që nuk ishin parë kurrë në ndonjë burrë, më të hijshme, qafën e fortë dhe të qëndrueshme, ashtu siç shquhet mes lojtarëve të krahut, shpatullat me një gjerësi të mrekullueshme, ngjyra e bardhë, e fshehur poshtë mantelit të kuqërremtë, paraqitja e syve jo të tmerrshëm, jo të humbur por të këndshëm. Këto tipare ndihmonin shumë virtytet e tjera e duket që bënin të rritshin të mirat e shpirtit".

Ky përshkrim i detajuar nuk mund të quhet një krijim i fantazisë të humanistit tonë, por një përshkrim realist, i cili ishte fryt, jo vetëm i kontakteve me njerëz të një gjaku me Skënderbeun, por tashmë duket e evidente



se para botimit të veprës së madhe, ai kishte siguruar një portret origjinal të Skënderbeut, të ngjashëm me atë që ishte realizuar edhe tek kodi i Fenesteles në miniaturë, ku Skënderbeu, gjithashtu, ishte paraqitur vërtet me një "mantel të kuqërremtë".

Si veti shpirtërore, gjithmonë sipas Beçikemit (ndryshe Barleti), ai ishte fetar, shpirtmadh, i thjeshtë, me zakone të pre- ra, shpirtgjerë, i madhërishtëm e gazmor. Pastaj, përveç një urtësie të thellë, kishte një kurajo e guxim të jashtëzakonshëm, e një forcë shpirtërore e fizike të paarritshme. Skënderbeu kishte një karakter të nderur (në momente të këqija kafshonte buzën deri sa i dilte gjak), nuk mund të duronte plogështinë, ishte i etur për gjakun e armikut, mbi të cilët sulej me furi si ndonjë vetëtimë e i papërbajtur si vërshimi i përrënjeve.

Një burrë me gjithë këto cilësi të shkëlqyera ngjante, sipas të thënave të Beçikemit, një figurë pothuajse hyjnore, një "homo prope divinus". "Pa dyshim - shkruan albanologu i shquar F. Pall - shkrimtari ynë ka shkruar pak si larg duke na pikturuar këtë portret. E me gjithë këtë, po të kemi parasysh virtytet me të vërtetë të jashtëzakonshme të Shqiptarit, për të cilin flasin edhe burime të tjera, besojmë se humanisti nuk e ka tepruar shumë nga të gjitha anët".

Kështu, para se autori anonim i vitit 1541 (për të cilin kemi sugjeruar P. Giovio) të merrte penën e të shkruante jetëshkrimin që paraqitëm më lart, ky portretizim letrar i bërë nga autori shkodoran, të cilin e quan "Barletano", qëndronte mbi tavolinën e tij të punës. Nga ky historian anonim, për profilin fizik të Skënderbeut, kemi këtë përshkrim:

"Portreti i tij (i Skënderbeut) që i mahnitshëm e shumë i bukur, ai kishte një trup të madh e të rregullt, me gjymtyrë të fuqishme e të forta, i gjerë në shpatullat, me ngjyrën e lëkurës të bardhë, me sy të çiltër e të gëzueshëm, me hundë si të shqiponjës e në tërësi

i fortë e i shëndetshëm; me qenë se unë kam mundur të siguroj portretin e tij të vërtetë (al naturale3), nuk po zgjatëm më rreth kësaj (çështje) të them gjë tjetër..."

Në variantin e autografuar nga Giovio, të publikuar gati pas dhjetë vjetësh më 1551 e të përkthyer më vonë italisht nga L. Domenichi, portretizimi i Skënderbeut paraqitet pak ndryshe:

"Skënderbeu ishte kaq i lartë, me një trup me kaq shumë muskuj, me gjymtyrë aq të forta, me një hundë të kërcyer e të harkuar (por në mënyrë të hijshme) që përfaqësonte pa dyshim një hero të vërtetë. Dhe këtë paraqitje të bukur e konstatojmë se e kanë trashëguar akoma shumë pas tij zotërinjtë e kësaj familje, të cilët u vendosën në Pulje, siç mundëm ta shikonim nga krahasimi i atij portreti që ne kemi në Muze e në mënyrë të veçantë tek Ferrando stërnipi i tij Markezi i qytezës të Sant Anxhelos, i cili vdiq në ditët e Pavisë, i vrrarë nga dora e mbretit.

Dy dëshmitë në përshkrimin fizik të Skënderbeut nuk janë në kontradiktë me njëra-tjetrën dhe as me paraqitjen që na transmeton Beçikemi. Ndryshimet në këto portretizime letrare janë vetëm të karakterit sasior. Diku gjejmë më shumë informacione e diku më pak, por personazhi i përshkruar nuk ndryshon në imagjinatën tonë shëmbëlltoren e tij.

Del pyetja se kush është burimi i vërtetë i këtij përshkrimi, i kësaj njohje nga ana e Giovios? Veprat e shkruara apo piktura e portreti të tij, i cili përmendet në të dyja dëshmitë e mësipërme? Nga këto dëshmi duket një lidhje e ngushtë mes përshkrimin letrar dhe faktit se autori e kishte gjetur portretin "al naturale". Ndërkohë lihet të kuptohet tamam me ato karakteristika të fizikut të Skënderbeut. Pra lidhja mes portretizimit letrar e atij ikonografik është mjaft e ndjeshme. Në rastin e parë nuk përmendet Muzeumi, i cili ishte në fazën e rindërtimit dhe për trashëgimtarët

e Skënderbeut shënohet gjetkë se ata ishin vendosur në Terra d'Otranto në dukatin e Sanpjetros (Galatina), e cila ju dha si dhuratë nga mbreti i Napolit Ferante Kastriotit. Fakti vihet në relacion si një dëshmi e provë e meritave të Skënderbeut gjatë fushatës së tij në Itali.

Në dëshminë e dytë (publikuar më 1551) kur Giovio përmend Muzeun e trashëgimtarët e Skënderbeut duket se bëhet fjalë për të njëjtin portret, për të cilin kishte folur më 1541. Meqenëse jetëshkrimi i mësipërm qëndronte poshtë portretit, mbetet disi e paqartë në se informacioni mbi aspektin fizik vijon nga portreti, nga studimet apo kontaktet me familjarët e Skënderbeut nga ana e Giovios. Mund të merret sa njëra aq edhe tjetra. Ndërsa në rastin e parë përmendet nipi i vërtetë i Skënderbeut, më 1551 na flitet për një tjetër Ferrante Kastrioti i vrrarë në betejën e Pavisas, që ka ndodhur në fillim të shkurtit më 1525, e Giovio duhet ta ketë takuar e njohur atë përpara kësaj date kur këta Kastriotas u angazhuan totalisht në instancat më të larta të Curies Romane dhe tek Papa Leoni X për një çështje divorci të vëllait të tij Alfonso Kastrioti.

Gjatë qëndrimit të Giovios në Napoli gjatë viteve 1527- 1528 ai ka takuar apo dëgjuar edhe për të tjerë pasardhës të familjes Kastrioti: një Jovana (Giovanna) Kastrioti e cila ishte këshilltarja më e besuar e mbretëreshës. Për vashën e bukur Anxhela Kastrioti, që gjithashtu bënte pjesë mes damave më të zgjedhura që shoqëronin mbretëreshën në veprimtaritë e saj.

Kur Giovio përmend trashëgimtarët e Skënderbeut e aspektet e jashtme fizike të bukurisë së tyre, sigurisht që ka parasysh të gjithë këta persona që ka njohur por merr si prototip më 1551 Feranten (vdekur më 8.II.1525) mbasi ky me sa duket kishte fizik të lartë e të zhdërvjellët prej atleti si të Skënderbeut, e nga ana tjetër kishte fituar edhe një farë nami në oborret princore të Italisë. Nga burime të tjera mësojmë gjithashtu se edhe nipi i vërtetë Ferante Kastrioti (1479-1561) dukë në San Pietro (Galatina) ishte gjithashtu shtatlartë. Ky kishte mbetur një zotëri i provincës shumë më pak i njohur në nivel kombëtar se sa i pari. Bile, në vitet e fundit të jetës së tij, ishte larguar komplet nga drejtimi i dukatit duke u mbyllur në formë krejt private jetën e tij. Pikërisht me këtë Ferante ka qenë në kontakt edhe Marin Beçikemi, të cilit më 1522 i dedikonte veprën e Historisë.

Shtatlartësia e Skënderbut është konfirmuar dhe nga një dokument i gjetur dhe i publikuar nga At Valentini. Në këtë dokument me të cilin Skënderbeu i ishte drejtuar Signorisë të Venedikut shkruhet:

"Në lidhje me rrobat që, siç na është premtuar, do të na jepen dy herë në vit, ju lutem të më dërgoni rroba të përshatshme për trupin tim, ashtu siç ju janë dhënë edhe Zotërinjtë të tjerë, sepse thonë që mund të më mjaftojnë 16 krahë (rroba) për dy palë veshje. Mirëpo zotërinj llogarisni pak me kujdes se sa krahë më duhen për dy palë veshje aq jepmëni; sidoqoftë bëni ç'ka t'i pëlqejë Zotërisë Suaj në lidhje me rrobat që më duhen".

Në përputhje me këtë kërkesë nga ana e Skënderbeut, Venediku ja plotësoi në një farë mënyre dëshirën duke i dërguar 18 krahë rroba, ndërsa princërvë të tjerë shqiptarë vazhdoi t'u dërgonte nga 16 krahë rroba të kushtueshme, dy herë në vit. Sipas këtij fakti, At Valentini duke bërë llogaritë përkatëse (1 krah = 0.58 m) i bie që Skënderbeu të ishte i lartë afërsisht 2 m mbasi për të bërë një veshje shpenzonte gati 7.12 ml plaçkë.

(Marrë nga profili në FB i autorit)

Bellinit, detyra e piktorit zyrtar të Venedikut ju caktua më 1474, pra 6 vjet pasi kishte vdekur Skënderbeu. Aspekti tjetër është se Skënderbeu nuk ka qenë asnjëherë në Venedik. Kështu që, çfarëdo pretendimi për një portret të Skënderbut nga dora e Bellinin, është krejt i pamundur.

Bellinomania shqiptare

Nga ILIA KARANXHA

Qysh në kohën e Rilindjes Kombëtar Shqiptare, lindi ideja e realizimit të portretit të parë të Skënderbeut nga Gentile Bellini. Si pikënisje për këtë përcaktim, shërbeu një sugjerim i bërë nga antikuari dhe numismati i shquar austriak Friedrich von Kenner, i cili në veprën e tij "Koleksioni i portreteve të Princit Ferdinand von Tirol. Shqipëria", ff. 110-112, ("Die Porträtsammlungen des Erzherzogs Ferdinand von Tirol, Albanien, ff. 110-112), do deklaronte:

"Përputhet më së fundi gjithçka sipas praktikës të asaj kohe që Gentile (Bellini) që ngarkuar të pikturonte portretin e të famshmit shpëtimtar të kristianizmit, i cili në atë kohë pati raporte të ngushta (miqësi) me Republikën, ndërkohë që ai ishte vetë prezent në Venecia. Grafika e madhe e Bernardino Venezianit, portreti i Giovios dhe kopja jonë, janë ndoshta të lidhura me bocetin që ju bëri mjeshtri, kjo e fundit është pra me siguri më afër me origjinalin e kopjes tonë tjetër të Firences, e cila na ofron një ide të përafërt me luhatjet e ndryshimet e shumta në detajet prej ku origjinalet u ekspozuan nder kohë nga kopjues të ndryshëm.

Ky përcaktim i bërë qysh më 1898, entuziazmoi mjaft rilindësit tanë dhe nga ajo kohë, ka filluar ndjekja për të gjetur mes dhjetëra e dhjetëra portreteve me ngjyra që i janë bërë Skënderbeut, atë të Bellinit.

Në këtë rendje nuk kanë munguar as pseudopiktorë, që veprat e tyre me ndonjë portret të dobët, ti deklarojnë e ti shesin si një



Portreti i parë zyrtar origjinal i Gjergj Kastrioti Skënderbeut në një miniaturë të vendosur në kodin "De Romanorum Magistratibus" të shkruar nga Andrea Domenico Fiochio publikuar më 5/11/1465.

portret i Bellinit. Pra, belinomania në ambientin shqiptar, vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Përpara se të zbrisim te Bellini dhe te Skënderbeu, duhej së pari të sqarohet deklarata e bërë nga Friedrich von Kenner, të cilën pjesa më e madhe e belinianëve tanë as e njohin fare dhe, kush e ka njohur e ka pranuar pa asnjë vështrim kritik.

Von Kenneri thotë se: "sipas praktikës të asaj kohe që Gentile (Bellini) që ngarkuar të

pikturonte portretin e të famshmit shpëtimtar të kristianizmit". Në fakt, vërtet që ishte një praktikë e tillë e Venedikut për personat e shquar që e vizitonin, angazhonin piktorin e tyre zyrtar, mirëpo Bellinit kjo detyrë si piktori zyrtar i Serenisimës (Venedikut) ju caktua më 1474, pra 6 vjet pasi kishte vdekur Skënderbeu. Aspekti tjetër është se Skënderbeu nuk ka qenë asnjëherë në Venedik. Kështu që, çfarëdo pretendimi për një portret

Portretizimi më i parë i Skënderbut "dal vivo", i cili shërbeu më pas si gjenerues i gjithë ikonografisë kastriotjane ishte bëra para vitit 1465, kur Gerardo de Maffei për interesat e tij bibliofile, brenda mjedisve të Selisë së Shënjtë në Vatikan, kopjoi nga kodin i Fenestelles portretin e Skënderbeut. Ka qenë i njëjti portret që u përdor më pas në grafika e veprës monumentale "Histori e Skënderbut" nga Marin Beçikemi, e më tej edhe nga Paolo Giovio për muzeun e tij në Komo.

të Skënderbut nga dora e Bellinin, është krejt i pamundur.

Portretizimi më i parë i Skënderbut "dal vivo", i cili shërbeu më pas si gjenerues i gjithë ikonografisë kastriotjane ishte bëra para vitit 1465, kur Gerardo de Maffei për interesat e tij bibliofile, brenda mjedisve të Selisë së Shënjtë në Vatikan, kopjoi nga kodin i Fenestelles portretin e Skënderbeut. Ka qenë i njëjti portret që u përdor më pas në grafika e veprës monumentale "Histori e Skënderbut" nga Marin Beçikemi, e më tej edhe nga Paolo Giovio për muzeun e tij në Komo.

Pra, portretizimi më i parë i Skënderbeut ishte bërë brenda këtij mjedisi. Praktikisht, qysh në kontaktin e parë kur Skënderbeu vizitoi papën Nikolla V më 1453.

Sakrificat për të gjetur ndonjë portret të realizuar nga Gentile Bellini, janë të gjitha humbje kohe dhe mashtrime që kërkohet tu jepet ndonjë peshe, që as e meritojnë...

Mulliri me dy kate që shërben edhe si vend i shenjtë

Mulliri i Postovirës



Nga DRINI VLESHA

Mullirit i Postovirës është një mulli shekullor, i cili ndodhet në luginën e lumit Drini i zi. Ai është ndërtuar fisi Marku nga fshati Vrej (Kukës). Në ndarjen administrative i takon Kukësit, por në jetën shoqërore të atyre anëve, njihet si mulliri që bashkonte Dibrën dhe Kukësin, konkretisht fshatrat nga njësitë administrative Reç në Dibër dhe Arën në Kukës.

Mulliri u shërbentë të gjithë banorëve, dhe shpesh herë - tregojnë njerëzit, mullixhiu në disa raste ka shërbyer edhe si shkues. Duke qenë se në të bluanin banorët nga të dy krahinat, ai tregonte se kush ka vajzë e kush ka djalë për të martuar.

Njerëzit, duke pritur radhën në mulli, miqësoheshin me njëri-tjetrin dhe nga këto miqësi krijonin dhe krushqi. Tregohet se ndonjëherë bëheshin martesë që në djep, por edhe pa lindur akoma, që në bark. Martesa që në bark ishte atëherë kur dy persona kishin gratë shtatzënë, krijonin miqësi: nëse është e imja vajzë dhe i joti djalë dhe anas-



jelltas, na qoftë përhapër miqësia dhe fëmijët martoheshin kur mbushnin moshën. Nesë fëmijët ishin të të njëjtës gjini, nuk kishte martesë, por ngeleshin miq.

Mulliri është dy katësh, punon me ujë që rrjedh nga Burimi i Postovirës. Kati i parë është mulli për blurjen e drithit, ndërsa kati i dytë kishte funksion për prodhimin e shajakut (kashnikut), që ndryshe quhet Valanicë. Sot është shumë vështirë të gjesh një të tillë në Shqipëri.

Banorët tregojnë një histori për këtë mulli, që është shumë interesant.

Një hajdut nisat natën për të vjedhur

drithin që ishte në mulli. Pasi merr çfarë mundet, nisat për të ikur në shtëpi. Gjatë gjithë natës kishte ecur dhe në të zbardhur e gjen veten përsëri te dera e mullirit. I tronditur nga kjo, lë drithin dhe rrefehet te mullixhiu. I tregon të për vjedhjen e drithit dhe për udhëtimin që e ktheu prap aty. Pas kësaj ngjarje askush nuk vodhi më në mulli. Pas kësaj ngjarje vendi u konsiderua si vakëf.

Mulliri dhe valanica sot nuk punojnë, por në memorien e banorëve mbetet e veçantë. Nëse bëhet Skavica, nuk ka më mulli, ka thjeshtë "na ishte dikur një mulli me fshatrat për rreth tij".

Libri i ri

KËNGË
DHE
FJALË TË URTA
POPULLORE

I mbledhur dhe i përgatitur për botim
HAJRI SHEHU

BOTIMET M&B

Hajri Shehu
KËNGË DHE FJALË TË URTA POPULLORE
Botimet M&B
Çmimi: 1000 lekë

Krijimtaria gojore është, siç dihet, formë e ndërgjegjes shoqërore. Dhe, njëherazi, është edhe një lloj i veçantë arti. Kjo do të thotë se përmbajtja e çdo veprë folklorike (poezi, përrallë, anekdotë etj.) përcaktohet nga kushtet materiale të zhvillimit. Por, njëherësh ajo është shprehje estetike e marrëdhënieve reale historiko-shoqërore, e veprimtarisë së përditshme të njeriut, e jetës, e jetesës, e punës, e zakoneve dhe e traditave. Shpresojmë që në këtë tubë këngësh e fjalësh të urta popullore, të mbledhura në krahinën e Ujemujës të qarkut të Dibrës, lexuesi ta shohë këtë zhvillim dhe këtë shprehje estetike. Ato janë pjesë e kulturës sonë kombëtare. Shpresojmë, gjithashtu, që ato t'i rikthehen popullit si një mjet i vyer i kësaj kulture. Studiuesi Hajri Shehu është kthyer në vendlindje për së dyti herë. Herën e parë, me fjalën e Ujemujës. Tani, me krijimtarinë folklorike të Ujemujës.

Marrë nga libri "HISTORIA E DIBRËS" - Që nga lashtësia deri në mars 1939
i prof. dr. Kristo Frashëri. ISBN: 978-99956-04-82-0, Botimet M&B, Tiranë 2012

KUNDËR NDËRHYRJES JUGOSLLAVE

Nga akademik KRISTO FRASHËRI

(vijon nga numri i kaluar)


Megjithëse pati mjaft përfitime territoriale nga Konferenca e Paqes, qeveria jugosllave ishte e pakënaqur nga Traktati i Londrës. Ajo nuk kishte ndonjë kundërshtim në lidhje me premtimet që Traktati i Londrës i jepte Greqisë në Shqipërinë e Jugut. Shqetësimet e saj rridhnin nga përfitimet që siguroi Italia në Shqipëri. Me përfitimet që pati Roma në Shqipëri – aneksimin e krahinës së Vlorës kujdestarinë që fitoi mbi shtetin autonom shqiptar - Jugosllavisë i mbyllej rruga për të realizuar ëndrrën e madhe serbe – shtrirjen deri në lumin Shkumbin dhe daljen e saj në Durrës. Veç kësaj, me praninë e Italisë në Shqipëri, Roma i dilte Jugosllavisë në kufijtë jugorë, në një kohë kur po bëhej fqinje edhe në kufijtë veriorë, gjë që ishte e rrezikshme për Beogradin në një rast lufte me të. Si rrjedhim, duke përfunduar praninë e Italisë në Shqipëri, qeveria jugosllave jo vetëm krijonte një lloj qetësie në kufijtë e jugut, por në të njëjtën kohë, pastronte rrugën për ta nënshtruar vetë Shqipërinë.

Duhet theksuar me këtë rast se në lidhje me Shqipërinë qarqet qeveritare të Beogradit vëmendjen e tyre e përqendruan te dëbimi i ushtrive italiane nga viset shqiptare, kurse rezistencën shqiptare ndaj Jugosllavisë nuk e morën sa duhej në konsideratë. Në lidhje me Shqipërinë, shpresat e veta kryeministri serb Nikolla Pashiqi i vari te Esat pashë Toptani, i cili me marrëveshjen e fshehtë që kishte lidhur me të në Nish në qershor të vitit 1915, kishte premtuar të bëhej vasal i Jugosllavisë në shtetin që ai do të kryesonte në Shqipërinë e Mesme. Kryeministri serb mendonte se Esat pashë Toptani, i cili edhe pse ishte një figurë e urryer nga shqiptarët dhe se qëndronte në emigracion, mbasi nuk guxonte të kthehej në atdhe, i kishte të gjitha aftësitë politike për ta marrë në dorë pushtetin dhe për t'ia dorëzuar Shqipërinë pa luftë Jugosllavisë.

Megjithatë, qeveria jugosllave nuk i zbuloi menjëherë haptas kartat e saj. Sapo në Paris filluan punimet e Konferencës së Paqes, në janar të vitit 1919, qeveria jugosllave doli me një tezë, me të cilën dukej sikur mbronte interesat e Shqipërisë. Ajo e kundërshtoi Traktatin e Londrës dhe kërkoi që Shqipërisë t'i njihje pavarësi dhe plotë me kufijtë e caktuara më 1913, duke përdorur si argument se shqiptarët ishin të aftë të qeverisnin vetveten, prandaj nuk kishin nevojë për asnjë kujdestari apo mandat të huaj. Por në rast se kjo zgjidhje që shtronte qeveria e Beogradit nuk do të pranohet nga Fuqitë e Mëdha - atëherë Jugosllavia kërkonte që t'i jepeshin asaj viset e ashtuquajtura "serbe" të Shqipërisë Veriore duke u zotuar se do t'u jepte shqiptarëve të zonës së Shkodrës një autonomi administrative si atë që gëzonte minoriteti i sllav i Rutenisë në Austri. Vetëkuptohet se për qeveritarët e Beogradit, kreytrevja dibrane, e cila përfshijë në planet e tyre aneksioniste, ishte një territor plotësisht sllav.

Pretendimet e Jugosllavisë ranë kështu në kundërshtim me pretendimet e Italisë, e cila kërkonte që Traktati i Londrës të zbatohet tërësisht në dobi të saj. Për këtë qëllim, Roma kërkonte të aneksonte rrethin e Vlorës së bashku me ishullin e Sazanit dhe të merrte kujdestarinë mbi shtetin autonom shqiptar, i cili sipas saj, duhej të formohej jo në Shqipërinë e Mesme, por brenda kufijve të vitit 1913. Në këtë mënyrë ajo donte të përjashtonte si Jugosllavinë, ashtu edhe Greqinë nga çdo përfitim tokësor në kurriz të Shqipërisë. Pretendimet e Italisë dhe të Jugosllavisë ranë nga ana tjetër në kundërshtim me ato të Greqisë, e cila nguli këmbë për zbatimin pikë për pikë të Traktatit të Londrës, duke kërkuar aneksimin me çdo kusht të Shqipërisë së Jugut në favor të saj. Për të evituar kundërshtimin grek, Roma i bëri lëshime Athinës. Në verën e vitit 1919, Italia pranoi që me Akordin Tittoni - Venizellos, Greqia të merrte të ashtuquajturat vise greke në Shqipërinë e Jugut, kurse Greqia nga ana e saj pranoi që Italia të aneksonte Vlorën me hinterlandin e saj.

Zërin e dibraneve në favor të pavarësisë dhe tërësisë tokësore të Shqipërisë, e çoi në Konferencën e Paqes në Paris më 1919 Fuat Dibra, i cili kryesoi delegacionin e kolonisë shqiptare të Stambollit dhe e shpenzoi pasurinë e tij të konsiderueshme për të shpëtuar atdheun, njëkohësisht Dibrën, nga rreziku i copëtimit dhe i nënshtrimit. Madje, për hir të kontributit që ai dha, Fuat Dibra u ngarkua më 5 prill 1920 nga qeveria e Tiranës që të mbronin së bashku me Pandeli Evangjelin, delegatë zyrtarë të Shqipërisë, çështjen shqiptare në Konferencën e Paqes. Zëri i dibraneve në favor të pavarësisë së plotë të atdheut dhe tërësisë tokësore të Shqipërisë buçiti



Elez Isufi, kryetari i "Komitetit Kombëtar" të Arrasit

jo vetëm në Konferencën e Paqes në Paris, por edhe në Kongresin Kombëtar të Lushnjës, i cili u mbledh në fund të janarit 1920.

Në Kongresin e Lushnjës, Dibra u përfaqësua nga tre vetë: Ramiz Daci, Dine Maqellara dhe Dine Dema, të cilët përfaqësonin i pari popullsinë e Shehrit, i dyti Topalltinë, i treti Malësinë. Zgjedhja e delegatëve qe rezultat i një kompromisi që u arrit midis krerëve dibranë. Prej tyre vetëm Ramiz Daci përfaqësonte qarqet përparimtare demokratike dibrane. Dy të tjerët vinin nga paria çifligare e Topalltisë (Dine Maqellara) dhe ajo konservatore e Maleve (Dine Dema). Të tre delegatët e miratuan vendimin historik të Kongresit për të kundërshtuar çdo cënim tokësor të atdheut dhe çdo mandat të huaj mbi Shqipërinë. Por në lidhje me problemin e ndërtimit të shtetit shqiptar tek ata u dukën hapat e para të përcarjes së faktorëve të brendshëm. Një rol në këtë përcarje në trevën dibrane luajti Ahmet Zogu.

Ahmet Zogu ishte një figurë e njohur për dibranët. Ai njihje si biri i Xhemal pashë Zogut (biri i Xhelal pashë Zogut), pasardhësi i derebejve të Matit, të cilët tashmë qenë kthyer në pronarë çifligjesh. Në fillim të shekullit XX i ati i tij Xhemal pashë Zogu ishte për disa vite mytesarif i Dibrës. Si rrjedhim, edhe vetë Ahmet Zogu jetoi për disa kohë në Shehër. Si biri i mytesarifit, ai kishte zënë miqësi me bijtë e disa krerëve të Dibrës, moshatarë të tij, siç ishin Fiqiri Dine, Hysni Dema, Taf Kaziu, etj. Ai vajti në Kongresin e Lushnjës si delegat i Matit, rreth i prefekturës së Dibrës, duke e quajtur veten dibran. Për t'i forcuar lidhjet me parinë konservatore, Ahmet Zogu pak më vonë u dha fëmijëve të tyre – Fiqiri Dines (birin të Dine Maqellarës), Hysni Demës (birin të Dine Demës), Taf Kaziu, Muharrem Bajraktarit etj., bursa shtetërore për t'u shkolluar si oficerë të xhandarmërisë shqiptare. Qeveria shqiptare e Kongresit të Lushnjës, e cila së bashku me organet e larta shtetërore u vendos më 11 shkurt 1920 në Tiranë, korri me ndihmën që pati nga organizatat patriotike mjaft suksese në zbatimin e programit të saj. Krahinat e vendit filluan të bashkoheshin njëra pas tjetrës me qeverinë e Tiranës. Me kërkesën e saj, autoritetet qendrore i larguan ushtritë e tyre nga Shkodra më 11 mars dhe nga Korça më 26 maj 1920. Edhe autoritetet italiane i tërhoqën ushtritë e tyre nga shumica e viseve të pushtuara. Por nga ana tjetër, në vend që t'i transportonin në Itali, i përqendruan në rrethin e Vlorës dhe të Tepelenës. Përkundrazi, autoritetet jugosllave bënë veshin e shurdhër. Nuk i lëvizën asnjë hap ushtritë serbe nga lugina e Drinit. Krahina e Dibrës mbeti kështu si dhe ajo e Vlorës përsëri nën okupacionin ushtarak të huaj.

Shqipëria, e rrrënuar nga okupacionet e huaja ushtarake dhe me institucione shtetërore shqiptare të sapoformuara, nuk ishte në gjendje të përballonte në të njëjtën kohë një luftë të armatosur kundër tre shteteve fqinje. Për më tepër, qeveria shqiptare ishte ende në fazën e organizimit të forcave të xhandarmërisë. Për mungesë mjeteshe financiare ajo nuk kishte filluar akoma nga krijimi i ushtrisë kombëtare. Veç kësaj, ajo u detyrua t'i angazhonte forcat e saj të pakta për ndjekjen e bandave esatiste, të cilat, të nxitura nga qeveritarët serbë dhe tërthorazi nga agjentët italianë filluan ta kërcënonin Tiranën. Në këto rrethana, për forcat shqiptare u bë e qartë se çelësi që do ta zgjidhte lëshimin e ndërlukuar në të cilën ndodhej çështja shqiptare në arenën ndërkombëtare ishte

shpërthimi i luftës çlirimtare kundër ushtrive italiane. Kjo për arsye se, sipas qarqeve politike të Tiranës, po të dëboheshin ushtritë italiane nga Vlora, shfuqizohej në pikën më nevalgjike Traktati i Fshehtë të Londrës. Si rrjedhim, Beogradi dhe Athina nuk do të kishin të drejtë të kërkonin përfitimet që atyre u jepte Traktati. Megjithatë, qeveria shqiptare nuk donte të angazhohej ajo vetë në një luftë kundër Italisë, për shkak të pasojave diplomatike negative që ajo mund të kishte për çështjen shqiptare, qoftë nga dobësia ushtarake, qoftë nga reagimi ndërkombëtar. Me shumë të drejtë forcat patriotike shqiptare e gjykuan se në ato rrethana efektin më pozitiv në dobi të çështjes së atdheut do ta bënte lufta e organizuar nën formën e kryengritjes çlirimtare të vetë popullsisë së krahinës së pushtuar të Vlorës, kundër ushtrive pushtuese italiane. Barrën për të organizuar dhe drejtuar këtë kryengritje të popullsisë së pushtuar në rrethin e Vlorës kundër ushtrive italiane e mori përsipër Komiteti i "Mbrojtjes Kombëtare", i cili do të vepronte i shkëputur nga autoriteti i qeverisë së Tiranës. Madje, udhëheqësit politikë shqiptarë shpresuan gjithashtu se lufta çlirimtare e Vlorës, duke synuar dëbimin e ushtrive italiane nga Shqipëria, do të shihej me sy të mirë nga Beogradi dhe Athina, si rrjedhim, gjatë zhvillimit të saj, qeveritë jugosllave dhe greke nuk do ta godisnin mbrapa shpine Shqipërinë.

Në fakt, qeveria jugosllave në përputhje me deklaratat që kishte bërë në Konferencën e Paqes i dha të kuptonte qeverisë së Tiranës se nuk do ta bezdiste Shqipërinë në rast se ajo fillonte veprimet luftarake për dëbimin e ushtrive italiane nga Shqipëria. Por nga ana tjetër, ajo nuk mori asnjë zotim për të tërhequr ushtritë e saj nga e ashtuquajtura zonë strategjike, me të cilën ajo cilësonte krahinën e Dibrës. Kryeministri jugosllav Pashiqi mendoi se me luftën antiitaliane të shqiptarëve dhe me lëvizjen esatiste që ajo organizoi në Shqipëri punët po shkonin në favor të politikës së Beogradit. Por llogaritë e tij dolën të gabuara.

Në sajë të heroizmit popullor që treguan shqiptarët në luftën e Vlorës, e cila shpërtheu më 5 qershor 1920, u arritën fitore të mëdha, që as diplomacia e kancelarive të mëdha, as ajo e qeveritarëve të Beogradit nuk kishin mundur t'i parashikonin. Siç dihet, ushtritë italiane nuk u bënë dot ballë sulmeve të fshatarëve shqiptarë dhe u grumbulluan brenda pak ditëve në qytetin e Vlorës. Diskreditimi i qeverisë italiane qe kaq i madh, sa kryetari i qeverisë së Romës, Nitti, flamurtari i flaktë i aneksimit të Vlorës dhe i mandatit italian mbi Shqipërinë, dha dorëheqjen. Kryeministri i ri Xholiti (Giolliti) shpejtoi të deklaronte në parlament se kërkesa për vendosjen e mandatit italian mbi Shqipërinë ishte një gabim politik dhe se ky gabim mund të rregullohej vetëm duke përkrahur prijet e shqiptarëve për një shtet të pavarur kombëtar. Veç kësaj, sapo në rrethin e Vlorës Komiteti i "Mbrojtjes Kombëtare" shpërtheu kryengritjen e armatosur kundër ushtrive italiane – në rrethinat e Shijakut filloi nën komandën e Bajram Currit operacioni ushtarak kundër bandave esatiste, i cili përfundoi me likuidimin e tyre. Për më tepër, ndërsa bandat esatiste po likuidoheshin përfundimisht në zonën e Shijakut, në Paris Avni Rustemi likuidoi me atentat më 13 qershor 1920 aleatin e ngushtë të Serbisë, Esat pashë Toptanin. Më në fund, më 2 gusht 1920 Roma kërkoi me ngutësi të ndërprite kryengritja shqiptare, mbasi kishte vendosur të nënshkruante marrëveshjen për tërheqjen e ushtrive të saj nga Vlora. Pas këtyre veprimeve, dibranët prisnin me padurim sinjalin nga Tirana për të rëmber armët kundër ushtrive serbe, të cilat, në kundërshtim me premtimin, e kishin shtuar regjimin e terrorit në trevën e tyre.

Por, pas kthesës që ndodhi në politikën italiane ndaj Shqipërisë dhe pas likuidimit në të njëjtën kohë të lëvizjes esatiste së bashku me udhëheqësin e saj, qeveria jugosllave në vend që të mbante premtimin për tërheqjen e ushtrive të saj nga treva e Dibrës, shpejtoi të zbatonte sa më parë programin e vet ndaj Shqipërisë. Për këtë qëllim, që në korrik ushtritë jugosllave kishin ndërmarrë një sërë provokacionesh kufitare në zonën e Shkodrës dhe të Dibrës me shpresat se këto do ta detyronin qeverinë e Tiranës që të gjuhëzohej ndaj diktatit të Beogradit. Në zonën e Shkodrës, ku ndërhyrjet jugosllave qenë më të theksuara, shpërtheu patriotizmi popullor, i cili solli si rezultat shpartallimin e forcave intervencioniste jugosllave në Koplik dhe dëbimin e tyre jashtë kufijve të Shqipërisë. Disfata që pësuan në Koplik i detyroi qeveritarët e Beogradit që të ndërprisnin menjëherë provokacionet e tyre në zonën e Dibrës, duke u përqendruar përsëri gjatë lumit Drin, në të ashtuquajturin kufi strategjik. Megjithatë, në

valën e patriotizmit që tashmë kishte pushtuar mbarë Shqipërinë, popullsia dibrane nuk mund ta toleronte më qëndrimin e ushtrisë serbe në të ashtuquajturën vijë strategjike. Pas nënshkrimit të Protokollit të Tiranës më 2 gusht 1920, me të cilin Italia u detyrua t'i largonte ushtritë e veta nga Vlora dhe ta njihje Shqipërinë si shtet të pavarur me kufijtë e vitit 1913, qëndrimi i mëtejshëm i ushtrisë serbe në ultësirën dibrane u bë i pajustifikuar. Në këto rrethana, qeveria shqiptare jo vetëm nuk e ndali, por e pa të dobishëm aksionin e armatosur të dibraneve për çlirimin e trevës së tyre brenda kufijve të vitit 1913.

Si në rastin e Vlorës, edhe këtu meqenëse qeveria e Tiranës nuk donte ta merrte mbi vete përgjegjësinë e këtij aksioni të armatosur kundër ushtrive jugosllave - vendosi në heshtje që aksionin ta drejtonte një komision i posaçëm dibran. Për këtë qëllim, u mbledh në fshatin Arras të Çidhnës një kuvend i vogël i dibraneve. Kuvendi, i cili u mbledh më 13 gusht 1920, zgjodhi në analogji me Komitetin "Mbrojtja Kombëtare" të Vlorës një komitet lufte – "Komiteti Kombëtar" – të përbërë nga Elez Isufi, Ramiz Daci, Ramiz Dibra, Jashar Erebara, Dine Maqellara, Ismail Strazimiri, Selam Zhuka, Dervish Lusha dhe disa të tjerë. Për hir të kompetencave që mori përsipër për të ushtruar përkohësisht pushtetin politik dhe ushtarak në trevën dibrane, komiteti u quajt për autonomazi nga popullsia lokale "Qeveria e Arrasit".

Momenti politik ndërkombëtar për shpërthimin e kryengritjes çlirimtare ishte plotësisht i përshtatshëm. Në protokollin italo-shqiptar që u nënshkrua në Tiranë më 2 gusht 1920, Roma pranoi "pavarësinë e plotë të Shqipërisë", ashtu siç qe përcaktuar më 1913 dhe zotohej se nuk do të lejonte që askush tjetër të cënonte sovranitetin dhe tërësinë e saj tokësore. Si rrjedhim, në këtë protokoll, Roma hidhte poshtë si Traktatin e fshehtë të Londrës, ashtu edhe praktikën e zhvilluar brenda dhe jashtë Konferencës së Paqes. Duke shfrytëzuar këtë moment politik, Komiteti Kombëtar i Dibrës nën kryesinë e Elez Isufit vendosi më 13 gusht 1920 të shpërthente menjëherë kryengritjen e përgjithshme çlirimtare kundër ushtrive jugosllave.

Ashtu si në rastin e Vlorës, edhe në Dibrë para se të fillonin veprimet e armatosura komiteti i Arrasit i drejtoi një ultimatum komandës serbe në Peshkopi, me të cilën i kërkonte zbrazjen brenda 24 orëve të tokave që i takonin Shqipërisë. Siç parashihej, jugosllavët nuk u përgjigjën. Krisma e parë e kryengritjes filloi në Dibrën e Poshtme. Me thirrjen tradicionale "A bes a besë!" me mijëra malësorë, të udhëhequr nga Isuf Xhelili, nipi i Elez Isufit, në agimin e 16 gushtit 1920 sulmuan kodrat e Shumbatit, ku ndodhej reparti më i rëndësishëm i serbëve. Pas një ore luftimesh të ashpra, jugosllavët u shpartalluan, duke lënë rreth 100 të vrarë dhe gati 600 robër së bashku me armatimet dhe municionet e tyre. Pothuajse në të njëjtën kohë, malësorë të tjerë sulmuan me heroizëm repartet jugosllave të përqendruara në afërsi të Peshkopisë – në Pollozhan, në kodrat e Kabës, në Lisat e Trenës, ku u zunë të tjerë robër, të cilët gjithsej rreth 800 vetë (numri ndoshta i tepuar), u nisën në drejtim të Tiranës dhe më vonë, nëpërmjet Durrësit, u kthyen me anije në Jugosllavi. Të tmerruar nga furia e kryengritjes së malësorëve dhe nga përhapja e saj me shpejtësi në mbarë Dibrën e Epërme, ushtritë jugosllave e braktisën të gjithë "vijën strategjike". Në mbrëmjen e po asaj dite, kryengritësit arritën në vijën e kufirit.

Këtu malësorët dhe fusharakët dibranë, me gjithë porosinë kategorike të qeverisë së Tiranës dhe urdhrin e prerë të "qeverisë" së Arrasit nuk deshën të ndaleshin në kufirin e caktuar, ndonëse padrejtësisht nga Fuqitë e Mëdha. Disa kilometra tej kufirit dukej Dibra e Madhe, shkëlqetjen e së cilës nga trugu i Atdheut, dibranët nuk e përtypnin dot. Një tjetër "A bes a besë!" dhe kryengritësit hynë brenda në qytet. Me një rrëmujë të papërkrahur ushtritë jugosllave braktisën qytetin dhe zunë Grykën e Radikës. Kjo qe një fitore e shkëlqyer, e cila nuk përfundoi me protokoll.

Pala shqiptare shpejtoi t'i evitonte ndërlukimet. Që të nesërmen, më 17 gusht 1920, me presionin e "qeverisë" së Arrasit, kryengritësit u tërhoqën nga Shehri. Elez Isufi, me një deklaratë me shkrim që u lëshoi autoritetëve jugosllave, i ftoi të ktheheshin në Dibrën e Madhe, duke i garantuar se nga ana e shqiptarëve do të respektoheshin kufijtë e vitit 1913. Por qeveria e Beogradit, e tërbuar nga se po i fluturonte në erë platforma e "vijës strategjike", pruri përforcime të konsiderueshme për të ripushtuar me anën e një ofensive frontale tokat e humbura.

(vijon)

Dr. Nevruz Bara nderon punën, profesionin dhe detyrën e mjekut, por i bën nder dhe nderon dhe vendlindjen e tij, Dardhën dhe Dibrën.

Dr. Nevruz Bara, kirurgu me shpirt human

Nga SHAQIR ÇERPJA

Historia e Dardhës i ka themelet në heroizëm dhe në qëndresë heroike përballë armiqtë e pushtuesve të huaj. Në historinë epike të Dardhës ka themelet, buron e merr jetë arti, folklori, kënga dhe vallja. Dardha shquhet dhe është e afirmuar për art e artist. Dardha shquhet dhe është e afirmuar edhe për njerëz të dijes, intelektualë e profesionist. Njëri prej tyre është Nevruz Bara. Ai mësoi, studioi, punoi me shumë vullnet e këmbëngulje dhe ngjiti shumë suksesshëm shkallët e dijes e të karrierës profesionale. Me punë dhe nëpërmjet punës, duke punuar me pasion dhe përkushtim maksimal në shërbim të njerëzve, ai krijoi një profil të spikatur njerëzor dhe profesional dhe me shumë mirënjohje dhe respekt është çmuar e vlerësuar nga të gjithë njerëzit që e njohin, veçanërisht nga ata që u ka shërbyer dhe u shërben.

Nevruz Bara është biri i denjë dhe djali i bekuar i Dardhës dhe Dibrës, nga të cilat merr dhe të cilave u jep krenari. Ai u lind në pranverë të vitit 1962 në Zall-Dardhë. U lind, u rrit dhe u edukua në gjirin e një familje të thjeshtë, por shumë të respektuar e të nderuar, jo vetëm në zonën e Dardhës, por edhe më gjerë. Dy prindërit e tij, Ramadan e Xhilkë Bara, dy njerëz të dashur e dashamirës, të qetë e të urtë, shumë punëtorë, të papërtuar dhe të palodhur, punuan me shumë përkushtim dhe i rritën dhe i edukuan fëmijët e tyre me dashurinë për njëri-tjetrin, për njerëzit, për punën e shoqërinë. Dhe, fatmirësisht, të gjithë fëmijët e tyre u bënë shembullorë. Shembullorë në familje, në shkollë, në punë, në shoqëri.

Shkollën 8-vjeçare dhe shkollën e mesme i kreu në vendlindje me rezultate shumë të mira. Ishte djalë dhe nxënës i qetë, i urtë, i sjellshëm, i kulturuar dhe shumë korrekt. Ishte nxënës shembullor. Shembullor në sjelljet, shembullor në mësim. Rezultatet e larta në mësim, por edhe cilësitë e veçanta njerëzore, karakteri, vlerat e virtytet e spikatura njerëzore e ndihmuan, i hapën derën, shtegun dhe udhën për të vazhduar studimet e larta në degën e zgjedhur dhe më të preferuar, jo vetëm atëherë, në atë kohë, por edhe në këtë kohë, për mjekësi. Sigurisht, kjo nuk ishte një mundësi e shans i rastësishëm, por ishte një përzgjedhje e studiuar mirë dhe e konsultuar e dakortësuar midis organeve vendimmarrëse në bazë e në rreth. Ishte një vlerësim i madh për Nevruzin, por më shumë

Dr. Nevruz Bara ishte dhe është në krye e në ballë të punës, në ballë të vështirësive. Ai është korrekt, i përgjegjshëm, i përkushtuar dhe i papërtuar për t'u shërbyer njerëzve. Mendimet, fjala, këshillat dhe sugjerimet e tij përcjellin mirësi, japin e mbjellin shpresë dhe krijojnë besim.

I pajisur me dije dhe aftësi teorike e praktike, me eksperiencë e përvojë profesionale, në periudhën 2010-2015 vazhdon studimet plotësuese në Universitetin e Mjekësisë, ku merr gradën shkencore "Doktor shkencash".



se vlerësim për Nevruzin, ishte shans për njerëzit që do t'u shërbente Nevruzi.

Në periudhën 1982-1987 vazhdoi, kreu dhe përfundoi studimet e larta në fakultetin e mjekësisë të Universitetit të Tiranës dhe u diplomua mjek i përgjithshëm. U kthye në vendlindje, ku u emërua mjek në qendrën shëndetësore në Zall-Dardhë.

Ndonëse i ri, jo vetëm në moshë, por edhe në punë e profesion, ai e nisi punën me shumë dëshirë, punoi me shumë vullnet e përkushtim për të kryer detyrën, për t'u shërbyer njerëzve, banorëve të vendlindjes, dërnjanëve të Dardhës së tij, të Dardhës sonë, por edhe më gjerë. Dashuria për punën dhe profesionin, kultura e komunikimit dhe shërbimit, gadishmërisë për t'u shërbyer njerëzve kudo e kurdo, në çdo kohë, ditën e natën, jo vetëm në qendrën shëndetësore, por edhe në çdo fshat, në çdo lagje, shtëpi e familje, bënë që puna e tij të çmohej e vlerësohej shumë, ndërsa Nevruzi të respektohej nga të gjithë banorët, në të gjithë fshatrat e Dardhës, por edhe nga banorët e fshatrave përreth. Puna dhe përkushtimi i tij tërhoqi vëmendje dhe mori vlerësim edhe nga institucionet shoqërore e shtetërore në bazë e në rreth, të cilat e përzgjedhën Nevruzin,

që të vazhdonte e studionte më tej, për t'u specializuar, që t'i shërbente, jo veç vendlindjes, por edhe vendit e atdheut. Pas dy viteve punë të suksesshme në qendrën shëndetësore në Zall-Dardhë, Nevruzi iu dha e drejta dhe në periudhën 1990-1994 përfundoi studimet post universitare, ku u specializua kirurg i përgjithshëm. Sigurisht, në vetëdijen e tij prej intelektualit të formuar, studimet post universitare dhe specializimi për kirurgji, ishin një vlerësim i madh. Më shumë se shans për Nevruzin, ky ishte një shans për njerëzit që do t'u shërbente Nevruzi. Sigurisht, në vetëdijen e tij, ndjente përgjegjësinë e madhe, që kishte profesioni delikat i mjekut kirurg. Dhe, tek ndjenja e përgjegjësisë për pro-

Ajo që e dallon dhe e bën të veçantë, ajo që e bën personazh dr. Nevruz Barën, është zemërbardhësia dhe shpirti i tij human. Ai e ndjen në zemër dhe e përjeton në shpirt dhimbjen fizike të pacientit dhe vuajtjen shpirtërore të familjarëve të tyre. Dhe punon maksimalisht për t'u shërbyer atyre, pa asnjë dallim e paragjykim. Me punë të palodhur, me përkushtim maksimal dhe shërbim korrekt, dr. Nevruz Bara ka krijuar profilin njerëzor, intelektual dhe profesional.

fesionin e mjekut kirurg, niste dhe buronte dëshira, vullneti, energjia, përkushtimi dhe këmbëngulja e Nevruzit për të përvetësuar në rrënjë e themel, teorinë shkencore dhe praktikën profesionale, jo vetëm për të



justifikuar besimin e organeve shtetërore e shoqërore, por në radhë të parë, për të qenë i aftë, në lartësinë e detyrës dhe kërkesave të kohës, të punës e të profesionit, për t'u shërbyer njerëzve, jo vetëm me dëshirë, durim e përkushtim, por edhe me besim, siguri dhe kurajë profesionale.

Pas studimeve postuniversitare dhe specializimit për kirurg i përgjithshëm, emërohet mjek kirurg në Spitalin Rajonal të Lezhës, ku punoi në periudhën 1994-2016, plot njëzetë e dy vjet. Gjatë kësaj periudhë të gjatë pune dhe shërbimi në Spitalin Rajonal të Lezhës, krahas punës e shërbimit si mjek kirurg, ka kryer edhe specializime të ndryshme, punë e detyra të tjera. Në periudhën 2010-2016 ka kryer edhe detyrën e dre-

jtorit të Spitalit Rajonal Lezhë. Gjithashtu, në periudhën 2009-2013 ka qenë edhe anëtar i këshillit të bashkisë Lezhë. Ndërsa në periudhën 2004-2014 ka qenë edhe pedagog i jashtëm në fakultetin e shkencave mjekësore. Ka kryer specializime të ndryshme, brenda e jashtë vendit, si në Itali, Zvicër etj.

I pajisur me dije dhe aftësi teorike e praktike, me eksperiencë e përvojë profesionale, në periudhën 2010-2015 vazhdon studimet plotësuese në Universitetin e Mjekësisë, ku merr gradën shkencore "Doktor shkencash".

Gjatë punës shumëvjeçare në Lezhë, Nevruzi fitoi eksperiencë e përvojë, jo vetëm profesionale, shërbeu me përkushtim dhe dha kontribut të çmuar, jo vetëm për spitalin, por edhe për qytetin dhe krijoi profilin e një intelektualit të formuar, një profesionist të aftë e të përkushtuar, të një drejtuesi të zot e kompetent. Sigurisht, puna e gjatë si mjek, por dhe si drejtor spitali, e ka ballafaquar Nevruzin me shumë pengesa e vështirësi, me problematika të vështira dhe të ndërlikuara, por ai, me kurajë, me zgjuarsiri e mençuri, me kulturë e tolerancë, i ka përballuar, i ka kapërcyer dhe i ka zgjidhur me sukses.

Që në fillim të punës së tij në Lezhë, Nevruzi u ambientuar me punën dhe qytetin, u miqësia me qytetarët. Në Lezhë punoi, jetoi, shërbeu, fitoi përvojë, krijoi, ndërtoi e ngriti karrierën e tij profesionale, njohu njeriun e jetës e krijoi familjen e tij të re, rriti dhe edukoi fëmijë. Lezha e priti si djalë, si mjek dhe e përcolli si hero, por përsëri e pret si hero.

Pas një pune të suksesshme e jete të bukur në Lezhë, ku Lezha dhe Nevruzi lanë gjurmë të çmuara në jetën e njëri tjetrit, në vitin 2016 Nevruzi transferohet në Tiranë dhe emërohet e nis punë kirurg në spitalin "Shefqet Ndroqi" (sanotorium), ku punon me përkushtim dhe kurajë në shërbim të njerëzve, duke u ballafaquar me vështirësi, lodhje, mundim e stërmundim, duke qenë direkt i ekspozuar me rrezikun e sëmundjeve të ndryshme, veçanërisht me epideminë e korona virusit. Njëkohësisht është edhe pjesë e stafit akademik, pedagog në universitetin "Aldent". Nevruz Bara, në vitin 2018, ishte i pari mjek në shkallë vendi, që iu përgjigj thirrjes emergjente të Ministrisë së Shëndetësisë, për të shkuar e shërbyer përkohësisht kirurg në Spitalin Rajonal të Kukësit, ku mungonte mjeku kirurg.

Dr. Nevruz Bara ishte dhe është në krye e në ballë të punës, në ballë të vështirësive. Ai është korrekt, i përgjegjshëm, i përkushtuar dhe i papërtuar për t'u shërbyer njerëzve. Mendimet, fjala, këshillat dhe sugjerimet e tij përcjellin mirësi, japin e mbjellin shpresë dhe krijojnë besim.

Ajo që e dallon dhe e bën të veçantë, ajo që e bën personazh dr. Nevruz Barën, është zemërbardhësia dhe shpirti human i tij. Ai e ndjen në zemër dhe e përjeton në shpirt dhimbjen fizike të pacientit dhe vuajtjen shpirtërore të familjarëve të tyre. Dhe punon maksimalisht për t'u shërbyer atyre, pa asnjë dallim e paragjykim. Me punë të palodhur, me përkushtim maksimal dhe shërbim korrekt, dr. Nevruz Bara ka krijuar profilin njerëzor, intelektual dhe profesional. Modeli i tij i spikatur si njeri, si intelektual dhe si profesionist, i bën nder dhe nderon punën, profesionin dhe detyrën e mjekut, por i bën nder dhe nderon dhe vendlindjen e tij, Dardhën dhe Dibrën.

Dr. Nevruz Bara është njeri fisnik dhe mjek model, me shpirt human.

Dom Nikoll Kaçorri,
meshtari i Pavarësisë

libri i ri

Nga GËZIM LOKA

Në këtë hyrje dua të ju bëj me dije, të dashur lexues, se dëshira ime për të bërë një libër për Dom Nikoll Kaçorrin është e kahershme, mbase njëzet e pesë-tridhjetëvjeçare. Kam jetuar në Lurë me kujtimet për të, me imazhin e tij, me leximet për figurën e tij, me etjen e pashuar për të ditur gjithçka për këtë figurë emblemike të Lurës e të kombit shqiptar.

Sa më shumë thellohesha në jetën dhe veprën e tij, aq më shumë ndieja përgjegjësi për atë që do të shkruaja, i vetëdijshëm se ajo që mbetet në letër është një mesazh e testament mos'harrimi për sot e për nesër, për këtë lurian me shpirt të madh, që e ngriti Lurën dhe shqiptarinë në nivele të epërme të kujtesës historike.

Burimet e të vërtetave që më çojnë drejt kësaj figure janë të shumta, por unë kam zgjedhur një vështrim letrar për këtë ikonë të atdhetarisë, që vuri gjithçka në shërbim të kauzës së lirisë e të mëvetësisë së trojeve shqiptare.

Me emrin e Dom Nikoll Kaçorrit, meshtarit të Pavarësisë, zëvendëskryeministrit të qeverisë së Vlorës, lidhet një nga epokat më të ndritura dhe më të vështira të historisë kombëtare.

Me gjithë kontributin e madh në shpalljen e Pavarësisë dhe funksionimin e të parës qeveri shqiptare, emri i tij është lënë në gjysëmharresë dhe nuk i është dhënë merita që i takon.

Dom Nikoll Kaçorri u lind në Krejë, Lurë më 21 shkurt 1862, fshat ky që ndan dy krahina të mëdha: atë të Dibrës e Mirditës. Ai rridhte nga një familje, me babain katolik, ndërsa nëna me besim mysliman, duke promovuar atë që jo vetëm në Lurë, por në të gjithë Shqipërinë është modeli i bashkëjetesës fetare.

Falë zgjuarsisë dhe dëshirës për t'u shkolluar, djaloshi ra në sy të arkipeshkvit të Durrësit, imzot Ambrosio, i cili gjatë një vizite në Lurë, u kujdes që ta shkollonte dhe ta bënte meshtar.

Më 1884 mbaroi studimet filozofiko – teologjike për meshtar dhe u shugurua në Shkodër. Me kalimin e kohës kompletohet me shkollë të rregullt, kulturë të lartë, duke mbaruar në vitin 1890 në Zvicër për teologji, politikë, filozofi e magjistraturë me nota të shkëlqyera.

Ai ishte sekretar i Arqipeshkvisë së Durrësit me qendër në Delmnisht të Kurbinit, ku shërbeu për 20 vjet, duke patur në administrim edhe kishat dhe famullitë e Kthellës, Selitës dhe Lurës. Pastaj u emërua famullitar në Durrës.

Për veprimtarinë frytshme kishtarë, Papa i asaj kohe e nderoi me "Kryqin e artë", "Për Kishë dhe Papë". Emërohet l'peshkv dhe nisët me shpejtë – si për të kryer me përkushtim detyrën e lartë ipeshkvnore. Ishte ndër të parët në organizimin e shoqërive patriotike "Vllaznia", "Bashkimi" Durrës (1907-1909) dhe bashkëpunon me Abdi Toptanin dhe Mustafa Merlikën për rilindjen e Shqipërisë, arsimimin dhe gjuha shqipe.

Gjatë viteve 1905 – 1907 drejtoi kryengritjen e armatosur kundër turqve në Kurbin.


Më 1908, Kaçorri mori pjesë në Kongresin e Manastirit dhe në 1909 ishte në Kongresin Kombëtar të Elbasanit.

Dom Nikoll Kaçorri ishte në krah të Ismail Qemalit si nënkryetar i qeverisë shqiptare.

Lura ishte jo vetëm vendlindja e tij e dashur, por krahina ku fokusohet shqetësimi i tij atdhetar; kontaktet me Lurën i mbajti gjatë gjithë jetës.

Kudo në rrugëtimin e tij vjen si imazh Lura, drejt së cilës udhëtonte kohë pas kohe, çmallej dhe mbushej me frymëzim për veprat e tij të mëdha në lëmin e atdhedashurisë. Ky rilindjas i kthjellët, e deshi Lurën

Lura dhe Dom Nikoll Kaçorri



me pasionin e gjakut dhe lëkurës së tij, e kishte Lurën nën lëkurë, pjesë të gjakut dhe përkushtimit të tij të epërm atdhetar.

Me Lurën, vendlindjen e tij, lidhet emri i një ikone të pavarësisë dhe të shtetit shqiptar, Dom Nikoll Kaçorri, prifti e patrioti shqiptar, një figurë kryesore në lëvizjen kombëtare për pavarësi të shqiptarëve nga pushtuesi otoman.

Lura ishte vendi i rrënjëve të tij, gjaku dhe ashti i tij, frymëzimi dhe përkushtimi, të cilin e ushqeu gjer në fund me frymën e tij një rilindasi të shquar.

Emri i Dom Nikoll Kaçorrit është përmendur jo rrallë edhe gjatë viteve të komunizmit, duke i dhënë vendin që meriton këtij kleriku katolik në panteonin e figurave të shquara të kombit shqiptar.

Çdo 28 Nëntor, së bashku me Ismail Qemal, Luigj Gurakuqin përkujtohet edhe atdhetari i madh, prifti shqiptar, Dom Nikoll Kaçorri, strategu i pavarësisë së Shqipërisë, që i dha kombit modalitetet e një jete në kërkim të arkitipit të vlerave njerëzore e kombëtare.

Lura ndihet krenare për birin e saj, nënkryetarin e Qeverisë së Vlorës të vitit 1912, që ishte një personalitet i spikatur i Kishës Katolike të Shqipërisë, me detyra e misione të ndryshme, një atdhetar i flaktë, që shkriu jetën për liri e pavarësi të popullit e të vendit, e për këtë do të përkujtohet në shekuj e mijëvjeçarë, jo vetëm nga Lura e Lurianët, por nga gjithë shqiptaria.

Ai qe edhe një intelektual i madh, që dha

kontribut të veçantë në afirmimin e vlerave kulturore të kombit shqiptar.

Ky prift patriot, që jetoi e punoi për Fe e Atdhe, ishte nga Kreja e Lurës, ku lindi në vitin 1862, me babë katolik e nënë myslimane. Mësimet e para i kryen në Seminarin Papnor të Shkodrës, studimet e larta të filozofisë e të teologjisë në Austri. Shërben për 23 vjet rresht si prift famullitar në Delbinisht e Durrës, duke nxjerrë meshtarë të rinj e duke ndërtuar Kisha të reja, pa harruar asnjë çast misionin e tij për Fe e Atdhe.

Kultivimi e mbrojtja e identitetit kombëtar të shqiptarëve dhe kumtimi i Lajmit të Mirë, ishin dy elemente përbërëse të veprimtarisë së tij. Është ndihmës i ngushtë i kryepeshkvit të sëmurë të Durrësit, Imzot Primo Biankut. Është klerik, por edhe patriot, është meshtar, por edhe muzikant, është predikatar, por edhe dijetar.

Lura ndihet krenare për birin e saj, nënkryetarin e Qeverisë së Vlorës të vitit 1912, që ishte një personalitet i spikatur i Kishës Katolike të Shqipërisë, me detyra e misione të ndryshme, një atdhetar i flaktë, që shkriu jetën për liri e pavarësi të popullit e të vendit, e për këtë do të përkujtohet në shekuj e mijëvjeçarë, jo vetëm nga Lura e Lurianët, por nga gjithë shqiptaria.

Ai qe edhe një intelektual i madh, që dha kontribut të veçantë në afirmimin e vlerave kulturore të kombit shqiptar.

Dom Nikoll Kaçorri është në kujtimet e fratit të ri françeskan Atë Bon Gjeçaj, gjakovarit të sapo dalë nga universitetet evropiane, kur në vitin 1897 kremtonin në Durrës Meshën bashkë dhe, sipas radhës, ndërsa Imzot Nikoll Kaçorri i binte harmoniumit e këndonte liturgjinë hyjnore, Atë Bon Gjeçaj e ndihmonte atë me violinën e tij.

E ai është edhe në kujtimet e Imzot Pjetër Demës i cili, gjatë viteve 1905-1906, për një periudhë dy vjeçare, ishte ndihmës e krah i djathtë i Imzot Kaçorrit si famullitar në Durrës, sidomos gjatë verës, kur Imzot Kaçorri shkonte me shërbimet e veta në Austri. Megjithëse prift, për interesat e kombit e të Atdheut, Dom Nikoll Kaçorri nuk tërhiqet edhe mbas atij çasti të lavdishëm për detyrat e tjera që ia kërkon interesi i popullit dhe Atdheut. Është nënkryetar i Qeverisë së parë shqiptare.

Merr pjesë në shumë kuvende kombëtare, sidomos ndër ato për arsim-kulturë dhe për lëvrimin e gjuhës shqipe. Është pjesëtar në Kongresin e Manastirit dhe përkrahës për hapjen e normales së Elbasanit. Është aty ku e kërkon interesi i Atdheut. Dhe largohet burrërisht prej detyrave, largohet nga politika, vetëm atëherë kur, me ndërgjegjen e tij të pastër sheh, e kupton se në atë politikë ka papastërti e mos sinqeritet, që rrezikon fatet e popullit e të Atdheut të tij të dashur. Burrërisht në rrezik e në pjesëmarrje, edhe me burrërisht në vendim e largim, Dom Nikoll Kaçorri mbetet përgjithmonë një figurë e shquar e Rilindjes kombëtare shqiptare.

Ndërroi jetë në Vjenë më 29 maj të vitit 1917, pas një sëmundje të rëndë në moshën 55-vjeçare. Emri i Dom Nikoll Kaçorrit është përmendur gjatë viteve të komunizmit, duke i dhënë vendin që meriton këtij kleriku katolik në panteonin e figurave të shquara të kombit shqiptar.

Bëj një abonim
online ose
kopje të shtypur...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...
email: rrugaearberit@gmail.com



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit ose ndiq linkun: <https://tinyurl.com/lcc3e2f>

Nga SHAQIR SKARRA

Poetët janë një rracë e çuditshme njerëzore, preken e tjetërsohen si me magji, edhe nga një buzëqeshje e luleve në pranverë, edhe nga stina e dimrit e nga dallgët e detit. Një poete të tillë njoh edhe unë, që në fakt çdo ditë i hap portat e ditës së saj me buzëqeshje dhe oshëtim, me dallgë deti e lule vjollcë pranverë, me këngët e shpirtit që nuk rreshtin kurrë nga gurra e madhe dhe e pashtershme e lirikave të saj. Cucë Vile e nuse Dibre, siç ka qejf dhe vetë të shprehet poetja e afirmuar tashmë Sulbie (Tota)Shehu, pas botimit të librit të parë në vitin 2020 "Anës Drinit" siç duket e ka ngritur stekën, dhe në vëllimin e dytë që po na jep në duar me titull "Lotin ma kthe në vesë mëngjesi" nuk është larguar kurrë nga lirikat pasi me lirika është e dashuruar qysh kur e pa vetë se kishte talent për të shkruar.

Duke e shfletuar librin e saj nga faqja e parë dhe në të fundit shikojmë me kujdes se poetja herë këndon si mjellmë e herë si zanë, herë flet më hënën e herë me detin, herë me qiellin e herë me natyrën.

Unë për veten time them se jam me fat që isha redaktori i këtij libri me lirika, them isha me fat se isha edhe lexuesi i parë dhe të them të drejtën u befasova nga freskia e vargjeve dhe befja e imazheve që ajo përcjell tek lexuesi me një thjeshtësi vërtet për tu admiruar.

Në poezinë e poetes Sulbie Shehu fryjnë erërat e trazuar femërore, kujtimi, ëndrra, iluzioni, vetmia, malli, kategori të përjetshme të fiksionit poetik, që nuk kanë ndryshuar kurrë që kur ka lindur poezia, por që vijnë në kurba dhe dimensione të ndryshme nga njëri poet tek tjetri, në filtrin e përvojës vetjake dhe unit. Sulbia ka botuar vazhdimisht edhe në rrjetet sociale dhe akseset e ndryshme të epokës së modernitetit. Kam lexuar herë pas here cikle të poezisë së Sulbies, botuar në portale të ndryshme, dhe më bën përshtypje gjallëria e imazhit dhe figurës, shpërfaqja piktorale në akuarelin e ndjenjës, dendësia e mendimit poetik, asimetria e gjendjeve dhe përjetimeve, që në finale të aktit poetik përbëjnë një harmoni të plotë, të kudoshfaqur në strofa e vargje, që të mbeten në mend për një kohë të gjatë.

Dhe ja se si shprehet poetja në poezinë e saj me titull: "Boll inat të kam, pa t'folë nuk rri dot":


*"Do i përziej lotët, me pak vesë mëngjesi,
me flladin e mbrëmjes do të përqafoj .
Shpesh t'i përballë meje
zë e nis të zbehesh,
boll inat të kam, këtë s'e mohoj.*

*Në vargjet e mia, përsëri je ti,
herë më vjen si këngë e herë si refren.
Boll inatë të kam, edhe ti e di,
ndaj nuk rri pa t'folë se bëhem verem! "*

Poezia e saj tërheq vëmendjen për fshehjen e objektit poetik dhe fjalën e kulturuar. Nën tisin e vetëpëmbajtjes dhe "ekonomizimit" të fjalëve, shpërfaqet një shpirt i trazuar deri në rebelim, që kërkon ta jetojë me intensitet të lartë gjithçka dhe që në rrugëtimin e ëndrrës, përballet me çdo pengesë, e mbi të gjitha me pengesat që i ngre vetvetja.

Sulbia, mes shpërthimit ndjesor dhe aparatit meditativo-lirik, si arsyetim poetik rreth të ndodhurës, si kujtesë, si imazh, si arkitip i sendërtuar në kumt estetik, mes mesazhit, ndjenjës dhe mendimit, ka zgjedhur intuitivisht gravitetin tërheqës të të nënkuptuarës, të asaj që është në sipërfaqe, të nëntekstit. Moderniteti i saj nuk është klithës, por "shungurues", duke na bërë të besojmë në fiksionin e saj, në apologjinë e të vërtetave të saj, që mëton t'i bëjë të vërteta universale të gjithëkohshme, duke besuar

Poetja e fjalës së bukur



Sulbie Shehu

Lotin ma kthe
në vesë mëngjesi

Lirika

verbërisht në atë që shkruan, çfarë dëshmohehet si cilësi absolute e poezisë, që kur ajo ka nisur rrugëtimin drejt njerëzve në këtë botë.

Befja, në kuptimin e të papriturës rrëzël-itëse, kapriçoze dhe ndjellëse njëherësh, shfaqet si "ormanent" poetik në poezitë e Sulbies, duke na joshur në krahët e ëndrrës së kulluar, e cila qëndron tej caqeve të çdo arsytimi racional dhe filozofie jetësore, si një transhendencë e unit të unifikuar me vetë botën dhe universin.

Moderniteti i saj poetik shfaqet më së pari në grimcimin në formë mozaiku që poetja i bën objektit poetik, "lëndës së parë", duke e thërmuar dhe rikonfiguruar në një të plotë të re, që tashmë, përveçse pjesë e kujtesës, është pjesë e filtrave të fuqishëm estetikë, që vë në përdorim autorja.

Përzgjedhja e imët e fjalës, si shenjimi metaforik dhe simbolik i gjendjes, imazhit dhe mesazhit, duket se është pjesë e një diskursi ballafaques dhe reargues të poetes, e cila në çdo gjë që bën objekt të artit të saj poetik vështron një marrëdhënie, që ia bën më të afërt ëndrrën, njerëzit që e rrethojnë dhe botën. Sulbie Shehu përcjell ankthin e njeriut modern, që përballet me kujtesat e

tij, me kohën e ëndrrës dhe zhgjiëndrrës, me baticat dhe zbaticat e fatit, me humbjen e ndjeshmërive të botës ndaj vuajtjes së tjetrit, çfarë e bën poeten të rebelohet dhe të kërkoj ankorim në brigje të sigurtë.

Poetja e ndërton figurën poetike me anë të projeksioneve të thyera fotografike, duke e risjellë realitetin jetësor me nuanca dhe ngjyra të përdezura, por larg shtampave deklarative dhe prolixse, me të cilët, në fakt, është mbushur dëng një pjesë e konsiderueshme e librave të botuar me poezi, sidomos gjatë këtyre viteve të fundit, ku lehtësia e të shkruarit dhe identifikimi i artit poetik me një soj zeje artizanale, e ka dëmtuar rëndë peizazhin poetik të botës shqiptare.

Ajo prirret të zbulojë anët e panjohura të vetvetes dhe të atyre që e rrethojnë, duke i rivlerësuar kujtesat, përjetimet dhe impresionet e çastit, me anë të një rimodelimi, që është, në thelb, imazhi i asaj çfarë poetja e konturon si kredo të botës së saj të brendshme. Polivalenca e figurës që ajo ndërton, komunikimi i ngrohtë lirik, përzier me mesazhe bashkëkohore dhe universale për nga gama e rrokjes së këndvështrimeve, e bëjnë poezinë e Sulbies të komunikojë

Po të pyes Zalldardha ime

*Kush mungon sot moj Zalldardhë?
Në këto skena që gjëmojnë.
A janë mbledhur të gjithë artistët?
Po pyes veten vallë kush mungon?*

*Kush këto skena i hijeshonte?
Me atë zë kala vigane.
Vallë ku është sot Haziz Ndreu?
Kënga e ti vepër e madhe !*

*Sot t'u mblodhën bij e bija,
Të gëzojnë në ditën tënde.
Po ku është vallë Xhelal Çerçepja?
Që n'kto skena hidhte valle.*

*Ti gjithmonë o moj Zalldardhë,
Nëpër shekuj buqetë lulësh.
A mos vallë sot të mungon?
Zëri i ëmbël i Qerim Sulës.*

Bashkë qëndruam Vilë e Kalisë

*O po të thërras nga bjeshkët tona,
O moj Vilë e historisë!
Ty gjithmonë të ndriti balli,
Kurrë s'u ndave me Kalisë.*

*Nëpër shtigjet e Drinit Zi,
Ju latë gjurmët në gur e shkëmb.
Vilë, asnjëherë nuk t'u tremb syri,
Me vëlla Kalisin në istikam.*

*Bashkë luftuat nëpër shekuj,
Lidhët besën e falët gjakun.
Shpia e parë e Murat Merës,
Lartëson brezash bajrakun.*

*O do këndojmë për viset e mija,
Se jemi bijtë e këtij vatani.
Vilë - Kalis për ju del kënga,
Dhe për ju më ushton zani.*

*E ëmbël vjen kanga për ju vise t'mija,
Se shpirti më këndon më ëmbël se kurrë.
Kangën ma rrëmben bukuria e historia,
Perlat arbënore, shqipe në flamur!*

emocion të fortë dhe ndjesinë e një zbulimi të beftë.

Originaliteti i poezisë së saj është i dukshëm, aq sa një lexues i kujdesshëm e dallon menjëherë atë nga poezitë e poetëve të tjerë, veçori kjo e autorëve të rrallë, që gjejnë korda të përbashkëta me lexuesin e tyre.

Në vargjet e poetes ka trill, magji, dritëhije të një botë të thyer simbolike, mbushur me trishtim e dhimbje, pezm e dashuri, trill e vetmi, të cilat shpërfaqen me një thellësi tronditëse, e cila vjen e na zgjon nga gjumi e na mundëson shpalimin e një bote shprese e harmonie asimetrike, me anë të një simbolike shumëdimensionale.

Poezi si këto të Sulbies nuk lexojmë dhe aq shpesh në këtë kohë të ngarkuar aq shumë me prolixitet, shtampa dhe stereotipe. Duke lexuar poezinë e saj, të duket sikur përballësh me efektet e një kure "terapeutike", pas një mpirje të gjatë dhe ankthi sindromik dhe ky është efekti i poezisë elitare, të të freskojë shpirtin dhe të të bëjë të ndihesh më mirë me veten dhe me të tjerët, në një botë të pa përkryer dhe stresante, siç është bota jonë, të cilën poetja nuk tenton që "ta ndreq", por duke i bërë një autopsy të thellë vetvetes, unit të saj të trazuar, ajo na ofron një mundësi për ta parë ndryshe botën, për ta modeluar atë sipas shijeve tona më të mira.

Nga OSMAN XHILI

Motër e dashur! Ti sapo mbushe 80 vjeç dhe unë mbeta për pak i hutuar. Krahas një komenti apo postimi të thjeshtë në rrjetet sociale, desha të të dhuroj diçka apo të të bëja një surprizë të vogël. Nuk di vërtet! Ti sot jeton në Kanada, larg nesh. Pasi u mendova dhe pak akoma, vendosa të të kushtoja një shkrim, që është fare pak për veprimtarinë tënde, me të cilën çdo njeri mund të krenohet pa frikë.

Ti ishe gjithë kohës një nxënëse dhe mësuese e shkëlqyer. Prindërit tanë kënaqeshin me arritjet e tua. Në vitet e mëvonshme, krahas mësimeve, shquheshe dhe në aktivitete të ndryshme, që zhvilloheshin me raste festash e përvjetorësh të ndryshëm.

Ishte 25 prilli i vitit 1953, dita e kufirit. Një moment i tillë vlerësohej shumë asokohe dhe shkolla shtatëvjeçare e Maqëllarës jepte një koncert me këngë e recitime për kufitarët e postës së Bllatës. Mes shumë nxënësve të tjerë të talentuar, motra Shqipe, atëherë në klasën e gjashtë, u paraqit me një recitim mjaft të bukur e prekës. Titullohej "Vdekja dhe ushtari". Tregonte për një ushtar sovjetik, Vasil Terkinin, të plagosur rëndë në frontin e luftës. Dhe pse kanë kaluar shumë dekada që atëherë, motra Shqipe akoma i mban mend mbi 30 strofë të kësaj poezie.

Lufta ndizej flakë e zjarr,
Thellë fushës me gjëmim,
Vasil Terkini, ushtar,
Dergjej shtrirë si i pafrymë...

Njerëzit e shumë që ndiqnin koncertin vërtet u mrekulluan nga interpretimi brilant i vajzës trupvogël dhe e duartrokiten gjatë. Këto do të ishin vetëm hapat e parë të saj në rrugën e gjatë të suksesit, që arrihet pas vështirësive të panumërta.

Shqipja e mbaroi shtatëvjeçaren me rezultate të shkëlqyera. Ishin vite të hershëm dhe vendi kishte shumë uri për mësues, qofshin këto dhe pa përfunduar shkollimin e plotë. Motrën e kërkuan të punojë si mësuese me fëmijët e kopshtit. Ajo kujton se i erdhi një kontroll nga seksioni i arsimit të rrethit. I dërguari i seksionit të arsimit, Xh. Berisha, mbetet i habitur nga njohuritë që kishin fëmijët e kopshtit dhe kompetenca në të shpjeguar e edukatores së re. Ishte kjo punë dhe këto vlerësime pozitive, që edukatorja e re të kalojë tashmë si mësuese në cikël të ulët, punë që e vazhdoi derisa doli në pension.

Ishte viti 1961, kur Shqipja largohet nga shtëpia prindërore për të bërë nuse e Fidallarëve të Grevës. Ajo mbaron shkollën pedagogjike në Tiranë dhe në Elbasan, duke kompletuar njohuritë në shkenca dhe pedagogji, gjëra këto që do t'i transmetonte më së miri te nxënësit e saj. Shumë drejtorë



me të cilët punoi, Tush Topuzi, Avni Fida, Kimete Kata, Gani Hoxha e të tjerë, thonë fjalët më të mira për Shqipjen dhe se nuk ishte nevoja të kontrollonin klasën e saj. Ata madj dëshironin që ajo të mbante gjithnjë klasën e parë, pasi ishte bërë një metodiste shumë e zonja. Nuk kishte raport në mes apo në fund të vitit, që mbante drejtorja, dhe të mos përmendej emri i saj si mësuesja më e dalluar e kolektivit.

Në një nga kontrollet që vinin nga lart, Todi Lubonja veçon mësuesen e përkushtuar Shqipe Fida, duke shkruar tek gazeta "Mësuesi" e asaj kohe. "A e njihni?" - fillonte artikulli. "Të gjithë duhet të marrim shembull prej saj." Dhe vazhdonte më pas, duke përshkruar me detaje arritjet dhe punën e saj shembullore.

Pak kohë më pas, seksioni i arsimit në rreth propozon mësuese Shqipjen për dekoratën "Naim Frashëri". E menjëhershme ishte përgjigjja pozitive dhe në koleksionin e medaljeve dhe certifikatave të fituara u ishte shtuar dhe një tjetër, shumë e rëndësishme si kjo.

Motra ime, Shqipja



Aktiviteti i përditshëm i mësuese Shqipes ishte shumë i ngjeshur e rezultativ. Ajo ishte mësuese, ishte nënë me shumë fëmijë, por dhe një aktiviste shoqërore, që kërkonte përparim në çdo fushë të jetës. Zgjidhet kryetare e gruas për fshatin. Bashkë me shumë shoqe të saj, si Lule Korumin, Fllanxa Hoxhën e shumë shoqe të tjera punojnë fort për të gjallëruar jetën e fshatit me aktivitete e veprimtari të ndryshme.

Në një nga kongreset e gruas, që mbaheshin në Tiranë, motra do të ishte njëra nga delegatet e këtij Kongresi. Në përfundim të punimeve ata vizitojnë ferma të ndryshme dhe përfitojnë nga eksperiencia e grave të suksesshme.

Por ky nuk ishte i vetmi kongres ku mori pjesë. Në cilësinë e anëtares së këshillit për frontin demokratik të rrethit, ajo merr pjesë si delegate e njërit prej kongreseve të këtij forumi të rëndësishëm për kohën.

Për shumë vite me radhë Shqipja do të zgjidhej si anëtare e këshillit të bashkuar për zonën e Melanit. Me vërejtjet e sugjerimet e saj konstruktive bëhej pjesë e zgjidhjes së problemeve të ndryshme, që shtroheshin për diskutim.

Shqipja pranoi dhe një varg detyrash të tjera shoqërore, por unë do të desha ta përmbyll këtë cikël me të qenit si kryetare gjykatë për fshatin. Ishte vërtetë çështje delikate për kohën të ishe në një pozicion të tillë. Duhej të jepje dënime dhe për pak gojë ushqim që lopa e fshatarit përllante nga prona kooperativiste apo se një fëmijë i vogël ishte tunduar të marrë ca kokrra qershi nga një pemë diku pranë shtëpisë së tij. Por më e bukura mund të ishte se kooperativa i kishte marrë dhjetëra pemë, disa dynymë apo hektarë tokë, familjes në fjalë. Kryetarja e gjykatës i mendonte të gjitha këto, bile vetë ajo i kishte dorëzuar me hir apo me pahir disa hektarë tokë. Ndaj përpiquej që të jepte dënime sa më minimale, pasi i donte dhe i dhimbsheshin njerëzit e thjeshtë e të varfër.

Në gjithë këtë front të madh angazhimesh ajo kurrë nuk harroi atë më kryesoren, familjen. Fati e deshi që të kishte për bashkëshort një burrë fisnik, Murat Fidën. Bashkë krijuan



një familje vërtet për t'u pasur zili, plot tre vajza e dy djem, siç ishin të mëdha familjet e asaj kohe. Fëmijët u rritën, u shkolluan, por morën dhe një edukatë të shëndoshë, që të ishin pika referimi në shoqëri. Të tria vajzat: Zamira, Liljana dhe Sosina mbaruan shkollimet e larta për mësuesi. Zamira mbaroi për gjuhë të huaj dhe letërsi. U martua në Bellovë me inxhinier Maksin, zbritën në Peshkopi, më pas ndërtuan shtëpi në Tiranë, ku u bë nëndrejtoreshë shkollë. Por fluturimi i saj nuk u ndal sërish. Aplikoi dhe fitoi një lotari kanadeze dhe ka mbi njëzet vite që punon e jeton familjarisht atje, duke fituar dhe një profesion tjetër, si specialiste dentare. Katër fëmijët e vajzës tjetër, Liljanës, kanë mbaruar shkollimet e larta për inxhinieri, ashtu si Veliu, babai i tyre dhe po bëjnë emër në këtë profesion të vështirë. Po kaq e talentuar Sosina, me dy fakultete të kryera dhe me fëmijë shumë inteligjentë.

Dy djemtë; Avdiu me emrin e gjyshit dhe Armondi mbaruan gjimnazin dhe nuk arritën dot të vazhdojnë shkollimet e larta. Jo se u mungonte inteligjenca, por donin t'i bëheshin krahu familjes. Emigruan në Greqi, ku punuan e fituan, blenë truall e ndërtuan shtëpi të bukura në Tiranë. U martuan me dy zonjusha të nderuara, Mondën, mësuesen e përkushtuar dhe Mozën, menaxheren perfekte nga familja Biba e Qafëmurrës. Sot ata menaxhojnë secili biznesin e tij, kurse fëmijët e tyre po plotësojnë dëshirën e etërve për shkollime të larta.

Para dy vjetësh fshati ynë bëri një aksion të rëndësishëm për rrethimin e varrezave, mbjelljen e bredhave dhe ndriçimin. Me të marrë vesh për këtë nismë të bukur, motra Shqipe, bashkë me vajzën e saj, Zamirën, dërguan një shumë të konsiderueshme të hollash, si kontribut për aksionin tonë. Ajo nuk e harron origjinën, vendin ku u lind, u rrit dhe hodhi hapat e para të shkollimit dhe edukatës.

Jeta e njeriut është sa e bukur, aq dhe me goditje e vështirësi. Në këtë betejë motra ka humbur bashkëshortin dhe vajzën e mesit, Liljanën. Zemra e saj është pikëlluar jo pak, po sërish ka ditur të menaxhojë dhimbjen, kur sheh aq shumë fidanë të shëndetshëm, që e rrethojnë dhe zbukurojnë jetën e saj.

Motra Shqipe, shqipja e maleve që fluturon në lartësi e ka ndalur fluturimin në Kanada. Atje kanë krijuar një oaz të këndshëm pune e jete dhe shumica e familjes është transferuar atje. Është bërë disa herë gjyshe e stërgjyshe dhe i mëson nipërit e mbesat me të njëjtin përkushtim si nxënësit e shkollës dikur.

Urime motër e dashur! Sa më shumë vite të lumtura pranë familjes tënde të mrekullueshme!

KËRKOHET GAZETAR

Kërkohen një gazetar me kohë të pjesshme. Detyra kryesore është të shkruajë dhe raportojë për ngjarje që ndodhin në qarkun e Dibrës.

Të interesuarit duhet të kenë pasion gazetarinë.

Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.

Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

Tel. 069 20 68 603

E-mail: rrugaearbërit@gmail.com

Vetëm shpirti dhe zemra e atyre që e kanë provuar e përjetuar e dinë se sa vështirë dhe sa e rëndë është pesha e mallit dhe dhimbja e ndarjes për së gjalli, kur jeton larg atdheut

Nga SHAQIR ÇERPJA

Sadin Maliq Çerpja nga fshati Lashkizë i rrethit të Dibrës, për 45 vjet, që nga viti 1949 e deri pas rënies së regjimit dhe diktaturës komuniste në Shqipëri, qëndroi në mërgim, larg atdheut, në Amerikë dhe e kishte të ndaluar e të pamundur të vinte në atdhe, të vizitonte vendlindjen, të shihte e të takonte njerëzit e tij të afërt e të dashur, vël-lain, kushërinjtë, hallat e dajat, nipat e mbesa. Por as nuk mund të merrte informacion e të komunikonte në distancë me ta.

Vetëm shpirti dhe zemra e atyre që e kanë provuar e përjetuar e dinë se sa vështirë dhe sa e rëndë është pesha e mallit dhe dhimbja e ndarjes për së gjalli, kur jeton larg atdheut dhe e ke të ndaluar e të pamundur, jo vetëm kthimin në atdhe, qoftë dhe përkohësisht, por as komunikimin në distancë me njerëzit e afër të gjinisë e të gjakut.

Në vendlindje, në Dardhë, quhej e thirrej Sadin, por në të gjithë regjistrat shtetëror, në Shqipëri dhe në Amerikë është regjistruar e thirrur me emrin Sejdin.

Sadini u lind në vitin 1928, në lagjen Zhugjerr, të fshatit Lashkizë. Në moshën dy vjeçare mbeti jetim, sepse nëna e tij vdiq në moshë shumë të re. Dhe, ai u rrit nga njerka e tij, Hane Muça, e cila u kujdes dhe e rriti me shumë përkujdesje dhe dashuri nëne. Vitet e fëmijërisë dhe vitet e para të rinisë i kaloi në fshat, pranë familjes, duke u kujdesur për blegtorinë dhe duke punuar në bujqësi. Në vitin 1948 u thirr dhe shkoi për të kryer shërbimin ushtarak. Deri në Peshkopë e përcollti dhe i fundit që u takua dhe u nda me Sadinin ishte Dali Çera, nipi i Maliq Çerpës. Deri në Korçë, në të njëjtën makinë me Sadinin kishte udhëtuar edhe Ibrahim Kaca, por në Korçë i kishin ndarë, sepse Ibrahimin e kishin ndaluar në Korçë, ndërsa Sadinin e dërguan në kufi, në Kapshticë. Vetëm kaq informacion dihej për Sadinin, sepse në vitin 1949, ishte në frontin e luftës, në vijën e parë të zjarrit dhe luftimit, por, aty humbi çdo kontakt me shokët e tij ushtarakë dhe me komandën ushtarake të repartit ushtarak e nuk u pa më. Sigurisht, humbi çdo kontakt edhe me familjen dhe të afërmit e tij në Dibër. Nuk dihej ku ishte, ku shkoi, si shkoi e pse shkoi. Atëherë edhe mjetet e komunikimit e informacionit mungonin. Pushteti, regjimi dhe diktatura komuniste e etiketuan dhe e akuzuan si dezertor dhe, rrjedhimisht, familja dhe të afërmit e tij, për gati gjysmë shekulli, që nga viti 1949 deri pas rënies e përmbyesjes së regjimit komunist në Shqipëri, mbajtë mbi shpinë peshën e rëndë të diferencimit politik e klasor.

Në vitin 1957, vëllai i Sadinit, Hasan Maliq Çerpja thirret në degën e punëve të brendshme Peshkopë dhe provokohet, duke i thënë se të kanë ardhë dollarë nga Amerika. Veç të tjerave i thonë se do t'i japin adresën e Sadinit dhe i ai, Hasani, t'i kërkonte Sadinit të kthehet në Shqipëri dhe t'i premtoje se do të dalë një dekret për falje. Por Hasani iu shmang të gjitha provokimeve. Në këtë rast kuptoi se Sadini ishte gjallë dhe se ishte në Amerikë, por vetëm kaq dhe nuk dinte e nuk kishte asnjë informacion tjetër për vëllain e tij.

Hasani, i cili kishte qënë edhe partizan në luftën nacionalçlirimtare dhe kishte luftuar për çlirimin e vendit, nga viti 1949 dhe deri pas rënies së regjimit komunist, jetoi me zemër të djegur dhe me shpirt të përvëlur për vëllanë e tij të vetëm, me të cilin nuk kishte asnjë lidhje dhe komunikim dhe asnjë informacion. Por hallin, mallin dhe brengën i mbajtë brenda vetes. I mbajtë për vete dhe i fshehu brenda vetes, se nuk donte që edhe të tjerët të vuanin si ai. Hasani pati familje të madhe, pati shumë fëmijë dhe krijoi shumë miqësi. Bëri e pati edhe disa dasma, por dasmat e tij ishin gjysmë dasma, sepse

Sadin Maliq Çerpja, trupin në Amerikë e shpirtin në atdhe



Sadin Maliq Çerpja për 45 vjet, që nga viti 1949 e deri pas rënies së regjimit dhe diktaturës komuniste në Shqipëri, qëndroi në mërgim, në Amerikë, dhe e kishte të ndaluar e të pamundur të vinte në atdhe, të vizitonte vendlindjen, të shihte e të takonte njerëzit e tij të afërt e të dashur...

mungonte Sadini, i cili as nuk e dinte kur bëheshin dasmat e kush martohej. Ai as nuk e dinte se sa fëmijë kishte i Hasani. Kushedi se sa e sa herë, Hasani, fshehurazi ishte për-lotur dhe kishte fshehur lotët, kur në dasma, i vetëm priste e përcillte dasmorët, krushq, daja, miq e shokë, pa patur pranë, pa patur përkrah vëllanë. Ndoshta, nuk pati asnjë ditë të vetme të qetë, që të mos mendonte për Sadinin. E kujtonte, mendonte e fantazonte sikur t'a shihte vetëm njëherë, t'a kishte përballë, t'a kishte pranë, të vështroheshin sy më sy, të buzëqeshin ballë përballë, të takonin e të shtrëngonin duart, të dëgjonin zërin e njëri-tjetrit, të uletshin në sofër bashkë ...

Pas rënies së regjimit dhe diktaturës komuniste në Shqipëri, në vitin 1994, Sadini bashkë me bashkëshorten e tij Liza, erdhën në Shqipëri, tek Hasani dhe të afërmit e tyre të dashur. Vetëm kur erdhi Sadini në Shqipëri, u mësua e vërteta e jetës së Sadin Çerpës, rreth 45 vjet larg atdheut, në mërgim, me trup në Amerikë dhe me zemër e shpirt në atdhe.

Në provokacionet e gushtit të vitit 1949, Sadini, bashkë me shokët e tij ushtarakë ishin në frontin e luftës, në vijën e parë të zjarrit, përballë forcave ushtarake greke. Ndërkohë që lufta dhe luftimet vazhdonin, skuadra ku ishte Sadini, si dhe disa oficerë, gjenden të rrethuar nga ushtria greke, pa asnjë shteg dha pa asnjë rrugëdalje. Zihen rob, çarmatosjen dhe merren e dërgohen në një kamp grek në Selanik, ku u mbajtën e qëndruan jo pak, por katër vjet. Pas katër vjetësh u shpërndanë në disa shtete dhe Sadini i rastisi të shkonte në Amerikë dhe u vendos në Boston, ku filloi një jetë të re, një ndryshe. Fillimisht punoi në një kompani makinash, "General Motors". Pas disa vitesh në këtë kompani, punoi në një nga kompanitë e shqiptaro-amerikanit Antonio Athanas, i cili, për punëtorët shqiptarë kishte

vëmendje dhe tregonte interes dhe kujdes të veçantë. Për punëtorët shqiptarë që punonin në kompanitë e tij, kishte vënë një kusht dhe një detyrë specifike, që krahas punës, çdo ditë të mësonin një shkronjë shqipe dhe pastaj të mësonin që të shkruanin fjalë e fjali shqipe. Edhe komunikimin me njëri tjetrin e ndërmjet tyre t'a bënin në gjuhën shqipe. Në Boston, Sadini njihet dhe krijon lidhje të afërta me dibranin Lazim Prethin, i cili kishte ardhë më herët në Boston dhe ishte martuar me një vajzë greke. Lazimi me bashkëshorten e tij greke ndërmjetësuan dhe Sadini u njoh dhe u martua me një vajzë greke nga Kallamata e Greqisë. Nga kjo martesë, Sadini dhe bashkëshortja e tij Liza, lindën dhe kanë tri vajza: Hana (Ana), Niki dhe Paula. Vajzës së parë, Sadini i dha emrin Hana, në kujtim dhe në nderim të njerëzës së tij, Hane Muça, e cila e rriti me përkujdesje dhe dashuri nëne. Me lindjen, rritjen dhe martesën e tri vajzave, familja u rrit dhe u zgjerua.

Sadini kishte dijeni për regjimin e diktaturës komuniste dhe për varfërinë ekstreme të popullit në Shqipëri, por nuk kishte asnjë informacion e dijeni për vëllain e tij në Shqipëri. Sadini ishte i vetëdijshëm se, për shkak të tij, Hasani dhe familja e tij në Shqipëri, ishin ndëshkuar politikisht.



Menjëherë pas rënies dhe përmbyesjes së regjimit dhe diktaturës komuniste në Shqipëri, tek Sadini, në shpirtin dhe zemrën e tij u zgjuan dhe u ringjallën shpresat dhe ëndërra e madhe për të ardhur në Shqipëri. Por fillimisht nuk ishte i sigurt dhe nuk kishte siguri. Bashkë me Lazim Prethin e bashkëshortet e tyre greke, bien dakord e vendosin që fillimisht të vinte vetëm bashkëshortja e Lazimit. Ajo erdhi e vetme në Shqipëri, shkoi edhe në Dibër, u interesua, gjen dhe merr informacion për Hasanin dhe familjen e tij, që jetonin e banonin në Tiranë. Pasi bashkëshortja e Lazimit kthehet në Amerikë dhe e siguron Sadinin se nuk ka asnjë pengesë e problem për të shkuar në Shqipëri, në vitin 1994, Sadini bashkë me bashkëshorten e tij greke, Lizën, vinë në Shqipëri, tek Hasani dhe tek të afërmit e tjerë.

Atë ditë dhe ato ditë takimi e bashkimi, malli u shkri në lotë dhe u shua me lotë.

Përqafime të pandashme e lotë të pasosur kudo: në aeroport, në rrugë, në makina, në oborr, në shkallë, në dhomë. Sy që vështroheshin ngultas e duar që takoheshin e shtrëngoheshin fort. Me lotë e në mes lotëve frymonte e fliste çdo gjë, gjithçka. Flisnin, qeshnin e këndonin muret, dyert e dritaret, llampat e dritave, gotat e ujit e filxhanit e kafesë. Të gjithë gëzonin bashkë për këtë gëzim, gëzimin më të madh të jetës. As nuk kishte patur dhe as nuk do të kishte më gëzim të madh si ky e më të madh se ky. Ndoshta, ky

gëzim shkoi edhe tek varret dhe e ndjen edhe të afërmit e tyre të vdekur ... Gëzimi ishte aq i madh, sa nuk thuhet e nuk përshkruhet me fjalë. Prandaj, në vend të fjalës, fliste loti.

Daut Çerpja dhe Gëzim D. Çera ruajnë shumë kujtime, kanë shumë mbresa dhe me emocione tregojnë shumë episode nga takimi, qëndrimi dhe udhëtimi me Sadinin. Midis të tjerave dhe veç të tjerave, Gëzim D. Çera tregon se kur po udhëtonin nga Laçi për në Lezhë, kur arritëm tek ura e Milotit (ura e Zogut), Sadini kërkoi të ndalonin makinat. Vështroi anash, pastaj vështrimin e ndali në drejtim të Shkopetit dhe tha: -Me siguri, andej është rruga që kalon e shkon për Dibër. Dhe premtoi se kur do të vinte radhën tjetër, do të shkonte në Dibër, në Zall-Dardhë e Lashkizë. Do të shkonte edhe në lagjen Zhugjerr e në trojet, ku lindi dhe u rrit. Do të shkonte e të prekte rrasat dhe gurët në maje të Karmës, në Krixe e Kryeshite. Do të shkonte e të shtohet mbi barin e një tek Lama e Danit e në livadhet e hurdhës së Pakrojit. Do të futej e të ecte përmes degëve të shkurreve të lajthisë në kodër të Halimit, në kodër të Tanushit e në Usoje. Do të ngjitej te hurdha e Kalit e do të pushonte nën Hijet e Zeqirit. Do të pinte ujë te Kroj i Zhugjerrit e tek Kroj i Gjarpërit, ...

Por trazirat e vitit 1997 ia thyen zemrën, ia vranë dhe ia prenë shpresat. Në atë kohë të vështirë të trazirave të vitit të zi 1997 në Shqipëri, Sadini e përjetoi me dhimbje. Ai ishte i shqetësuar e prekuar për Shqipërinë dhe njerëzit e tij në Shqipëri. Interesohej, telefononte, pyeste dhe këshillonte njerëzit e tij në Shqipëri që të shmangeshin dhe të rrinin sa më larg konfliktit dhe politikës konfliktuale shqiptare.

Pas disa kërkesave të përsëritura të Sadinit, për të shkuar në Amerikë, Gëzim D. Çera,

mer vizën amerikane, pret edhe biletën dhe bëhet gati për të shkuar në Amerikë. Por, një javë përpara se Gëzimi të nisej e të shkonte në Amerikë, merr lajmin e papitur nga Amerika se Sadini ishte ndarë nga jeta. Familjarët e Sadinit, bashkëshortja Liza dhe tri vajzat, meqë nuk kishin mundur të merrnin lehtë fatet për të shtyrë varrimin deri sa të arrinte dhe Gëzimi, atëherë kishin vendosur që të shtynin ditën e "të shtatëtave" për deri kur të arrinte Gëzimi në Amerikë. Dhe, në ceremoninë fetare të "të shtatëtave" Gëzimi ishte atje dhe çoi e hodhi mbi varr dhe nga dheu i atdheut, dheun e marrë në oborrin e shtëpisë së vëllait të Sadinit në Shqipëri. Gjithashtu, familjarët e Sadinit ishin kujdesur që për ditët që Gëzimi qëndroi në familjen e Sadinit në Boston, gjithë kohën të ishin të pranishëm dy përkthyes, të cilën punonin e përkthenin me turne.

Ndonëse jetoi larg atdheut, në Amerikë e largët dhe gati gjysmë shekulli nuk pati informacion, kontakt dhe komunikim me familjarët dhe njerëzit e tij të afërt në Shqipëri, Sadin Çerpja kujtohet me shumë dashuri, jo vetëm nga fëmijët e vëllait të tij në Shqipëri, por edhe nga të afërmit e tjerë. Për respekt dhe në kujtim të Sadin Çerpja, i cili jetoi dhe vdiq në Amerikë, emrin e tij e ka marrë dhe e mban njëri nga kastërnipat e tij, djali i djalit të Dautit. Edhe tani, familjarët e Sadinit, bashkëshortja Liza dhe vajzat Ana, Niki dhe Paula kanë e mbajnë lidhje dhe komunikojnë me familjarët e vëllait të Sadinit në Shqipëri.

GJECI & GJOCI



Një takim befasues. Para 13 vjetësh, saktësisht më 1 qershor 2008. Takim malli dhe dashuria. Gjecin e mbaja mend herët, në fëmijërinë time, e kam ndjek duke u rritur, shkolluar, marrjen përgjegjësi të detyrave të vështira të punës. Kisha miqësi me babanë e tij, Shukriun, bile kisha bërë një fotografi kur fillova punën në shtator 1959 si agronom në kooperativën e Brezhdan-Zdojanit, vendlindjen e tij dhe timen. Gjocin e kisha shokë punë. I kishim zyrat pranë e pranë, në një kat, një mur na ndante. Kishim mbaruar të njëjtin universitet, Institutin e lartë Shtetëror të Bujqësisë, siç mori emrin e përveçëm në 10 vjetorin e themelimit, 1961, emër që e mbajti derisa u bë Universiteti Bujqësor i Tiranës. Ia kisha pi rakinë në kullën e tij në Vajmëdhej. Edhe kafën e hidhur... Takimi, pas 12 vjetësh ndarjeje ishte një befasi e këndshme. Na qeshte zemra. Shikoni fotografinë dhe do ta lexoni. Kam bërë një gabim që nuk ia fali vetes. Kam fotografuar dhjetëra mijëra njerëz, në udhëtimet e mia nëpër Dibër e në mërgim. Më vjen keq që nuk i

kam kërkuar dikujt që ta shkrepente aparatën, bashkë me ta në një fotografi... Tash kam filluar ta korrigjoj. Vonë, tepër vonë... Në këtë rast, të tre bashkë, buzëqeshja dhe gëzimi do të ishte i trefishtë. Diçitura do të ishte Gjeci – Ashiku - Gjoci... Dy brezhdanës e një muhurrak. Me siguri do më kishin futur në mes, do të më mermin për krahu. Ishte një rastësi që atë ditë parakalova mjedisëve të "Shumicës", asokohe në mjedisin e ish uzinës Dinamo. Ishte një rastësi që sot, tek e gjeta midis dhjetëra mijëra fotografive, rastësisht, më sollti mall e dashuri. Nuk e di në se ata kishin krijuar firmën "Gjeci & Gjoci". Do të ishte një gjë e bukur... Me siguri kishin krijuar dashurinë jetësore Hysni Gjeci & Rexhep Gjoci... Sonte bën shumë ftohtë në Athinë. Frynë erë. Kohë bore... Ky "takim" më ngrohu.

Abdurahim Ashiku
Athinë, 12 janar 2022

Nazmi Përkola, "babai" i minierës së Bulqizës

Nga DESTAN RAMA

I vdekuri kujtohet,
për ç'ka punuar - nderohet
Urtësia

Të shkruash për njerëz që kanë bërë epokë në jetën dhe veprën e tyre është e vështirë. Themi kështu, sepse sado që të mundohesh ti, kurrë nuk mund ta përshkruash tërë veprimtarinë apo bëmat e tyre. Një i tillë është edhe Nazmi Përkola që me plot gojën mund ta quash Babai i minierës së Bulqizës. Nazmiu ka një biografi jete të dhimbshme nga lindja e deri në moshën e adoleshencës. U lind më 22 gusht të vitit 1932, në fshatin Fushë-Bulqizë, të rrethit Dibër. Rrjedh nga një familje e varfër, por me atdhetari e patriotizëm të thekur. Mësimet e para i mori në shkollën fillore, në vendlindje. Këtu ai shkëlqeu si nxënës dhe premtonte shumë për një të ardhme të shkëlqyer. Ky ishte edhe mendimi i mësuesve të tij, të cilët në fakt nuk u zhgënjyen. Nuk u rreshtua drejt për drejt në radhët e partizanëve, për arsye moshe, por u shërbeu atyre më së miri duke kryer detyrën e korrierit, bashkë me kushëririn e tij, dëshmorin Latif Përkola. Detyrën e kreu me korrektësi, sinqeritet dhe me trimëri, duke ruajtur në maksimum sekretin e saj. Të çudit fakti se gjatë kohës së pushtimit ai mësoi nga një oficer, kolonel Italian, i quajtur Mario, në mënyrë përfekte gjuhën italiane.

Pas çlirimit, nisur nga nevojat ekonomike të familjes, në moshën 12 vjeçare, filloi punën në minierën e Bulqizës, e cila ishte hapur nga një shoqëri italiane. Për këtë i erdhi në ndihmë kushëririn e tij, më i madh, i nderuari Rrahman Përkola, të cilit ia miratuan kërkesën pronarët e minierës, për ta marrë në punë. Me punën që bënte, tërhoqi vëmendjen e drejtuesve të minierës, të cilët duke parë aftësitë



e tij organizuese dhe drejtuese, në vitin 1952 e emëruan përgjegjës transporti në minierë. Këtu ai arriti rezultate të larta në kryerjen e detyrës. Në fund të vitit 1952, zgjidhet kryetar i Bashkimeve Profesionale të Bulqizës. Këtë detyrë ai e kreu me vullnet dhe përgjegjësi të plotë. Dhe po në këtë vit emërohet zv-drejtor i ndërmarrjes tregtare të Bulqizës, deri në vitin 1966. Gjatë kësaj kohe mbaroi arsimin e mesëm profesional, në degën "gjeologji", pa shkëputje nga puna, me rezultate të shkëlqyera.

Në gusht të vitit 1966 emërohet drejtor i ndërmarrjes tregtare deri në vitin 1970. Nazmiu ishte shumë i etur për dije, ndaj në vitin 1968-1972 kreu studimet e larta me rezultate shumë të mira. Kështu shkallë-shkallë u ngjit në majat më të larta të dijes, me një formim të kompletuar intelektual. Më 1970-1976 u emërua zv-drejtor i minierës të Kromit Bulqizë. Në nëntor të vitit 1976, emërohet drejtor i ndërmarrjes së ndërtimit të minierës. Në gusht 1988 deri në janar 1991 emërohet drejtor i traverbankut Klos, ku aty doli në pension.

Nderimet:

Për punën e shkëlqyer të kryer me korrektësi e sinqeritet të plotë

Nazmiu është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, (i asaj kohe) me urdhrat e klasit të I, II, III, si dhe nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave, ku anëtarë i kolegjit të kësaj ministrie për 17 vjet rresht ishte vetë ai, u dekorua me disa medalje dhe certifikata.

Për merita të çmuara me vendim nr 36 dt 12.10.2012 prefekti i qarkut Dibër i dha titullin "Qytetar Nderi i Bulqizës", pas vdekjes me motivacion: "Me punë e përkushtim, plot pasion e angazhim, në postet drejtuese të minierës, gjithnjë pranë halleve e shqetësimeve të banorëve të trevës së Bulqizës e më gjerë, duke mbetur komunikues i aftë, i thjeshtë e i sinqertë me ta."

Nazmiu ishte njeri human. Jetonte me hallet a problemet e punëtorëve të minierës dhe të gjithë komunitetit. I vinte keq për më të pamundurit nga ana ekonomike, ndaj i ndihmonte ata duke i punësuar në minierë, pa asnjë interes. Shumë e shumë njerëz kanë mbresa e kujtime të bukura dhe mallëngjyese për Nazmi Përkolën. Sot fëmijët e tij ndihen krenarë e të lumtur që kanë pasur një baba si ai. Atyre u duhet të përballen me "Stuhitë" e falënderimeve dhe të përgëzimeve; të shokëve miqve, gjakut të tij dhe e të gjithë atyre që e kanë njohur.

Por fatkeqësisht erdhi një ditë që ligjet 'kryeneçe' të natyrës e bënë të vetën, ia morën jetën. Kjo ndodhi në gusht të vitit 2006. Iu bëftë shpirti dritë!

Nazmiu vdiq, por la prapa një familje të mrekullueshme. La gjashtë fëmijë të mrekullueshëm dhe të shkolluar me arsim të mesëm e të lartë; dy nga këta, Luani inxhinier dhe Fredi ekonomist, punojnë në minierë, po ecim në gjurmët e babait të tyre. Dhe të gjithë së bashku do të vazhdojnë më tej punën dhe veprën e tij. Jeta kështu na qenka; një borxh që i lë brezi-brezit.

printime dixhitale

me ngjyra dhe bardh e zi

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendare | postera | ftesa etj.

duke filluar nga 1 kopje e vetme

për informacion: mbsotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

in memoriam

Musa Vladi mbeti në kujtesën e njerëzve si një bir i Lurës, si një mësues i Bulqizës, si një veprimtar me horizont të gjerë shoqëror.

E qeshura që më sjell Musa Vladi

Dy foto, njëra serioz e tjetra i qeshur. E para duhet të jetë fiksuar para se të hyjë në klasë, para se t'u thotë e t'i thonë nxënësit "Mirëmëngjesi mësues". Të gjithë në këmbë. Me sytë tek Ai. Me frymëmarrjen tek Ai.

E dyta e qeshur, plot gaz e hare, siç dinte ta mblidhte e ta shpërndante, Musa Vladi tashmë i Bulqizës. Unë kështu e kam parë gjithnjë Musa Vladin. Të qeshur e plot hare. Dhe kur buzëqeshja e tij bashkohesh me atë të mikut të tij Baftjar Shahinin, simfoni bëhej.

Kërkova në të dhjetëmijë negativët e jetës sime mos e gjej Musanë midis minatorëve, midis qytetarëve të Bulqizës, në konferenca të Bashkimeve Profesionale.

Nuk e gjeta.

Mbase e gjej. Nuk do të pushoj së kërkuari.

Mbase është me shumë e shumë filma që në rrugën e ikjes nga vendlindja diku ranë e diku pikuan siç pikon uji galerive të Bulqizës për tu fshehur pas gurëve e humb thellë shkëmbinjve.

Megjithatë Musa Vladi portretin tënd e kam. E ruaj në kujtesë. Siç thashë e siç shkrova: të qeshur. Nuk e di pse kjo cilësi e portretit të tij është kaq thellë shpirtit tim. Mbase është cilësi e njerëzve të mirë, njerëzve që ofrojnë dashuri e respekt.

I shkrova të vëllait...

Kaq është pak për të nxjerr figurën e Musait. Unë e mbaj mend të qeshur dhe shumë hokatar. Kishte edhe një fjalor të pasur dhe fjalë që bënin vend në biseda. Më shkruaj më gjatë për të. Edhe kur lindi, kur iku, familjen e sa më shumë.

Më dërgoi fjalët e zemrës të Halil Begut e të Bujar Shehut. Fjalë në një çast përlojtje. Çast kur nxënës i jepnin mësuesit lulet e fundit, jo në klasë por në largimin e tij pa kthim. Dhe jo vetëm ata por edhe intelektualë arsimitarë, banorë të qytetit "qytetit të floririt", Bulqizës...

I kujtuan Lurën ku lindi në shtator të vitit 1946, ku u arsimua, ku filloi jetën e tij mes fëmijëve si mësues, ku u edukua me kodin etik të malësorit ku shpesh përsëriste se "Nuk e tradhton kurrë njeriun".

I kujtuan jetën e tij lidhur në një nyje të fortë me Bulqizën ku u emërua pas dy viteve "shkollë" me fëmijët dhe burrat e Lurës, jetën si mësues në shkollën tetëvjeçare dhe të mesme, zëvendës drejtor e drejtor për shumë vite e atë që e njohu më gjerë e më thellë punën me minatorët, drejtues i Bashkimeve Profesionale.

E kërkova Musanë midis shokëve të punës në minierë.

Ma sollën të gjallë, plot mall e respekt...



BARDHOK RAJTA, inxhinier:

NË ATO BREZA NUK HARROHET MUSA VLADI

"E kam njohur shume herët dhe veçanërisht në Bulqizë ku përveçmësuesisë dha një kontribut shumë të madh me bashkimet profesionale të minierës në rolin e punonjësit të informacionit mbi punën në minierë, rezultatet e saj dhe përgjithësisht me jetëshoqërore të atyre viteve. Kishte një marrëdhënie të rrallë me njerëzit, ishte shumë i lidhur me ta dhe me krahinat nga vinin dhe veçanërisht duke u kujdesur për kushtet e tyre të jetesës dhe strehimin eshkolimim.

Në ato breza nuk harrohet Musa Vladi.

YLLI PATA, gazetar:

TIP PASIONANT NË TRANSMETIMIN E IDEVE

E kam pasur mesues. Na jepte edukate morale dhe politike.

Ishte një tip mjaft energjik, pasionant në transmetimin e ideve apo lëndës, serioz e nganjëherë i rreptë, por ishte me të gjithë njësoj nuk mbante hatër

Ndërkohë promovonte shumë nxënësit që aktivizoheshin me materiale për muzeun që drejtonte.

Mua me shkepte me 10-ta se i çoja foto të minierës se ja sillnin babës miqtë e shokët nga mediatsi puna jote për shembull.



ABDURAHIM ASHIKU:
Musa Vladin e kam parë gjithnjë të qeshur e plot hare. Dhe kur buzëqeshja e tij bashkohesh me atë të mikut të tij Baftjar Shahinin, simfoni bëhej.

BASHKIM LAMI, bashkëmësues

SHOK I SINQERTË DHE FAMILJAR I RREGULLT

Njohja ime e parë me Musa Vladin ka ndodhur kur ishim studentë në ILP "Luigj Gurakuqi" në Shkodër në vitin 1969. Musai ishte në fakultetin e histori-geografi-fizikulturë, ndërsa unë në matematikë-fizikë. Njohja ishte në grupe shokësh të gjithë fakulteteve si dibrane.

Në vitin 1970 Musai vjen nga Lura ku pati filluar punën si mësues e merr iniciativën si vullnetarë për të punuar në minierën e kromit në Bulqizë. Kjo iniciativë e tij u promovua në atë kohë si veprim i rëndësishëm, për një mësues që len punën e shkollës dhe shkon në sektorin e vështirë të minierës. Natyrisht sapo e mësova këtë ngjarje e gjeta një pasdite dhe u çmallëm, pasi kishim rreth një vit pa u takuar.

Bashkë me kushërinin tim Asllan Lami, teknik miniere në zonën D, e takuam përsëri Musain sepse në atë zonë u vendos të punojë dhe Asllani u kujdes që Musai të kalonte vështirësitë e momentit të fillimit, pasi miniera kishte rregulla të veçanta teknike, sidomos, kur punohej në thellësi të nëntokës. Më pas unë shkova ushtarë, por Musai me Asllanin kishin marrëdhënie pune të përditshme sepse Musain e mori në sektorin e tretë të zonës D, ku ishte vetë teknik dhe Kamber Duriçi, Hero i Punës Socialiste, ishte shefi i zonës. Pasi mbarova ushtrinë u emërova mësues në Bulqizë dhe Musai ishte kryetar i bashkimeve profesionale në ndërmarrjen e minierës. Takoheshim ndonjëherë dhe ruanim respektin reciprok me njëri tjetrin. Pas ca kohësh Musain e emërojnë mësues në shkollën 8-vjeçare ku isha dhe unë, pra u bëmë kolegë të afërt, ku takoheshim përditë në punë dhe shpeshherë në kohën e

KUJTIM GJOKA, inxhinier:

KA QENË NJERI ME SHUMË HUMOR
E kam patur mesues në shkollë të mesme. Ka qenë njeri i mirë dhe me shumë humor! Humor pa fund sa që ora e mësimit na dukej 5 minuta!

Ndonjë nxënës që vinte i papërgatitur i thoshte "Hape gojen, mor një herë!"

AGIM KOÇEKU, poet

ISHIM KRENAR NE DJEMTË E LURËS

Po n'rresht me ta' dhe Musa Vladi !
Bukurinë që kish' dhënë Zoti
Me liqenet, si kurorë Lura ,
Plot heronj e intelektual ,
Musa Vladi ...n'sofer me burra ...!
Nëse' nga Lura, si profesor,
Plot' cilësi, si felgjëri n'teste ,
Dia' e arsimit kishin nevojë ,
Profesor n'Bulizë, n'skollë të mesme!
Brez i ri' duhej përgatitur,
Për n'skollë t'larta, përxhinierë,
Ty' s'mjaftonte veç mësimi n'klasë,
Po n'galeri, n'nivele, qe kishte miniera!
Musa ishe' gjithëbuzëqeshje ,
Shume i drejte, pa preferenca,
Kudo ligjërove, si profesor ,
Si intelektual, n'për konferenca..!
Kush' te dukej, se po "çalon" ,
I jepje ndihme, e merrje për dore,
Vrulli i punës, n'minjere t'Bulqizes,
T'vendosi ne krye, t'klases punëtore !
Ishim krenare, ne' djemtë e Lurës,
Krenare..Nezhda' dhe Korabi ,
Jo veç Nikolla, Gjoka e heronjtë ,
Po n'rresht me ta' dhe Musa Vladi !

lirë ishim përsëri bashkë. Marrëdhënia ime me Musain ishte e sinqertë dhe gëzonim respekt reciprok për njëri tjetrin. Për Musain në kolektiv kishte mendime të dyzuara, por ai i thonte gjërat hapur, ishte kërkues e këmbëngulës në mbrojtjen e mendimeve të tij, ishte korrekt në marrëdhënie me kolegët e me nxënësit dhe i papërtueshëm në çdo rast në kryerjen e detyrave dhe bashkëpunues me shokët. Për ndryshimet politike të vitit 1990 ishte vlerësues objektiv i situatës dhe përkrahës i nevojës për ndryshim, natyrisht nga llogorja e tij, por me mua nuk hezitoi kurrë të rrinim bashkë dhe të debatim miqësisht edhe si kundërshtarë.

E kujtoj Musain, kur e kishim drejtues të formave të edukimit. Ai më ngrinte për të diskutuar pothuaj në çdo herë. Unë një ditë i ankohem, se pse duhej unë të diskutoja çdo radhë. Musai mu përgjigj e kishte për të mirën time, që të fitoja shprehje në diskutime e të mos mbetesha i ndrydhur nga lënda e matematikës. Nuk pata çfarë ti bëj Musait, por e vërteta është se mua diskutimet e shpeshta më aftësuan në të shprehur. Vite më vonë unë iu futa politikës në Bulqizë dhe u vërtetua qëllimi dashamirës i Musait, se të folurit në publik donë kthjelltësi, për të shprehur mendimet. Marrëdhënia me Musa Vladin mbeti e qëndrueshme derisa ai u nda parakohe nga jeta, pasi diabete e lodhi në shumë vite. Musa Vladi do të mbetet në kujtesën e bulqizakëve si një mësues i aftë e i përkushtuar, si aktivist shoqëror, si drejtues kompetent e vlerësues real i punës së kolegëve dhe shok i sinqertë e familjar i rregullt.

Musa Vladi mbeti në kujtesën e njerëzve si një bir i Lurës, si një mësues i Bulqizës, si një veprimtar me horizont të gjerë shoqëror. Musa Vladi është shpallur QYTETAR NDERI I BULQIZËS...

Abdurahim Ashiku
Janar 2022



M. Vladi me shokë



Rruga e Arbërit *Aty ku fjalët nuk i merr era!*

KRIJU AKTUALITET KULTURË TURIZEM SPORT DIASPORA NJOFTIME ARKIVA PAJTOHU/NDIHM

Kërk...

ARTIKUJ TË FUNDI

- Grate shqiptare që misionin vram jacobinën me shifërën nga firi Senokaj (BRI)
- Stratëzja e Dibrës nuk duhet të rindohet
- Qeveria duhet të tregohet e përvur dhe e përgjegjshme ndaj kërkuesve të punës
- Nga Duga Kanoni
- Rafting në Dri, një risi e turizmit në Dibrë për surpriza dhe aventura

Nga raftingu në Dri, te ngjitja në majën e Korabit, mundësitë e zhvillimit të turizmit

Me daljen e ngadalë nga pandemia shpresat për një risi të turizmit në vend po rriten. Çka kjo për një edhe lëvizjen për përgatitjen e guidave turistike dhe lëvizjen në turizëm. Më 29 maj 2021, në Parku Kombëtar "Shehervik" - Jabllanicë Ishë i pranohet ambasadori i...

Qershor 2021

Rruga e Arbërit *Botim i pavarur*

E vetmja e printuar për rajonin e Dibrës

Pajtohu dhe qëndro me gazetën *Rruga e Arbërit* më pranë #Dibrës!

Twitter: rrugaearbërit Facebook: Rruga e Arbërit Edit

Rruga e Arbërit @gazeteerajonittdibrës · Local business Edit Contact Us

www.rrugaearbërit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falënderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: info@rrugaearbërit.com

Informacioni për versionin e printuar: rrugaearbërit@gmail.com

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin "NDIHM MO EDHE TI" që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqipëri në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin "Rruga e Arbërit" ose përmes lidhjes:

<https://tinyurl.com/lcc3e2f>

Foto Majtas tregon pamjen e parë të faqes zyrtare në Facebook të gazetës *Rruga e Arbërit*

**REKLAMO
BIZNESIN
TËND**

Një faqe e plotë
me ngjyra kushton
15000 lekë

NE nuk jemi gazetë e pavarur, NE jemi gazetë e lirë
dhe pavarësia dhe liria jonë garantohe
vetëm nga mbështetja e lexuesve...

BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton:

Në Shqipëri: **600 lekë**. Në Europë: **10 Euro**.

Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Me **1000** lekë
mund të rezervosh
një reklamë gjatë
gjithë vitit në format
kartvizite (8x5cm)

**TANI MUND TË PAJTOHENI PRANË SPORTELEVE TË POSTËS SHQIPTARE
NË TË GJITHË SHQIPËRINË. NJË PAJTIM VJETOR KUSHTON 600 LEKË**

BIGmarket

një epokë e re dashurie
ndaj jush po nis tani

GJITHMONË ME OFERTA...
PESHKOPI MAQELLARË